

AGO ÇELI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

824-9  
C 36

# NÉ MALET KRYENGRITÈSE

88n-9

C 36

A G O Ç E L I

# NË MALET KRYENGRIȚESE

(K U J T I M E)

633392

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## DY FJALE PËR LEXONJËSIN

Sa herë kam mejtuar të shkruaj edhe unë kujtimet nga Lufta nacional-çlirimtare! E ky mejtim, mund të them, nuk më ka lënë kurrë të qetë. Ne ish - partizanëve na ka ngjarë shpesh që, kur kemi treguar histori të luftës, tek dëgjonjësit ka ndodhur të vëmë re edhe ndonjë shprehje habie e, ndofta, edhe mosbesimi. Kemi folur për ndonjë marshim të gjatë nëpër dimrin e ashpër, kur partizanëve u mungonte veshja, buka, gjumi, dhe ata ecnin, me gjithëse prapa mbeteshin gjurmë gjaku mbi dëborë; për ndonjë korier që çante me guxim përmes fashistëve për të çuar urdhërin në vend; për ndonjë të rrethuar që nuk pranoi të dorëzohej gjer në vdekje; për shokun që t'u plagos pranë dhe nuk pranoi asnjë ndihmë, po, përkundër, të urdhëroi të vazhdoje sulmin. Për këto, e të tjera si këto, kemi folur. Por, siç thashë, ka ndodhur që dëgjonjësit të kenë mbetur të habitur. Dhe ne, pa dashur, kemi pyetur, kemi kontrolluar kujtesën tonë. Po!! Të gjitha kanë ndodhur! Ne vetë i kemi parë

me sytë tonë, i kemi jetuar vetë. Lufta nacional-çlirimtare, është një epope e vërtetë me ngjyra heroizmi legjendare. Gjergj Elez Alija u ngre nga shtrati ku dergjej dhe, megjithqë kishte shtatë plagë në trup, e mundi bajlozin. Kështu thotë legjenda. Edhe partizanët dolën malit në fillim me një dyfek me gjalmë, një ballë me fishekë dhe luf-tuan kundër dy ushtërive të armatosura me armët më moderne, kundër kuçedrave të njerëzimit, siç ishin Gjermania naziste dhe Italia fashiste dhe fituan. Kështu thotë historia. Me trimërinë e Gjergj Elez Alisë luftoi edhe brezi ynë. Pra, edhe Lufta jonë e çlirimit është një epope legjendare, një legjendë e vërtetë e shekullit tonë.

«Çdo partizan ka qënë trim», ka thënë shoku Enver Hoxha. Po çdo partizan që kaloi në zjarrin e luftës së lavdishme, është edhe një thesar shumë i pasur kujtimesh. Një plumb i armikut të vrapshokun në krah, shoku yt të vdiq në duar, duke pëshpëritur «Para, partizanë». Për shtëpinë, fshatin apo qytetin tënd të digjej nën flakët e zjarrit, shkove në një shtëpi të uritur: nëna, e veshur me të zeza, të dha kafshatën e fundit të bukës dhe ti nuk more vesh kurrë se ajo e ruante përfémijët e saj barkzbrazët. Ajo ta dha ty, se ti ishe luftëtar i lirisë. Ti shkove dhe i dha babait mandatën përdjalin e vetëm dhe ai nuk desh që në shtëpinë e tij të derdheshin lot. «Liria i ka rrënjet në gjak» tha ai dhe zuri vëndin e të birit, në rrjeshtin partizan që ai kish lënë hapur. Sa herë e ke ndjerë gazellimin e fitores mbi armikun! Sa herë je ndodhur në çaste të vështira, i rrethuar, i uritur, i pagjumë dhe çave përpara, duke mos e peshuar fare frikën e vdekjes! Sa herë i shkunde xhepet dhe ndave

thërrimet e mykura të bukës së misrit me shokët e tu të armëve.

Lufta jonë qe aqë e pasur dhe e gjithanëshme, sa edhe në disa libra historie, do ish tepër e vësh-tirë të pasqyroheshin gjithë ato mori ngjarjes, episodesh, që janë një model i lartë i heroizmit, i patriotizmit revolucionar, i trimërisë dhe i sakrifi-cës që bëri populli ynë nën udhëheqjen e ndritur të partisë, për çështjen e madhe të atdheut dhe lirisë.

Kur fillon të shkruash kujtimet, e ndjen veten ngushtë. Mund të kesh qindra episode të ngjashme dhe të ndryshme nga njëri-tjetri. Dhe pa tjetër të lind nevoja që kur mendohesh t'ua tregosh të tje-rëve, të përpinqesh t'i rreshtosh kujtimet sa më mirë, të tregosh sa më bukur lidhjen logjike të ngjarjeve, ashtu siç ndodhën edhe në jetë. Por ajo që të bën të trembesh gjithmonë kur shkruan kujtimet e tua për luftën e çlirimtë është veçanërisht ndjenja se nuk ke kurrë mundësi t'i paraqesësh ngjarjet dhe episodet në madhështinë e tyre të vërtetë, për të ringjallur kështu, te lexonjë-sit, po ato çaste e gjëndje shpirtërore, që ti ke pro-vuar dhe parë me sytë e tu. Pra, gjithmonë e ndjen se mbete borxhli përpara lexonjësve dhe përpara vetes sate. Po prapë të ngushëllon e vërteta e madhe se heroikja, madhështorja e para-qet vetë veten e vet. Andaj edhe ne, ish partizanët, duke shkruar kujtimet tonë, sado zbetë që t'i para-qesim ngjarjet në krahasim me ato që kanë ndo-dhur, prapseprapë kemi bindje se vetë ngjarjet, duke pasur brënda heroiken, madhështoren, do ta ndihmojnë lexonjësin e sotëm e të nesërm për të

krijuar parafytyrimet e tia rrreth figurës së luftëtarëve të lirisë.

Dihet se kujtimet ngajeta e partizanëve trima nuk janë diçka për të kënaqur kureshtjen e brezave që nuk i jetuan ditët e luftës, pasi njerëzit tanë, si dje, edhe sot jetojnë revolucionarish dhe revolucioni ecën gjithnjë përpara.

Pra, edhe figura e luftëtarëve të lirisë është dhe do të jetë për brezat e sotëm dhe të nesërm shoku i llogoreve në të gjitha frontet e punës dhe të luftës.

Dhe për ne të brezit të luftës, që vetë procesi i ngjarjeve na bëri të kaliteshim në zjarrin e asaj epopeje të madhe, nuk ka lumturi më të madhe, se sa kur stafetën e revolucionit ta shikojmë në duar të sigurta ushtarësh sypatrëmbur, të gatshëm dhe të aftë, për ta çuar gjithmonë përpara çështjen për të cilën partizanët tanë trima shkruan faqe të lavdishme në historinë e popullit shqiptar.

## PJESA E PARË

### Në repartet «kufitare» njihem me shokë

Në vitin 1940, më çuan në repartet «kufitare» të Kukësit dhe pastaj në atë të Tropojës. Më duhet që fjalën «kufitarë» ta vendos që në fillim në thonjza, pasi, megjithëse fashistët bënin një propagandë të madhe mbi misionin «e shenjtë» që na ish besuar pér të mbrojtur «kufitë» e atdheut, qëllimi i tyre ish krejt tjetër. Shqipëria ish kthyer në një kryeurë e pushtimit fashist italian të vëndeve ballkanike. Pra, edhe përqëndrimi i forcave italiane në veri nuk kish qëllim të mbronte «kufitë» shqiptare nga Jugosllavia, po përgatitjet pér një sulm kundër atij shteti.

Pushtonjësit italianë dhe kasnecët e qeverisë kukslinge flisin sa ngjireshin pér «Shqipërinë e madhe», pér «sigurimin e kutive të shtetit shqiptar» etj. Ata, tek ushtarët dhe popullsia vëndase, kérkonin të shfrytëzonin edhe ndjenjën e dashurisë pér vëllezërit tanë të Kosovës pér t'u përligjur dhe pér të pasur përkrahje në sulmin që do t'i bën Jugosllavisë.

Po krahas kësaj propagande të ulët, bëhej në mes të ushtarëve edhe një propagandë tjetër nga

njerëz patriotë e pjesëtarë të grupeve komuniste. Kështu demaskoheshin parullat e propagandës fa-shiste se gjoja italianët «kishin ardhur për të mbrojtur kufitë tona, për t'i kthyer Shqipërisë Kosovën». Dalngadalë kushdo e kuptonte se prej atyre që kishin pushtuar krejt Shqipërinë, që kishin skllavëruar popullin shqiptar, nuk kish si të pritej që t'i zinte meraku për mbrojtjen e kufive të Shqipërisë dhe për fatin e Kosovës. Edhe njerëzit më të thjeshtë e kuptionin se xhelati kërkonte të fshihte hanxharin nën gunë. Propagandistët fa-shistë, duke gjetur çdo ditë e më tepër qëndresë edhe në mes të ushtarëve, filluan të mbanin qëndrim përherë e më të rezervuar. Ne nuk na besonin që të na vinin roje në kufi pa pasur pranë edhe ushtarë italianë. Në mes të ushtarëve shqiptarë e italianë kish gjithnjë grindje, pastaj filluan edhe rrahjet. Shpesh ushtarët italianë na fyenin haptazi: na thoshin se «ju s'ju pyet askush» «vëndi juaj është një koloni e jona». Këto fjalë na zëmëronin dhe ne kundërvepronim ashtu si mendonim. Për fjalë të tillë edhe unë rraha një ushtar italian dhe më arrestuan. Në burg më erdhën e më takuan dy ushtarë, Muzafer Askeriu nga Gjirokastra dhe Jani Zaharia nga Përmeti. Ata më dhanë fshehur paqeta me cigare dhe më shprehën simpatinë dhe solidaritetin e tyre për qëndrimin tim.

— Ushtari italian të ka thënë të vërtetën, tha Muzaferi duke vënë buzën në gas. — Shqipëria është kthyer në një koloni italiane.

— E di, — iu përgjigja, — po kur ta thotë tjetri në sy, s'mund ta përbash veten. Nuk mund ta dëgjoja pipinon të më fliste me aqë fodullëk. Me Muzaferin dhe Janin patëm raste të bise-

donim edhe herë të tjera. Ata u bënë edukatorët e mi të parë dhe shokët më të shtrenjtë.

Ishin anëtarë të grupeve komuniste të dy, dalloheshin për njohuritë e gjëra, për aftësitë në të çmuarit e gjëndjes politike dhe në të orientuarit në rrëthana të caktuara.

— Nuk duhet shprehur kështu urrejtja ndaj fashizmit. — më thanë një ditë Muzaferi me Janin.

— Mund të rrahësh një, dy, dhjetë ushtarë italianni. Por nga kjo s'vjen asgjë. Ne duhet të bëjmë një punë më të organizuar. Kështu si ti e si ne, të pakënaqur nga pushtonjësi fashist janë edhe shumë ushtarë të tjerë. Ne duhet t'u tregojmë se rruga e vërtetë e shpëtimit të Shqipërisë është lufta kundër Italisë fashiste, të sabotojmë çdo gjë që të na vijë ndoresh.

Muzaferi shpejt më dha disa broshura të grupeve komuniste. Më foli për Unionin Sovjetik, siç e quanin atëhere «Bashkimin Sovjetik», për shtetin e parë të punëtorëve dhe të fshatarëve. Përmua ajo kohë qe rilindja e vërtetë. Horizonte të gjëra in'u hapën përpara syve. U bëra më i fortë. Që atëhere, fillova të bashkëpunoj ngushtë me ta. Filluam të organizojmë grupet e para treshe. Shpejt m'u besua dhe mua drejtimi i njërit prej këtyre grupeve.

Bënim herë pas here mbledhje, natyrisht, fshehursti. Në to flitej për idetë përparimtare, për tradhëtinë e regjimit të satrapit Zog, i cili i a kishte shitur Shqipërinë prej kohësh perandorisë fashiste. Agjитatori më i zjarrtë qe Muzaferi. Ai na tregonte se në botë egzistonte një shtet ku punëtorët dhe fshatarët drejtonin vetë ekonominë e vendit, pushtetin politik, Bashkimi Sovjetik. Propagandën



Pjesëmarrës të grupeve të para komuniste: nga e majta  
në të djathtë Ago Çeli, dëshmor Myzafer Asqeriu  
dhe Jani Zaharia.

e përqëndruam sidomos ndër shokët më të afërt  
dhe tek ata që mejtonim se një ditë mund t'i  
tërhiqnim në grupet tona treshe.

Kur isha në Tropojë, më takoi të shkoja thuaj-  
se në çdo postë kufitare. Aty kisha të njojur dhe  
shokë të tjerë të rekomanduar. Ndjeja kënaqësi  
të veçantë, sa herë via re se edhe tek të tjerët  
zjente po ajo ndjenjë pakënaqësie dhe revolte ndaj  
pushtonjësve fashistë.

### **Komunisti italian**

Në gusht të vitit 1940, repartet kufitare dhe  
një divizion italian u vendosën në Kukës. Në mes  
të italianëve kishte shumë rezervistë, që i kalonin  
të 40 vjetët. Pritej që të hapej lufta me Jugoslla-

vinë. Por pasi në frontin e luftës italo-greke italia-nët s'kishin sukses, fashistët hodhën parullën që «ushtarët shqiptarë dhe popullsia vendase të shprehnin dëshirën për të kaluar në Frontin e luftës italo-greke». Si gjithnjë fashistët dhe qeveria kuislinge bërtisnin se kjo bëhej «për Shqipërinë e madhe me Kosovën dhe Çamërinë».

Grupet komuniste na udhëzuan që ta sabotonim këtë parullë. Dhe ne filluam t'u flisnim ushtarëve se nuk duhej të pranonin në asnje mënyrë për të luftuar as kundër grekëve, as kundër jugosllavëve. Nga lufta italo-greke Shqipëria jo vëtëm që s'kish asnje interes, po pjesa e saj e jugës po kthehej në një shesh lufte, ku digjeshin fshatra dhe shkrotohej ekonomia e vendit. Italia nuk e bënte këtë luftë për interesat e Shqipërisë, siç e trumbetonin fashistët, po thjesht për interesat e saja imperialiste. Siç kish skullavëruar dhe grabitur Shqipërinë, ashtu kërkonte të skullavëronte dhe të grabiste edhe popujt tanë fqinjë, grekët e jugosllavët.

Morali i ushtarëve sa vinte e po binte, jo vëtëm në shqiptarët po dhe në italianët. Zhurma e agijitorëve fashistë pritej me heshtje të plotë. Treshet tona vazhdonin të furnizoheshin me broshura të shtypura nga grupet komuniste.

Një herë me shokun tim Rasim Bazo, shtrirë në një krevat prej dërrase, po lexonim «Internacionalen», të shtypur në fletën e fundit të një broshure. Ne i lexuam disa herë ato strofa dhe vargje që na bënin më tepër përshtypje dhe nisëm t'i komentonim, sigurisht, si mund t'i kuptionim ne në atë kohë. Pastaj e lexonim përséri nga e para dhe përpinqeshim ta thoshnim përmendësh. Në krah të

djathtë ishte shtrirë një italian, i zeshkët, i thinjur, që dukej se ishte më moshë të thyer. Unë e Rasimi e shikonim dhe qeshnim. Ai e kish xhaketën të zbërthyer, këpucët me lidhëza të zgjidhura, një mjekër të vogël. Të kujtonte më tepër ushtarët e liruar se sa efektivët.

— Ja me çfarë ushtarësh do ta bëjë Duçia Shqipërinë të madhe, — tha njëri nga ne duke treguar atë dhe qeshëm.

Italiani rrinte tepër i qetë. Megjithëse e kisha krevatin për krah tij, me atë njeri s'kisha pasur rast të shkëmbeja asnjë fjalë. Kish një natyrë të heshtur. E gjeja ose në gjumë, ose duke lexuar gazeta, revista të ndryshme dhe libra. Sigurisht që rezervoheshim ndaj tij, megjithëse ne i dinimi disa prej tyre që mereshin direkt me punën e ndyrë të SIM-it.

Ndërsa ne po vazhdonim të mësonim përmendësh «Internacionalen», pa pritur italiano afroi kokën tek unë dhe më tha ngadalë:

«Ju jeni komunistë».

Ne ndërprenë menjëherë leximin dhe vështruam njëritjetrin në sy. Rasimi e fshehu broshuren në një mënyrë që të huajit të mos i binte në sy.

— Jo, — mohova unë. — Ne s'jemi komunistë.

Ai buzëqeshi lehtë.

— Ju po lexoni «Internacionalen», — tha, po me atë ton të qetë.

Unë mohova përsëri, pasi ai mund të ishte edhe ndonjë provokator. Andaj i dhashë Rasimit edhe broshurat që kisha unë, dhe i thashë të dilte jashtë t'i fshihte, ndërsa unë do të vëzhgoja çfarë do të bënte italiano. I huaji filloi të vishej, pastaj dolli. Së bashku me të dolla dhe unë.

Para kazermave qëndruam të tre nën hien e një kumbulle.

— Gëzohem shumë që ju, djem të rinj, jeni komunistë, — filloi të flasë qetë qetë italianni. Unë jam vetë komunist. E di që nuk më besoni. Kini frikë nga unë, por duhet ta dini se jam komunist. Më kanë marrë që nga kampi i internimit, më veshën ushtar dhe më kanë detyruar të luftoj në një tokë të huaj. Mos kini frikë nga unë, — na tha, dhe vura re se si i ndrisnin sytë nga një shkëlqim i brendëshëm. — Unë e urrej fashizmin, sa e urreni edhe ju. Fashizmi është armiku i gjithë njerëzimit.

Kur tha këto fjalët e fundit, m'u duk sikur nofullat iu shternguan, fytyra e tij e qetë sikur u egërsua; sytë shprehën zemërim dhe urrejtje.

Italiani vazhdonte të fliste. Ne nuk e kuptionim mirë italishten, dhe, veç kësaj, nuk mund t'i hapeshim aqë lehtë, pasi agjentët e SIM-it përdorin lloj-lloj metodash pér të na zbuluar. Vendosëm të thërrisnim Muzaferin të takohej me të. Shkoi pér ta marrë Rasimi dhe pas pak ata u kthyen të dy bashkë. Italiani me Muzaferin flisnin italisht. Ne kuptionim pjesën më të madhe të bisedës së tyre. Mua më kanë mbetur në mend fjalët e ushtarit të huaj: «Fashizmi është një kështjellë prej karte!. Demagogjia dhe pompoziteti janë nga çfaqjet e tij më të zakonshme pér të mbuluar krimet, dobësinë dhe pasigurinë në vetvete».

Ne ishim shumë të gëzuar që ishim njohur me një komunist italian. Veçanërisht i papërmbajtur tregohej Rasimi. Atë mbrëmje ai filloi të shajë ushtarët që i dinte se ishin agjentë të SIM-it, dhe pas pak filloi përleshja. Meqënëse Rasimi, nuk e

nderoi sipas irregullores një oficer, ky i preu fletë-arestin për në burg. Rasimi nuk pranoi t'i bindëj. Shpejt vjen një patrullë italiane për ta ares-tuar. Të gjithë ne u bashkuam me Rasimin dñe-patrullën italiane e pritëm me gaveta. Në ndihmë-të tyre u derdhën ushtarët italianë. Me ne u bash-kua pjesa më e madhe e ushtarëve shqiptarë. Qëllonim njëri-tjetrin me gaveta, me gurë dhe me-çdo gjë që kishim në dorë. Përfundimi i përlesh-jes qe i papritur: ne arritëm që jo vetëm Rasimi të mos futej në burg, po, me anë të protestave-tona, detyruam italianët të nxirrnin nga burgu edhe shokë të tjerë të burgosur më përpara.

Pas kësaj ngjarje u takuam përsëri me komunistin italian. Ai na përgëzoi.

— Sa më tepër t'u nënshtrohesh fashistëve, aqë më shumë të shtrydhin — tha italiano. — Ju është dhatë të kuptojnë se sot e tutje nuk mund të sillen me ju si t'ua dojë qejfi. Por kini kujdes: do-të mundohen t'ju përcajnjë, do të shfrytëzojnë midis jush gjithë sahanlëpirësit. Sa më të bash-kuar të jini, aqë më vështirë do ta kenë t'ju nën-shtrojnë sipas dëshirës së tyre.

Ne që prej asaj dite e thërrisnim italianin «miku ynë».

Ne ndjenim kënaqësi kur shikonim frutet e punës sonë.

Nën direktivat e grupeve komuniste, kishim arritur që te pjesa më e madhe e ushtarëve shqip-tarë të ngjallnim ndjenjën e revoltës, të urrejtjes ndaj fashistëve dhe, në një rast të caktuar, kishim kryer një veprim, që sado modest, ishte shënja e një fillimi të mirë.

Po këto ishin disa forma proteste; sigurisht, ende të paka, në krahasim me ç'duhej të bënim.

## Tentativë revolte e armatosur

Grupi ynë, me anë të shokut Niazi Hoxha nga Kukësi e tjerë lidhej me fshatarët, jepte udhëzime për veprime të koordinuara e më të gjera. Në këtë kuadër u vendos që të merrej prefektura e Kukësit, të vritej gjenerali, federali dhe të shkatërrohenj garnizoni. Po për të arritur një objektiv të tillë duhej të armatoseshin fshatarët, pasi numri i anëtarëve të grupit tonë nuk mjaftonte për të kryer një aksion të tillë kaq të rëndësishëm. Armët duhej t'i siguronim. Këto do t'u shpërndaheshin fshatarëve me anën e Niaziut dhe të shokëve të tjerë. U këshilluam me mikun tonë italian. Ai na ndihmoi që të hapnim depot, kur ishin roje shokët tonë të grupit. Mundëm të merrnim nga depot pushkë, mitrolozë të lehtë, mortaja, bomba dore, municione dhe materiale të tjera luftarake, të cilat i mbarëtëm me karroca. Pasi i bëmë gjithë këto përgatitje, menduam, se do t'ishte mirë të tërhoqnim nga ana jonë edhe kapitenin Neki Bejkon, i cili në ndonjë rast na fliste kundër italianëve. Ky na dukej i nevojshëm për të drejtuar ushtarakisht sulmin përmarrjen e garnizonit të ushtrisë. Nga grupi u çaktovat për të biseduar me kapitenin. I shkova në shtëpi dhe i fola hapur rrëth qëllimit të këtij aksioni të armatosur, për të marrë prefekturën dhe garnizonin. I çfaqa mejtimin se aksioni ishte plotësisht i mundshëm në ato kushte. Ushtarët shqiptarë ishin të pakënaqur ndaj pushtonjësve fasistë. Populli gjithashtu nuk priste veçse një shenjë të vogël. Ushtarët italianë, nën shtypjet e grushteve të rënda në frontin italo-grek kishin një moral të ulët. I fola dhe për shumë ushtarakë,

oficerë patriotë, që kishin sabotuar në ushtrinë italiane, siç ishte rasti i Spiro Moisiut. Pra, kishte ardhur koha që edhe ne të bénim detyrën tonë kundrejt atdheut. Kapiteni më dëgjoi në heshtje. Ai ndofta as që priste një propozim të tillë, pasi vura re se i ndryshonte vazhdimi shftyrat.

— Jam në një mendje me ju, — tha ai, — po për të kryer një aksion të tillë kërkohen njerëz dhe armë.

— Unë i thashë se ne kishim mundur të merrnim armë nga depot ushtarake dhe se ato i kishim shpërndarë në popull. I tregova dhe planin e marrjes së prefekturës; bile, edhe mënyrën si do të vritej dhe nga kush do të vritej gjenerali dhe federali. I kërkova mendimin e tij, çfarë vrejtje mund të kishte dhe çfarë detyra mund të merrte përsipër. Qëndroi pa bërë zë për disa sekonda. Pastaj tha:

— Mos u nxiton! Ta bisedojmë edhe një herë dhe pastaj marrim një vendim të prerë.

Këtë bisedë e bëmë në shtëpinë e kapitenit. Ishte e diel. Kishte rënë dëborë dhe aty nga ora dymbëdhjetë u ktheva në repart dhe njoftova shokët për përfundimet e bisedës me oficerin.

Rreth orës katër pasdite ra boria dhe batalioni u rreshtua. Përpara batalionit të rreshtuar erdhën një kolonel italian, kapiteni dhe një kapter shqiptar me një listë në dorë. Unë isha në rreshtin e parë. Kapiteni as m'i hidhte sytë fare, sikur të isha për të i panjohur. Menjëherë na shkoi mendja se kapiteni mund të na kishte tradhëtuar. Ai rreshthim i papritur i batalionit nuk ishte një shenjë e mirë. Megjithatë duhej pritur. Kapiteni filloi të lexojë emrat e gjithë shokëve tanë të grupit, gati

tridhjetë e dy veta. Ai nuk kishte gabuar shumë, na kish zbuluar thuajse të gjithëve. Pasi u rresh-tuam përpara batalionit, u urdhëruam që të nise-shim q'atë çast me shërbim për në Pukë. Armët do t'i merrnim me vete, por pa fishekë dhe të sho-qëruar nga një kompani me italianë. Koha e nis-sjes, mënyra si veprohej tregonte se ne nuk shko-nim në Pukë për arësy «shërbimi», porse diçka e rëndë na priste: ose internimi, ose pushkatimi: ashtu si armiku ta gjente më të volitëshme.

Unë dola nga rrjeshti, iu paraqita kapitenit dhe kërkova që nisja të bëhej të nesërmén, pasi po vinte nata dhe s'mund të ecej nëpër gjithë atë dë-borë që kishte rënë. I thashë se mua personalisht më dhimbte këmba dhe s'isha fare në gjendje të udhëtoja. Kapiteni nuk pranoi. Ai ecte poshtë e lart, pa më shikuar në sy. Unë nuk u largova dhe i kërkova përsëri që nisja jonë të shtyhej për të ne-sërmén. Me kapitenin flisja shqip. Koloneli kërkoi të dinte ç'doja. Kapiteni ja shpjegoi dhe ai dha urdhër që nisja të shtyhej për të nesërmén.

Në orën dhjetë të natës grupi ynë u mblodh për të vendosur se si do të veprohej. Kuptohej se kapiteni kishte tradhëtar. Qëndrimi ynë i mëtej-shëm në batalion na vinte jetën në rrezik. Andaj vendosëm të arratiseshim po atë natë. Nga kazer-mat do të largoheshim një nga një për të mos rënë në sy, pikëtakimi do të ish një vend mbi Kukës. Si u grumbulluam, pasi nuk kishim udhë tjetër, u detyruam të ndiqnim rrugën automobilistike nëpër borën që vazhdonte të binte. Por pengesa më e madhe ishte kalimi i urës së Drinit të Zi, që ruhej nga roje italiane. Ne iu afroam urës. Dy rojet shko-nin e vinin duke u takuar kohë pas kohe për të

ndezur cigaret. Tre nga shokët tanë, Ali Lala, Rassim Bazua e Ferik Islami nga Janjari, në çastin kur dy rojet u takuan në cepin e urës, i kapën në befasi, i çarmatosën dhe i muarën me vete disa kilometra larg. Ne prishëm linjën telefonike që lidhej me postën e kufirit dhe vazhduam rrugën. Bënte ftohët. Natë. Bora nuk pushonte së rëni. Na duhej të ecnim drejt kufirit me kujdes të madh që mos binim papritur në ndonjë patrullë italiane. Veç kësaj, ndjenim edhe rrezikun se mos ishte diktuar arratisja jonë nga reparti dhe të na ndiqnin prapa. Andaj çdo vonesë bëhej kritike. Por më në fund e arritëm dhe e kaluam kufirin pa u diktuar. Ne u dorëzuam në rojet jugosllave. Kur u thamë se ishim shqiptarë të arratisur nga ushteria italiane, ata na priten mirë. Na ndezën zjarr të ngrohem, na dhanë çaj dhe më vonë na nisën për në Prizren.

Kështu dështoi orvajtja jonë për një revoltë të armatosur. Gabimi ynë më i madh ishte që, pa e peshuar mirë, pa hetuar rreth kapitenit, ne jazbuluam të gjitha planet tona. Përse italianët nuk na arrestuan në vend dhe pranuan që të niseshim. të nesërmen, nuk ka si të shpjegohet.

Veçse, siç duket, kapiteni tradhëtar, për të ruajtur lëkurën e tij, ishte trembur ta tregonte hapur krejt planin tonë, pasi ish vetë gjer diku i përzier në të. Andaj ai duhet të na ketë paraqitur vetëm si të dyshimtë, sa për të prishur krejt planin tonë.

Më vonë ky tradhëtar u vra nga goditja e një predhe artillerie, më 1941, kur forcat fashiste sulmuàn Jugosllavinë. Këtë fund të turpshëm ja kish përgatitur vetes që kur kish zënë rrugën e tradhë-

tisë duke ua shitur ndërgjegjen pushtonjësve fashistë.

## Në vend të huaj

Autoritetet jugosllave prej Prizrenit na çuan në Prishtinë dhe pastaj në qytetin Valjevo të Sërbisë. Na vendsën në disa kazerma. Na dhanë nga një batanie për t'u mbuluar dhe për shtroje vetëm kashtë. Na veçuan krejtësisht dhe na trajtuan shumë keq. Ishim thuajse në një burg të vërtetë. Ne u detyruam t'i shtroheshim këtij fati të pamerituar për më tepër se dy muaj. Atje prunë edhe ushtarë të tjerë, të arratisur më vonë, për të mos luftuar për llogari të fashistëve italianë. Shpejt atje u bëmë rreth dyqind shqipëtarë. Ne mendonim krejt ndryshe. Si të arratisur shqiptarë nga ushtria italiane, nga një ushtri që pritej dita ditës të kalonte kufitë e Jugosllavisë, ne prisnim që të trajtoheshim si miq dhe jo sikur të na kishin zënë robër dhe të na shkëputnin për së gjallit prej botës. Por, megjithëse nuk dinim se si zhvilloheshin ngjarjet në atë kohë mjaft të acaruar, ne, anëtarët e grupit, mejtonim se Ushtria e Kuqe e Stalinit duhej ta çlironte krejt Ballkanin. Po as vetë ne nuk e dinim se si dhe kur mund të vinte një çlirim i tillë. Kjo ishte e vëtmja shpresë, me të cilën ushqenim veten dhe shokët.

Shumë nga ushtarët e arratisur nga agitacioni që kish bërë grupei ynë, filluan të na cilsonin edhe si fajtorë, duke na thënë:

— Ku është Stalini me Ushtrinë tuaj të Kuqe, për të cilën na kini folur kaq shumë? Mos vallë

qëllimi juaj ishte që të mbeteshim skllevër në një vend të huaj?

Shokët më të vendosur nuk e humbisnin kurajën. Por ishte e natyrëshme që në rrethana të atilla, kur askush nuk kujdesej për ne, kur na shikonin dhe na trajtonin thjesht si të burgosur, kur nuk ishim të sigurt aspak për të nesërmen, në t'atilla rrethana edhe besimi i disa shokëve për fitoren e ardhme, për të cilën nuk kishim dyshuar kurrë, kish filluar të lëkundej sadopak, edhe pse ne, me thonj e me dhëmbë mbaheshim fort dhe nxirrnim lloj-lloj argumentash për të bindur ushtarët dhe vetveten se për ne e vetmja shpresë ishin Stalini dhe Ushtria e Kuqe.

Në mes të muajit shkurt të vitit 1941 autoritetet jugosllave na shpërndanë nëpër qytete të ndryshme, dy e nga dy veta. Si duket, kërkonin, ndër të tjera, të shfrytëzonin edhe punën tonë, pasi u rëndoheshim edhe për atë copë bukë që na ipnin. Kjo shpërndarje na dëshpëroi tepër. Në një vend të huaj, ku të gjithë të shikojnë me dyshim, nuk ke tjetër më të afërt se sa shokun, bashkat-dhetarin tënd. Duke qënë të gjithë bashkë, na dukej se mund ta përballonim më mirë çdo të keqe që mund të na zinte. Mua dhe Rasim Bazon na çuan të punonim në një tunel afér qytetit Valjevo. Punonim gjashtëmbëdhjetë orë në ditë, në një të ftohët të madh. Bora kish ngrirë dhe ish kthyer në akull. Ishim të paveshur dhe gjithnjë të uritur. Ngarkonim dhe mbarnim gurë. Rasimi ish një djalë i rritur në qytet. Unë nuk besoja se ai mund t'u bënte ballë gjithë atyre vështirësive. Po njeriu nga natyra qenka i fortë dhe në luftën për të jetuar kalon pengesa, që, në kushte të zakonëshme,

do t'i dukeshin krejt të pamundura. Por, veç gjithë këtyre, strazharët jugosllavë (kështu u thoshin atje xhandarëve) nuk na linin rehat, duke na fyer çdo mëngjes e mbrëmje. Sipas strazharëve ne ishin njerëz të rrrezikshëm për qeverinë e tyre.

Nga fundi i marsit të vitit 1941 na mblodhën përsëri bashkë. Përveç dyqind shqiptarëve që ishin në Valjevo, ishin edhe afro njëqind shqiptarë të tjerë të arratisur në Jugosllavi që me ikjen e Zogut, duke përfshirë këtu nëpunës dhe oficerë. Në krye të tyre qëndronte një rus i bardhë, ish N/kolonel i ushtrisë së Zogut, Kyçyk Ullagai. U mblodhëm në një shesh. Nga ballkoni i një shtëpie na foli Kyçyk Ullagai. Ai na tha se ne duhej të luftonim për çlirimin e atdheut për të kthyer në fron përsëri mbretin. Mbreti, sipas aftësive dhe sakrificave që do të bënim, më vonë do të na shpërbiente dhe do të na gradonte. Sipas tij, me ne do të vinte dhe lart-madhëria e tij. Oficeri na pyeti më në fund se sa ishin që e pëlqenin atë plan.

Në emër të grupit tonë iu përgjegj Jorgj Shuteriqi. Ai shprehu kundërshtimin për të luftuar të lkuadruar në ushtrinë e ish-mbretit të rrëzuar. Edhe kur na pyetën një për një dhe u pa se ata që kundërshtonin planin e tij nuk ishin të pakët, Kyçyku, i tërbuar nga inati, filloi të bërtiste, të na akuzonte si komunistë, si njerëz të pafe, të familje dhe të paatdhe. Në ato çaste u lëshuan si ujqër strazhorët jugosllavë, na goditën me kamzhikë, me tyta pushkësh. Na arrestuan që të gjithëve dhe pas dy orëve, të lidhur, na hipën në vagona dhe të nesërmen në mëngjes na çuan në një kamp internimi. Atje kish vetëm disa baraka dhe vendi

ishte i shkretë. Përreth s'dukej asnjetë banesë, veç kazermave të ushtarëve që na ruanin ne.

Në atë kamp qëndruam njëzet ditë. Kundrejt nesh përdoreshin metoda fashiste. Na fyenin; për të ngrënë na ipnin nga një copë bukë të zezë me ujë lakrash sa për të mbajtur frymën. Dukej sikur ky ishte fundi ynë.

## Largimi nga kampi

Po erdhi dita e tetëmbëdhjetë prillit të vitit 1941 dhe për ne ndodhi diçka e papritur. Si zakonisht, prisnim orën kur ushtarët do të na hapnin derën e barakës që e mbyllnin nga jashtë. Po kaluan disa orë dhe asnjeri s'po vinte. Erdhi një çast kur ne filluam të dyshonim. Nisëm të thërrisnim, t'i binim derës me grushte, po askush nuk na përgjigjej. Atëhere shqyem derën dhe dolëm jashtë. Kampi ishte i shkretë. Shkuam te kazerma e ushtarëve dhe atje pamë një pështjellim të vërtetë: çdo gjë ishte lënë në rrëmujë, dëshmi e një ikje në panik; depot me veshmbathje, me ushqime e municione ishin lënë në mëshirë të fatit. Pra, diçka duhej të kish ndodhur. Ky kamp fatkeq vetëm në kushte të jashtëzakonëshme mund të na lejonte një «liri» të tillë. Nga disa fshatarë që erdhën në kamp mësuam se Jugosllavia ish sulmuar nga Gjermania dhe kish ngritur duart përpjetë. Nëpër depo muarëm ushqime, u armatosëm dhe nuk na mbetej tjetër veçse të niseshim në këmbë në rrugën drejt atdheut. Ishim banorët e fundit që linim atë kamp të mallëkuar. Ato njëzet ditë që qëndruam atje qenë prova më e vështirë gjatë gjithë qëndrimit

tonë në Jugosllavi. Na dukej sikur kishim dalë në liri, megjithëse rruga që kishim përparrë ish e gjatë dhe ne, të huaj, në një kohë lufte, në çdo rast mund të ndodheshim në rrezik. U nisëm më këmbë. Vend i ishte në një rrëmuje të vërtetë. Ish një kohë e tillë, ku secili përpiquej të ruante kokën e vet, kur asnjëri nuk të pyeste se kush ishe dhe ku shkoje. Duke kaluar qytete dhe fshatra, shikoje kudo te njerëzit frikën, panikun, pasigurinë, pësh-tjellimin.

Pas shtatë ditësh udhëtimi arritëm në Mitrovicë të Kosovës. Nuk do të na harrohet kurrë ai çast kur dëgjuam njerëz që po flisnin shqip. Ne i ndalnim në rrugë dhe u thoshim se dhe ne ishim shqiptarë. Përqafoheshim me ta të mallëngjyer, sikur të ishim miq, të njojur prej kohësh. Ishim midis bashkatdhetarëve tanë dhe e ndjenim veten më të sigurt, na dukej sikur gjithë vuajtjet tona kishin marrë fund.

Në Mitrovicë na priten mirë dhe, atë mbrëmje, të tridhjetë e dy shokët e kaluam në një shkollë që ish prishur pjesërisht nga bombardimet e gjermanëve. Nëpër rrugët e Mitrovicës kish gjallëri. Atje tabulloja ishte krejt ndryshe nga qytetet e tjera jugosllave. Agjitarët fashistë propagandonin se tani «Kosova do të bashkohej me Shqipërinë», se «italianët ishin vëllezër të shqiptarëve», se do të formohej një qeveri me Xhafer Devën në krye, se «kosovarët shpëtuan një herë e mirë nga zgjedha e shqave».

Kjo ish një lojë e dyfishtë. Fashistët kërkonin të shfrytëzonin urrejtjen e kosovarëve ndaj sérbo-mëdhenjve dhe ndjenjën e pastër për vëllezërit e tyre, për të maskuar skllavërimin fashist. Dhe kish

njerëz naivë që gënjeleshin nga kjo propagandë e stërholluar. Ne vumë re se si në qytet përgatitshin flamurët shqiptarë, dilnin me ta nëpër rrugë dhe pritnin të festonin shpalljen e qeverisë.

Për herë të parë atje lindën mosmarrëveshje edhe në grupin tonë. Pjesa më e madhe e shokëve mejtonin se nuk duhej të vazhdonim rrugën për të kaluar në atdhe, pasi një gjë e tillë paraqiste mjaft rreziqe. Në Kosovë, siç thuhej, do të ngrihej një qeveri shqiptare, pra, të qëndronim atje, ku mund të futeshim edhe në punë. Ne e kundërshtonim këtë gjë duke thënë se çdo qeveri që të formohej do t'ishte një qeveri kukull e vënë nga fashistët, një qeveri tradhëtare, siç ishte dhe në Shqipëri. Veç kësaj, në atdhe, ku njihnim mirë njerëzit dhe vendin, mund të zhvillonim një veprimitari më të gjërë. Pas shumë debatesh, e hodhëm në votë. Po ne ishim më pak dhe më kujtohet se njëri prej tyre na tha se pakica duhej t'i shtrohej shumicës. Po ne as që e kishim praktikuar ndonjë herë atë rregull dhe as që e njihnim si një forcë nënshtronjëse.

## E p a p r i t u r a

Të nesërmen shokët, që vendosën të qëndronin në Mitrovicë, na përcuallën gjer në stacionin e trenit, po kur arritëm ne, treni kish ikur dhe kështu u nisëm për në Shkup më këmbë. Arritëm rreth orës shtatë të mbrëmjes. Qyteti kish kudo gjurmat e luftës, shtëpi të shkatërruara nga bombardimet, shkolla të prishura, në stacion ushtarë, njerëz që vinin e venin, të vrarë, të plagosur. Me një fjalë,

ish një babiloni e vërtetë. Udha jonë për t'u kthyer në atdhe ish nga Manastiri i Bitoljes, po rruga ishte e prishur. Atëhere u detyruam të qëndronim në Shkup tri ditë. Strehoheshim në një shkollë të bombarduar pa drithë; të hanim nuk kishim. Veç kësaj, ne nuk e dinim se si mund ta gjenim rrugën për në Manastirin e Bitoljes. Të dilje ishte e rrezikshme. Qytetin e kishin pushtuar ushtarët bullgarë dhe çdo të dyshimtë e arestonin menjëherë, sidomos gjithë ata që kishin bërë pjesë në ushterinë jugosllave. Ditën e tretë tre nga shokët tanë, Ali Lalaj, Petro Calo, Hysen Kore shkuan për të parë disa kafshë të egra në një park zoologjik. Po shokët nuk po ktheheteshin. Atëhere ne dolëm për t'i kërkuar. Kuptohej që do të kishin takuar patrullat bullgare, do t'i kishin arrestuar si të dyshimtë dhe do t'i kishin burgosur, dhe, duke i kërkuar burgjeve, mezi i gjetëm pas dy ditësh. Me oficerin bullgar që na doli nuk merreshim vesh. Me vështirësi i thamë disa fjalë jugosllaviste, dhamë emrat e shokëve dhe thamë se ishim shqiptarë. Pas shumë ngurrimesh, më në fund i liruan.

Pas lirimit të shokëve, nevoja për t'u larguar sa më parë nga qyteti u bë e domosdoshme. Duhej të shkonim diku në një vend tjetër ku na dukej se do të ishim më mirë. S'kishim ku të flinim. Në stacion qëndronin disa treni. Marrim vesh se hekurudha për në Manastirin e Bitoljes ish rregulluar. Ish masdite. Ne u futëm fshehurazi në vagonat e një treni. Ai me siguri do të ikte drejt jugës diku sa më afër Shqipërisë. Ne s'e kishim ndjerë fare kur ishte nisur treni, të lodhur e të raskapitur, të uritur e pa gjumë siç ishim, na kish zënë gjumi. Veç në një mëngjes të thellë kur njëri prej shokëve u zgjua muarëm vesh se kishim arritur

në Selanik. Mbetëm aqë të habitur sa edhe lexonjësi i këtyre rreshtave. Fatorini i trenit kërkonte të dilnim jashtë. Po ish ende pa gjdhirë mirë dhe ne kërkuam të rrnim edhe ca në vagon. S'kishim as biletat. U mblodhën tre fatorinët dhe na kërku-an biletat. U thamë se ishim shqiptarë të aratisur nga ushteria italiane. Ata na kërkuau t'u jipnim në vënd të biletave, si shpërblim ndonjë xhaketë. Në xhaketa të tepërtë s'kishim. U thamë se s'kishim asnje gjë me se t'ua shpérblenim, por fato-rinët ngulnin këmbë. Atëhere filloi një rrahje e vërtetë që vazhdoi një çerek ore dhe ne mezi mundëm të iknim.

Stacioni i Selanikut ish mbushur me ushtarë grekë që ktheheshin nga fronti italo grek. Qindra veta ishin shtrirë për tokë. Disa të plagosur, disa të lodhur e të rraskapitur, flinin në anë të rrugës, disa bërtisnin nga dhëmbjet e plagëve, mallëkonin fashistët. Shumë ushtarë u kërkonin civilëve lëmoshë, cigare, bukë etj. Selaniku jetonte në ethen e luftës dhe të disfatës. Ne ecnim ku të na nxirte rruga. Kur arritëm në qëndër të qytetit, shihej e njëjta tabllo: ushtarë të rreckosur, të lodhur, me plagë, që kërkonin lëmoshë. Qyteti ishte i bukur me pallate të mëdha, me parqe dhe lulishte, me rrugë të gjëra. Ai shtrihej buzë detit, pastaj hapej në një pllajë që të kujtonte Gjirokastrën tonë. Po ne, si të huaj që ishim, të papajisur me asnje dokument, zbritëm afër bregut të detit dhe qëndruam në një park që ish pak si i mënjanuar dhe larg rrugëve kryesore. Aty kaluam ditën dhe natën. Ne nuk dinim se ku të drejtoshim dhe çfarë të bënim. Kuptohej se rreziqet tona për t'u kthyer në atdhe ishin shtuar më tepër. Në kishim udhëtar gjatë

atyre ditëve si një barkë pa timon përmes një deti të trazuar nga dallgët.

## Barba Simoni

Një plaku, si duket, i kishim rënë në sy si një rez të huaj dhe të panjohur. Na vuri re që ishim njerëz të pastrehë, të ardhur nga ndonjë vend i huaj. Sigurisht në kohë lufte gjëra të tilla nuk tingellojnë të çuditëshme. Jo vetëm ne që na kishte çuar në Selanik një rast i papritur, na kishte hedhur dallga e papërmabjatur e ngjarjeve, po edhe ushtarët grekë që ktheheshin nga lufta në vendin e tyre endeshin rrugëve të Selanikut në mëshirë të fatit. Plaku na u afrua dhe na pyeti se çfarë ishim dhe nga kishim ardhur. Ne shikuam njëri tjetrin në sy. Ai ish një njeri i panjohur dhe çdo përgjegje mund të shkaktonte rrezik. Mendoam t'i tregonim të vërtetën. Po dikush nga ne tha:

— Po sikur plaku të jetë një simpatizonjës i fashistëve?

Dhe kjo nuk ish e pamundur. Atëhere ne na priste burgu. Po kish më tepër mundësi që ai plak që tregonte, me sa na u duk ne, një interesim njerëzor, të mos ish njeri i keq. Kish më tepër mundësi të ish kundër se sa pro atyre që kishin pushtuar atdheun e tij. Me një greqishte gjysmake Hamiti, një nga shokët tanë, tha se ishim shqiptarë, ushtarë të arratisur nga ushtria italiane pasi e urrenim fashizmin. Ne i treguam se si na kish sjellë fati gjer atje. Plakut i ndriti fytyra kur mori vesh se ishim antifashistë. Ai u hodh e na përqafoi. Kur mori vesh se flimin jashtë, na ftoi në shtëpi të

tij, duke na premtuar një dhomë me qira. Ne i thamë se s'kishim me se t'ja paguanim qiranë.

— Kur të zini ndonjë punë, — tha plaku me një ton të qetë, — unë s'jua kërkoj tani paratë.

Vetëkuptohet që ne s'kishim ndër mënd të zinim ndonjë punë në Selanik, po të i knim sa më shpejt për në atdhe. Në ja shpjeguam Barba Simonit, se cili ish qëllimi ynë dhe e pyetëm në kishte ndonjë mundësi për të na ndihmuar që të kthehetëshim sa më shpejt në Shqipëri. Kjo bëhej dhe më e domosdoshme, pasi aty kishim parë edhe nga ata italianët, me të cilët kishim qënë bashkë në kufi. Ata na njihnin dhe do të mjaftonte një kallëzim për të marrë fund gjithshka.

Barba Simoni nuk ishte në gjëndje të na përgjigjej rrëth mundësive për kthimin tonë në atdhe. Megjithatë ai u tregua me ne shumë mikpritës.

Në shtëpinë e tij ne pothuaj qëndruam katër muaj. Punonim në një ekonomi duhani të një pronari. Pothuaj nxirrnim sa për të ngrënë. Plaku s'na kërkoi kurrë qira dhe na ndihmoi me aqë sa i erdhë në dorë. Ne nuk do t'ja harrojmë kurrë plakut këtë shpirtmadhësi fisnike. Pas ca kohësh Barba na tha se e vëtmja mënyrë për të krijuar mundësitë që të kthehetëshim në Shqipëri ish që të lidheshim me komunistët dhe patriotët antifashistë grekë. Ata kishin krijuar një administratë të posaçme për të ndihmuar ushtarët grekë që të kthehetëshin në shtëpitë e tyre. Barba Simoni na vuri në lidhje me ta. Hymë në një zyrë të vogël. Ishin tre veta, që të tre mbi të 40 vjetët. Na priten mirë. U treguam se ishim të arratisur shqiptarë, si kishim arritur gjer në Selanik dhe rrezikun që na kërcënohej për të na arrestuar. Ne u kérkuam në kishin mundësi të

gjenin ndonjë mënyrë për t'u kthyer në Shqipëri, ose për të ikur që andej, pasi aty kishin ardhur reparte të ushtërisë italiane, ku ne kishim qënë ushtarë. Kur muar vesh që ne ishim antifashistë, njëri prej atyre të treve u ngrit më këmbë dhe na përqafroi.

— Sa të jemi ne gjallë, nuk kemi për t'ju lënë të bini në duart e bishave fashiste! — tha ai. — Po të kërkonit të shkonit në Turqi, mund t'ju nisnim që nesër. Po ju kini vendosur të ktheheni në Shqipëri dhe ne do t'u çojmë gjer në kufirin e atdheut tuaj. Por kjo do të zgjasë pak dhe do të jetë më e vështirë pasi do të na duhet t'u përgatisim dokumenta të rrreme.

Ai fliste me një ton sigurie dhe entuziazmi. Ne na ndritën fytyrat nga gjëzimi. Kishim humbur çdo shpresë dhe ja ajo na lindi përsëri. U thamë se do t'u kthenim përgjegje sa më shpejt dhe u ndamë prej tyre duke i shtrënguar duart fort njëri-tjetrit.

Ne na bëri shumë përshtypje ndjenja e solidaritetit të shokëve grekë. Mendoam se ai që u ngrit dhe na përqafoi i pari, posa mori vesh që ishim antifashistë, duhej të ish komunist. Edhe ne e quanim veten të tillë. Dhe komunistët e gjejnë njëri tjetrin dhe janë për krah njëri tjetrit kudo që të jenë në botë. Ata i lidh ndjenja e madhe e internacionalizmit proletar, qëllimi i përbashkët, pamvarësish nga kombësia, nga raca dhe vendi nga janë. Është e vërtetë se ne në atë kohë fjalët «Internacionalizmi proletar» nuk i kuptionim dhe aqë mirë, megjithëse i kishim lexuar nëpër broshura e i përrnëndnim në mbledhjet tona të grupit. Po në qëndrimin e shokëve grekë frymën e inter-

nacionalizmit proletar ne e pamë të konkretizuar. Po edhe sikur ata të tre të mos kishin qënë komunistë, prapë i lidhte me ne lufta e përbashkët kundër të njëjtët armik dhe të njëjtët pushtonjës, fashizmit.

Përgjegja jonë vonoi. Kishte dy mendime: Një pjesë e shokëve mendonin të shkonin në Turqi, kurse pjesa tjetër të ktheheshin në Shqipëri.

Të parët arësyetonin kështu: Turqia është një vend asnjanës dhe atje do të ishim jashtë çdo rreziku. Shokët grekë kishin premtuar se atje mund të na nisnin që të nesërmen, kurse për të arritur në Shqipëri, jo vetëm që do të zgjaste shumë si kohë, por puna paraqiste rreziqe. Veç kësaj, me t'u kthyer në atdhe, do të arrestoheshim si dezertorë e antifashistë nga autcritetet qeveritare. Andaj pjesa më e pakët e shokëve ishin të mejtimit të shkonim në Turqi. Po ne të tjerët, që përbënim edhe shumicën, kërkonim të ktheheshim në atdhe, pasi na dukej shumë e rëndë të ndaheshim për së gjalli nga prindërit dhe të afërmit tanë. Veç kësaj, nëqoftëse ishim të vendosur për të vazhduar luftën kundër fashizmit, këtë mund ta bënim me popullin tonë, midis njerëzve tanë. Shëmbull i mirë ishte puna jonë me kufitarët, se, megjithëse na mungonte ende pjekuria, organizimi i duhur, ne brenda një kohe të shkurtër arritëm të bëним për vete një numër jota vogël të ushtarëve bashkatdhetarë.

Grindjet për këtë çështje qenë shumë të ashpra. Po ne duhej të dilnim me një vendim të vetëm. Sikur të kërkonim që një pjesë të shkonin në Turqi, dhe një pjesë në Shqipëri, kjo do të ish krejt e pahijëshme për ne dhe ndofta do të vinte në dyshim edhe sinqeritetin tonë. Më në fund, pas pesë

ditë debatesh, u kthyem përgjigjen se dëshironim të ktheheshim në Shqipëri. Atëhere shokët grekë, si morën të dhënat e nevojëshme, na kthyen këtë përgjegje: «Do të prisni sa të pregatisim dokumentat e duhura dhe ju njoftojmë ne».

Kjo përgjegje na ngjalli një lloj dyshimi dhe filluan përsëri qortimet për ne që ishim bërë shkaktarë për të mos shkuar në Turqi.

Dhe pritja qe tepër e gjatë. Ne çdo ditë na dukej një muaj. Në qytet ishim të veçuar. Vetëm Barba Simoni na binte ndonjë lajm. Prej një gjer më dhjetë qershor të vitit 1941 flitej se forca dhe armatime të shumta shkonin për në Bullgari, në drejtim të lindjes. Sipas Barba Simonit kjo ushtri e madhe e Hitlerit shkonte kundër rusëve. Nëpër pull qarkullonin dhe plot fjalë të tjera.

Në mbrëmjen e 22 qershorit, u lajmërua me anë të radios se në qytet shpalaje shtetrrethimi. Ky vazhdoi për tri ditë. Nuk lejohej asnjeri të dilte në rrugë, as të shkonte prej një shtëpie në tjetren. Kushdo që do të thyente këto rregulla do të pushkatohej menjëherë në vënd. Gjermanët filluan të arestonin komunistët në të gjithë qytetin. Ne pamë se si ata vrisin në mes të rrugës komunistë e patriotë që s'donin t'u dorëzoheshin. Ndjekjet dhe arrestimet vazhdonin. Po në mëngjezin e ditës tjetër ne vumë re se si në gjithë qytetin njerëzit i jepnin njëri tjetrit, nga dritarja në dritare, parrullën «ndihmoni djemtë tuaj», «hapni për ta dyert dhe dritaret», «i shpëtoni nga fashizmi».

Selaniku ish kthyer në një varr të vërtetë. Shikoje vetëm skuadra gjermane me të arrestuar përrapa, patrulla, autoblinda, etj. Njerëzit ishin struktur nëpër shtëpitë me ndjenjën e frikës së vdekjes.

Pas dy ditësh Barba Simoni na dha lajmin se miqtë tanë i kishin arrestuar dhe zyrat e tyre i kishin shkatërruar. Pra shpresat tona u prenë. Ne i thamë Barbës në kish mundësi të na njihte me ndonjë komunist tjetër, po ai na tha se ahere një gjë e tillë ish e pamundur dhe shumë e rrezikshme. Por ne s'kishim asnje mundësi tjetër, veçse të prisnim në dhomën e Barba Simonit ato që do të sillnin ditët që do të vinin. Dhe kush ka provuar pri-tje të tilla, e ka ndjerë se sa të neveritëshme janë plogështia dhe pamundësia për të vepruar.

### Në gjirin e tokës mëmë

Në të tillë gjëndje psikologjike ishim ne, kur në mbrëmjen e 4 gushtit papritur na u paraqit një i panjohur. Ai na tha se ish i urdhëruar të na njof-tonte se dokumentat ishin gati dhe se ai me një shok tjetër do të na shoqëronte gjer në Follorinë, gjatë rrugës për në Shqipëri. Ky lajm ish për ne si «sheqer-kismet» i zbritur nga qielli.

Të nesërmen duhej të takoheshim në një han në verilindje të qytetit. I lamë lamtumirën Barba Simonit, plakut fisnik e zemërbardhë, atij plaku të nderuar që mishëronte bujarinë, ndersh-mërinë e fisnikërinë e popullit grek, dashurinë e njeriut për njeriun. Dhe në orën 5 të mëngjesit në hypëm në një kamionçin. Përveç shoqëronjësit dhe shoferit kish ardhur për të na përcjellë edhe një shok tjetër. Ai na përgëzoi të gjithëve dhe na uroi «udhë të mbarë për në atdhe» dhe «Luftë të mbarë kundër fashistëve». Ne e muarëm me vete këtë urim të komunistit grek dhe e uruam atë në të

njëjtën mënyrë. Rruga ish e shtruar dhe kamionçini ecte me tërë shpejtësinë, në drejtim të veriperëndimit gjatë një fushe pa mbarim.

Gjatë udhëtimit shoqëronjësi na tha se ishte i urdhëruar që të mos na dorëzonte në duar të fashistëve dhe se me gjithë masat që ishin marrë, për çdo të papritur, kamionçini ishte i pajisur edhe me armë. Dhe ai na tregoi vendin ku kish fshehur armët: revolverë, thika, etj.

— Më mirë të vritesh se të biesh në duar të egërsirave! — përfundoi ai.

Ne na mallëngjente ky solidaritet i shokëve tanë të armëve, i shokëve tanë të një ideali.

Kur arritëm te një burim, u ndalëm dhe u shtruam për të ngrënë bukë dhe ushqime që shoqëronjësi i kish marrë posaçërisht për ne me vete. Po njeriut, jo vetëm nga hidhërimi, po edhe nga gëzimi i madh i pritet oreksi. Ne ishim në një gjendje aqë të emocionuar, sa shtruam bukën dhe asnje nga shokët nuk hëngri. Petro Colua filloi të na recitojë vjersha të Naimit përmendësh, sidomos atë pjesë të poemës «Bagëti e bujqësia» që flet përmallin e atdheut.

Rreth orës 4 rruga fushore mbaroi. Xhadeja filloi të ngjitej në një të përpjetë malore. Përpara nesh shtriheshin male. Petrua recitonë: «O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë». Këto vargje i përsërisnim të gjithë si fëmijët në klasë. Ne ishim ende larg kufirit, po malet që po kalonim na kujtonin vendlindjen, pejsazhin e ashpër e krenar të Shqipërisë.

— Sa larg është që këtej kufiri? Ku janë malet tonë? Pyesnim me ankth shoqëronjësin.

— Do të arrijmë së shpejti, — na thoshte ai.

Në kufi janë disa gurë të mëdhenj. Atje uluni më gjunjë dhe i puthni gjersa të çmalleni.

Në orën 6 të mbrëmjes arritëm në qytetin e vogël të Follorinës. Dyqanet, disa baraka të ulëta, vinin me radhë. Rrugët ishin të ngushta, të shtrëmbëra, të papastrë. Në pazar venin e vinin fshatarë me kafshë për dore. Ne i njohëm që nga veshja që ishin shqiptarë. Kur i dëgjuam të flisnin dhe shqip, u dolëm përpara dhe u përqafuam me ta. Shoqëronjësi dhe shoferi kujtonin se kishim takuar aty ndonjë njeri të njohur a të afërmit tanë, kurse ata ishin fshatarë, që vinin atje për të blerë misër, që as i njihnim, as i kishim miq. Po mjafton që ishin shqiptarë që ne të çmalleshim. I pyesnim se ç'të reja kishim nga Shqipëria, për dëmet që kish shkaktuar lufta. Njëri prej tyre kish pasur të vëllanë të arratisur bashkë me ne në Jugosllavi. Ai u ish dorëzuar autoriteteve italiane. Dhe pasojat ishin të rënda. E kishin internuar n'Itali.

— Duhet të kini mendjen, djem, — na tha fshatari, — po e muarën vesh qeveritarët se jeni arratisur nga ushtëria italiane, nuk do t'i kini punët mirë. Fashistët janë të liq, të poshtër.

Ne sigurisht që e merrnim me mënd një rrezik të tillë. E dinim se për të arritur gjer në shtëpitë tona do të kalonim përmes rreziqeve. Sidoqoftë paralajmërimi i fshatarit na e bëri edhe më të qartë se duhej të tregoheshim të kujdesëshëm për të mos rënë në grackë. Atë natë fjetëm në qytetin e Follorinës.

Të nesërmen, së bashku me fshatarët që kishin ngarkuar kafshët me misër, u nisëm në drejtim të kufirit. Shokët grekë na shoqëruan gjer te posta e kufirit. Korofillakët fshatarët i lejuan, po ne nuk de-

shën të na linin. U thamë se ishim ushtarë robër. Shoqëronjësit tanë u thanë korofillakëve se ne ishim vëllezrit e tyre, kishim luftuar kundër fashistëve dhe ishte turp që të silleshin ashtu me ne. Korofillakët kërkonin peshqeshe. Ata donin të na merrnin këmishat, xhaketat që kishim në trup. Shoqëronjësit filluan t'i shanin korofillakët. Filluan të grinden midis tyre dhe u desh që të ndërhyrin fshatarët shqiptarë për t'i ndarë. Ata u dhanë korofillakëve nga dy paqeta cigare gjersa u bindën të na lironin. Me shokët grekë u ndamë si vëllezër të vërtetë. Njeri nga ata, një burrë i hequr, me mustaqe, na tha duke mbledhur grushtin: «U takofshim së shpejti si triumfonjës të të njëjtit qëllim».

Ne ecnim në truallin e tokës amtare. Nëpër trup na kalonin të ngjethura, pështyma na mbetej në grykë. Më të dy anët malet dhe poshtë lugina e bukur e Devollit, Petrua recitonte vargjet e Naimit:

O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë.  
Fushat e gjëra me lule...

Kurrë në jetën time nuk e kam ndjerë aqë tepër sa në ato çaste madhështinë e këtyre vargjeve, ku shihnim madhështinë e dhëmshur të dashurisë krenare për malet, lisat, fushat e më-mëdheut tonë të dashur.

Shqipëria! Vatra dhe djepi ynë. Nëna jonë e gjëzimeve dhe e hidhërimeve! Ishim në gjirin e saj dhe të ndërgjegjëshëm se përpara na prisin përpjekje të reja.

## PJESA E DYTË

### Në malet kryengritës të Kurveleshit

Isha kthyer përsëri në gjirin e vendlindjes sime, në malet e ashpra e krenare, në malet e dashura, në malet kryengritëse të Kurveleshit. Ndjeja në vetvete një dëshirë për veprim. Më ishin grumbulluar energji të reja, besim i ri për të shkuar drejt çështjes sonë përpara. Isha në mes të bashkëfshatarëve të mi, në mes të kurvelehasve që i njihja dhe më njihnin. E dija hallin e secilit; kujt i kish mbaruar thesi me miell dhe s'kish bukë për darkë, tjetri priste i tmeruar se nëpër fshatra do të shkonte taksildari dhe do t'i sekuestronte gjithshka; kush do të përcillte me lot në sy djalin e vëtëm për në ushtëri.

Dhe të gjitha këto, kënga popullore i ka shprehur me dy vargje plot sintezë madhështi e dhëmbje:

O ju male me dëborë,  
Pse s'qani hallet e mia!

Varfëria dhe liria kanë qënë bashkudhëtarë të përjetshëm në këto male. Ato e kanë duruar var-

fërinë, po s'kanë duruar dot robërinë. Me të ardhur në Kurvelesh, së bashku me shokun Ali Lala, morën me një herë lidhje me organizatën e partisë në Vlorë. Takimi bëhej në dyqanin e një kosshitësi, pranë shtëpisë së Jani Zaharisë.

Në bazë të udhëzimeve të marra, shoku Ali Lala do të punonte në Kurveleshin e poshtëm, ndërsa unë në Kurveleshin e sipërm dhe do të mbaja lidhje në të njëjtën kohë, dhe me organizatën e partisë të Gjirokastrës. Në çdo 15-20 ditë raportonim në qëndrat e caktuara rreth aktivitetit të zhvilluar, rreth gjëndjes së krijuar në popull dhe mernim vazhdimisht udhëzimet e nevojshme se si duhet të vepronim më tej.

Udhëzimet e partisë në këtë kohë ishin, që duhej zhvilluar një punë propagandistike kundra qeverisë fashiste dhe veglave të tyre të verbëra, t'i tregonim popullit se e vetmja rrugë shpëtimi ishte kryengritja e armatosur, se nuk duhej t'i bindej autoritetet e fashiste, djemtë të mos shkonin ushtarë, të mos visheshin milicë, të mos ipnin taksa e xhelepe, të grumbullohen armë në pikat e fshehta etj, të popullarizohej Bashkimi Sovjetik si shteti i vetëm i punitoreve dhe i fshatarëve, si shteti i popullit dhe i të varfërve.

Dhe barinjtë nëpër male, të rinjtë nëpër dasma dhe gosti, duke u frymëzuar nga vija e partisë Komuniste shqiptare, kishin filluar të këndonin këngë të rea:

**Flamur, të mbuloi zia,  
Që kur erdhi Italia,  
Të vuri spatat e tia,  
Me gjak do t'i heqë rinia!**

Dhe rinia ish ajo forcë e re revolucionare që po shpërthente më të katër anët e Shqipërisë.

Në Kurvelesh pothuaj se në çdo fshat po propagandohej kundër fashizmit. Vëndlindja ime, Gusmari, ish dhe qëndra e nënprefekturës. Aty ish vendosur gjithë administrata fashiste. Për këtë arësy edhe puna agitative dhe propagandistike ish më e vështirë, po dhe më e nevojshme.

Bashkë me Ferik Dukën kisha hapur një dyqan. Këtë dyqan nuk e kisha hapur për tregëti, po sipas këshillave dhe udhëzimeve të shokëve, ai dyqan do të shërbente si qendër takimi me njerëzit më të mirë, për të punuar pa rënë në sy. Në fillim nisëm punën duke i kapur veç e veç njerëzit me të besuar e patriotë. Po më vonë, jo vetëm që arri-tëm të formonim grupe, po edhe numri i atyre që agjitonin në popull po shtohej. Grupe të tillë agjitorësh e propagandistësh u ngritën pothuaj në të gjitha fshatrat e Kurveleshit. Në Progonat, me shokë si Dalip Haxhiu, Godo Goxhiu e Hiqmet Haxhiu, në Nivicë e Rexhinë me shokë si Fejzo Dalipi, Dalip Tareja e Sinan Liza; në Vermik me shokë si Difo Braka, Bejo Çiraku dhe Jazo Kashta; në Golem, me shokë si Izet Nikollı, në Kaparjel me shokë si Riza Bizhga; në Lekdush, me shokë si Haqo e Xhelo Iljazi, etj. Ashtu edhe në Kurveleshin e poshtëm, me punën e partisë, që bënte shoku Ali Lala, kishte krijuar aktivistët e parë, sidomos në Kuç me: Bajram Kovarfin, Halit Bishën, Shaban Idrizin, Bame Mersinin etj. Këta me shokë të tjerë shpërndanin trakte, këngë revolucionare, propagandonin për të mos paguajr xhelepet e të dhjetat, për të mos shkuar ushtarë në shërbim të fashizmit. Veç kësaj, me anë të këtyre shokëve u grumbulluan armë dhe u

fshehën në vende të përshtatëshme. Dhe përfundimi i kësaj propagande qe i shkëlqyer. Që në vitin 1942 pjesa më e madhe e djemve të Kurveleshit, sidomos e Kuçit dhe e Nivicës, nuk shkuan ushtarë. Taksildarët ishin urdhëruar të vinin formalisht në këto fshatra, megjithëse e dinin se taksat nuk do t'u paguheshin dhe ata nuk do të ishin në gjendje të merrnin asnjë kundërmasë. Brenda një kohë shumë të shkurtër taksildarët, këta gologlë të fshatarëve, që u rrëmbejn edhe kusitë kur s'kishin si t'i lanin taksat, tashti ishin katandisur si pula të lagura.

### **Si u ngriten Këshillat e para të kuqe**

Nga fundi i shkurtit 1942, erdhi i dërguari i partisë militanti i shquar Mustafa Matohiti. Në Lajthizë të Gusmarit u organizua një takim i fshehtë. Me Mustafanë kishin ardhur dhe Bexhet Mema e Ali Lala. Mustafai vuri në dukje se sipas udhëzimeve të partisë kish ardhur koha për të ngritur këshillat Nacional-Çlirimtare në çdo fshat ose, siç u quajtën atëhere, «Këshillat e kuqe». Tani në çdo fshat të Kurveleshit lëvizja kish përkrahësit e saj. Po me ngritjen e këshillave puna do të merrte një formë më të organizuar dhe do të zëvëndësonim kryepleqësitë për të fituar sa më shumë influencë në popull. Mustafai, duke çmuar drejt rrethanat, duke parë dhe pengesat që kish pasur më përpara gjatë ngritjes së këshillave në disa fshatra si në Kuç, Kallarat e Bolenë, tregoi se ku duhej të mbështeteshim në punën tonë dhe çfarë masa duhej të ndërmerrnim për të mposhtur qendresën dhe

pengesat që do të hasnim. U caktua udha që do të bënim: do të fillonim me fshatin e Progonatit dhe do të kalonim në Lekdush, Gusmar, Rexhinë, Nivicë duke mbaruar në fshatin e Vërmikut. Më kujtohen disa episode kuptimplotë dhe pikërisht ajo që kish parashikuar me mprehtësi Mustafai se ne nuk do t'i ngrinim këto këshilla duke kaluar nëpër një rrugë të shtruar. Armiku e ndjente se pakënaqësia në popull po shtohej, dhe pushtonjësi egërsohej çdo ditë e më shumë, frikësonte njerëzit e përpinqej të koruptonte, nëpërmjet njerëzish që u shkonte fjala në fshatra, njerëz të Lëvizjes, patriotë, etj.

Në fshatin Progonat plani ynë dështoi. Shkuam në dyqanin e fshatit, pronarin e të cilit, Mustafai e njihte. Duke shpresuar se do të gjenim përkrahje tek ai njeri, kishim menduar që mbledhjen ta bënim në shtëpinë e tij. E kërkuam të dilte jashtë. Mustafai i tha dyqanxhiut se «sikurse je edhe ti në dijeni, edhe në Progonat, si në të gjitha anët e Shqipërisë, ka filluar lëvizja antifashiste. Menduam që sonte të bënim në shtëpinë tënde me burrat më të ndershëm të Progonatit, me njerëz patriotë e liridashës, një mbledhje, ku do të flasim për një organizim më të mirë të punës. Të mblidhemi për të ngritur këshillin», përfundoi ai.

Dyqanxhiut filloi t'i ndërrohej fytyra. Mustafai e vuri re dhe e pyeti me atë zerin e tij të qetë:

— E, ç'mendoni?

— Jam njeri me fëmijë, Mustafa, mos më ngatërro me këto punë. Këto mund të më sjellin shumë halle mbi kokë.

— Ata që do të vijnë në këtë mbledhje do të janë njerëz të njobur, progonatas, dhe prej tyre nuk

do të vijë asnje e keqe, — ndërhyri Bexhet Mema.

— A mund ta bëjmë këtë mbledhje në një shtëpi tjetër? — pyeti Mustafai. Dyqanxhiu filloi të fliste përsëri me një lloj emocioni.

— Po deshët, mua mos më ngatërroni me këto punë. Ju thashë që jam njeri me fëmijë.

Disa nga shokët tanë propagandistë nuk ndodheshin në fshat. Kështu që ne menduam se, për t'u përgatitur një mbledhje e tillë duhej ende të kalonte një farë kohe. U ndamë me dyqanxhiun duke i thënë që të mos ishte aq i frikësuar dhe e porositëm që biseda jonë të mbahej e fshehtë.

Po në fshatrat e tjerë puna na shkoi mbarë. Po atë natë shkuam në Lekdush dhe ngritëm atje këshillin dhe njësitin gueril. Pastaj kjo punë vazhdoi edhe në fshatrat e tjera të Kurveleshit të Sipërm.

## Një gasti politike

Për të ngritur këshillin në Gusmar vepruam në këtë mënyrë: Unë arrita më përpara. Më pas erdhën Mustafai e Bexheti. Gjoja ne sikur takoheshim rastësishët dhe për të parën herë unë i ftova në një gasti familjare ku ftoja edhe disa bashkëfshatarë të mi. Kjo ish mënyra më e mirë që të mos linim asnje dyshim në autoritetet e nënprefekturës se po organizonim një mbledhje të dyshimtë.

Në atë «gosti» thirra gjithë njerëzit, me të cilët kisha biseduar që më përpara dhe që e dija se ishin përkrahës e aktivistë të luftës sonë, si Ferik Dukën, Fuat Iliazin, Dak Gumenin, Gani Miten, Ajas Goron, doktorin e nënprefekturës, etj.

Ish shtruar tryeza. Unë mora gotën dhe, si i

zoti i shtëpisë, mirseardha gjithë miqtë. Si kaloi një kohë, u thashë të pranishmëve se Mustafa Matohiti do të na fliste për gjendjen politike dhe për detyrat që i dilnin popullit tonë dhe çdo shqiptari në luftën kundër fashizmit.

Mustafai tha se gjithë të pranishmit ishin njerëzit më të mirë e më patriotë të fshatit, se ai takim në shtëpinë e Selman Çelit nuk ish i zakonshëm, si mund të bëhej me rastin e ardhjes së ndonjë miku. «Çështja e çlirimt të atdheut tha ai është sot në rend të ditës, është një çështje e gjithë popullit, e gjithë patriotëve dhe njerëzve të ndershëm, është pra, edhe një çështja jona. Dhe përkëtë sonte jemi mbledhur këtu. Ju jeni në qëndër të nënprefekturës dhe pikërisht këtu, ku armiqtë nuk e presin, na duhet të bëjmë punën më të madhe. Po që të organizohemi më mirë, mendojmë të ngremë këshillin, siç është bërë dhe në disa fshatra të tjera, si në Kuç e Kallarat, Bolenë». Pastaj Mustafai foli për kryengritjen e armatosur, për Partinë Komuniste që ishte një parti e të varférve kundër fashistëve, bejlerëve e agallarëve gjakpirës. Mustafai tregoi shumë hollësi se si ishte organizuar shteti i parë i njerëzve të thjeshtë në botë, shteti i punëtorëve dhe i fshatarëve, Bashkimi Sovjetik. «Këshillat dhe njësitet guerrile do të jenë baza e kryengritjes së armatosur. U ftoj që të çfaqni mejtimet tuaja për të gjitha këto që po bisedojmë», përfundoi Mustafai.

Të gjithë e kishin dëgjuar fjalën e Mustafait në heshtje të plotë. Ndër disa dukej hapur një lloj shqetësimi. Asnjëri s'po pinte. Mustafai, kur vuri re këtë gjë, mori gotën dhe na ftoi të pinim për-

para se mund të diskutonin, për të krijuar një atmosferë sa më të gjëzuar.

Vetëm Femiu dhe Demiri më hidhnin herë pas here sytë me një lloj qërtimi. Ata të dy unë s'kisha pasur mundësi t'i lajmëroja që më përpara se përsë bëhej mbledhja; prandaj për ta fjalimi i Mustafait ishte i papritur. U bë një farë pushimi përpara se secili të çfaqte mejtimin e vet. Në atë kohë Demiri shkoi në dhomën tjetër, ku më thirri dhe filloi të më qërtonte!

— Më ke ftuar në shtëpi për davet dhe jo për politikë. Unë s'dua të merrem me këto punë se kam hallet e mia.

Ai në fillim desh të largohej fare, po pastaj u pendua. Femiut, që erdhi më pastaj, kishin filluar t'i dridheshin duart, sikur t'i ishin paralizuar.

Pas pak u ulëm të gjithë rrëth tryezës. I pari e mori fjalën Mustafa Ndreu, të cilit më vonë i dolli fytyra e tij prej tradhëtari. Ai tha: — Të mira dhe të nderuara ishin ato që u thanë këtu. Po më duket se s'është koha të bëjmë një luftë të tillë, se një luftë e tillë kundër një fuqie kaq të madhe do të humbasë gjithë milletin dhe s'do të fitojmë asgjë. Pastaj unë mejtoj që të mblidhemi edhe një herë tjetër, që të mejtohemi mirë përpara se të marrim një vendim. — Këtë ide e përkrahу dhe Femiu që foli pas tij.

Doktori tha se kish folur shpesh herë me të zotin e shtëpisë për këto çështje. — «Po ja son te — theksoi — Mustafai e sqaroi punën edhe më mirë. Pra, nuk kemi ç'të presim më. Sa më të nënshtruar që të jemi, aqë më tepër do të na shtohen vuajtjet!

Feriku tha: «Ne nuk duhet të trëmbemi nga

armiku. Edhe do të digjemi, do të vritemi. Dasëm pa mishra s'ka. Këto që u thanë këtu nuk i kemi dëgjuar për herë të parë. Ne duhet të japim fjalën menjëherë.» Të njëjtat fjalë përsërithi dhe Ganiu.

Pas shumë diskutimesh këshilli u zgjodh me kryetar Fuat Iliazin dhe sekretar doktorin. Komandant i njësitit gueril u zgjodh Ganiu, që ish dhe anëtar i këshillit.

Diçka karakteristike ndodhi edhe në fshatin e Nivicës. Mbledhja do të bëhej në shtëpinë e Dalip Tares. Nivicjotët e kishin marrë vesh se në fshat do të organizohej një mbledhje e fshehtë dhe se kish ardhur një njeri i rëndësishëm që do të fliste kundër qeverisë. Pothuajse kudo kjo po diskutohej, jo vetëm nga ata që ishin ftuar të merrnin pjesë në mbledhje, por edhe nga fshatarë të tjerë. Në këtë fshat njerëz si Veip Runa ishin me influencë dhe si shtëpi oxhaku. Çdo gjë atje vendosej. Mirëpo tashti po ndodhte diçka jo e zakonshme: do të bëhej mbledhje me rëndësi në shtëpinë e një fshatari të varfër, që gjer atëhere nuk ish dëgjuar për asgjë. Andaj kish edhe njerëz që mendonin të vinin apo të mos vinin. Po kishte nga ata që i shtynte kureshtja se ç'do të flitej në mbledhje

Në fillim na erdhën vetëm pak veta. Ora që kishim caktuar, po kalonte. Filluan të vinin njëri pas tjetrit, duke e përligjur vonesën me arësyen të ndryshme. Unë via re se si Dalip Tarja, që do të jetë një nga dëshmorët e parë në Kurvelesh, i shikonte të gjithë me inat.

Mustafai u foli të pranishmëve mbi qëllimin e mbledhjes. Si dhe në fshatra të tjera, disa veta në diskutimin e tyre shprehnin urejtjen kundër fashizmit, po dyshonin në mund t'i bëhej gjë një

fusqie aq të madhe siç ishte Italia fashiste. Bile një folës tha pikërisht këto fjalë:

— Ne e urrejmë Italinë, po që ta ndjekim duhet të bashkohet i tërë populli. Kur të ngrihen të gjithë, edhe ne do të jemi gati.

Po aty për aty plaku gjashtëdhjetëvjeçar, luf-tëtari i 1914-ës dhe 1920-ës, Kanan Malua i u përgjegj me këto fjalë:

— Ne nuk mund të presim sa të ngrihen të tjerrët. Ne e kemi për turp të qëndrojmë në bisht, prapa të tjerëve. Ja, popullin ne e bëjmë. Gjithë fshatarët e Kurveleshit duhet të ngrihen menjëherë më këmbë. Më 1920 ata që e hodhën në det Italinë, ishin më pak se ne. E si të trembemi, pra, ne sot që jemi më shumë dhe kemi një parti që i ka dalë zot vegjëlisë?

Fjalët e xha Kananit bënë shumë përshtypje.

Disa na pyesnin: «Po kush do të jetë në kë-shillë? Ne kemi takuar Veip aganë dhe s'na ka folur për një gjë të tillë».

Dukej se edhe forcat e reaksionit e kishin berë punën e tyre. Diskutimet vazhduan gjer afër mëngjesit.

Këshillat ishin diçka e re dhe e panjohur gjer atëhere. Ato ishin bërrthama e pushtetit të ardhëshëm, autoriteti revolucionar i popullit. Por gjatë ngritjes së këshillave ne pamë gatishmërinë e popullit, patriotizmin e tij, urejtjen kundër fashizmit. Në mbledhjen për ngritjen e këshillit në fshatin Nivicë një grua e thjeshtë labe na pyeti?

— Mor shokë, si do të jetë kjo qeveri që do të na ngrini ju, djema? A do të fitojmë gjë në fakirfukaraja?

Ndërsa xha Velua, një plak i njoħur i fshatit, u ngrit e tha:

— Ju, djem, e kini berë fora, po kini mendjen mos na tradhëtojnë ata të parisë. Se populli i Kurveleshit ka luftuar gjithnjë, po nuk ka fituar asgjë.

Në këto fjalë të këtyre njerëzve të thjeshtë, në dyshimet e tyre, shprehej një e vërtetë e madhe; luftën kundër zaptonjësve gjithnjë e kishin bërë njerëzit e thjeshtë, fakirfukaraja, por në krye kishin ardhur gjithnjë qeveritë antipopullore të parisë, që kishin tradhëtuar interesat e popullit, interesat e kombit. Për herë të parë ndodhë diçka krejt e re që s'kish asnje shemboll në historinë tonë. Dhe ja si u përgjegj komunisti Mustafa Matohiti, bilbil i maleve të Kurveleshit:

— Luftën tonë nuk e udhëheq asnje pari, po Partia Komuniste. Partia Komuniste ka dalë nga gjiri i popullit dhe punon për popullin. Qeverinë e re demokratike në Shqipërinë e re do ta ngremë ne. Edhe ti, Lalo, edhe ti, Xha Veli, do të japësh votën tënde, pëlqimin tënd. Ky këshill që ngritëm këtu sonte nuk është si kryepleqësitë, që mbanin anën e beut e të agait, që na shtypnin me qytën e dyfekut të xhandarit për çdo kundërshtim që bënim. Këshillat do luftojnë armikun, do të ndihmojnë fakirfukaranë.

Dhe si kurdoherë, fjala e Mustafait i ngrinte njerëzit peshë me forcën e saj bindëse, i bënte për vete, u ngallte shpresë, hov revolucionar.

Kështu gjatë vitit 1942 në të gjithë Kurveleshin ishin ngritur këshillat dhe njësitet guerile për çdo fshat. Kryepleqësitë dhe organet e tjera qeveritare thuajse u paralizuan. Praktikisht nuk zbatohet asnje nga urdhrat e qeverisë. Fshatarët nuk pranonin të jepnin taksa, të dërgonin djemtë ushtarë, etj.

## Autoritetet fashiste hidhen në kundërveprim

Autoritetet fashiste, të alarmuara nga kjo gjendje, filluan të kundërveprojnë me shpejtësi. Vetë N/prefekti, Nevrus Taçi, i shoqëruar nga milicë dhe xhandarë, kaloi fshat më fshat, si në Progonat, në Lekdush, në Kuç e Nivicë, duke i kanosur fshatarët që të mos pranonin disa të arsatisur «prishës të qetësisë», të mos e mbanin vesh Mustafa Matohitin, pasi ai ishte «një rebel», pëndryshe do të internoheshin dhe do të merreshin masa edhe më të rrepta. Veç kësaj, organizoi edhe një mbledhje më kryepleqtë dhe anëtarët e pleqësive, në të cilën erdhi dhe foli vetë prefekti i Gjirrokastrës. Ai i paraqiti partizanët si fëmijë të papjekur, si «rebelë», «prishës të qetësisë», «sinqerëz që rrëmbehen e s'i kuptojnë gjërat drejt». Po nga ana tjetër u hoq sikur i vinte keq për ta, pasi ata ishin «djemtë tanë», prandaj duhej t'u flisnin që «të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre».

Prefekti mejtonte se kishte të bënte me njerëzit e tij, kurse, pjesa më e madhe e atyre që ishin në mbledhje, ishin anëtarë të këshillit dhe të njësive tevere guerile.

Njeri nga ata, Magrip Bana, u ngrit e tha: — Partizanët na thonë të mos u mbajmë vesh qeveritarëve, pasi ata janë shitur te të huajt dhe bëjnë punën e atyre; kurse ju, zoti prefekt, thoni se jini patriot. Atëhere armatosni popullin dhe, nëqoftëse partizanët janë kundër atdheut, nuk do t'i vrasim me duart tonë!

Sigurisht zoti prefekt nuk do ta kish marrë

kurrë guximin të armatoste popullin e Kurveleshit, të cilit ja kish frikën gjer në palcë, sepse ai e dinte që grykat e atyre armëve do të drejtoheshin kundër tij. Veçse ai herë vishte lëkurën e qëngjit duke shprehur shqetësimin për fatin e «djemve që duhej të ktheheshin në familjet e tyre», herë nxirrte dhembët e ujkut, duke u kanosur se kundër të pëbindurve dhe përkrahësve të tyre do të merreshin masat më të egra.

Gjithshka ishte e qartë. Prefekti ushtronte në popull presion, duke përdorur kanosjet dhe demagogjinë për të frenuar hovin revolucionar, për të futur midis njerëzve panikun, përcarjen.

Në kohën kur bëhej ky presion, gjendja ishte mjaft delikate për ne. Këshillat dhe njësitet guerile apo i kishim formuar; autoritetet qeveritare ishin ende të forta për t'u hakmarrur me popullin, për ta tronditur psikologjikisht. Shumë njerëz ende të lëkundur në bindjet e tyre, do t'i bënte të ktheheshin në anën tjetër dhe të tjerë të tërhiqeshin nga frika. Në këto rrëthana, me Mustafa Matohitin në krye, u mblohdhëm në vendin e quajtur Gërxhi i Sinondresë dhe muarëm vendimin që t'i përgjigjeshim presionit të autoriteteve qeveritare: së pari, duke armatosur këshillat dhe njësitet guerile në çdo fshat, të cilat do të kishin lidhje me njëra tjetrën me pikë të përbashkët takimi në afërsi të nënprefekturës dhe do të ishin të gatëshme në çdo rast nevoje. Këto masa do t'i detyronin milicët dhe xhandarët që të mos vepronin aq lirisht nëpër fshatra dhe do të forconin kurajën në popull; së dyti, duke berë një punë më të madhe propagandistike në popull, do të demaskohej hipokrizia e nënprefektit, do të dilte lakuriq fytyra e tij prej

pseudopatrioti e tradhtari. Për këtë Mustafa Matohiti përpiloi një letër, e cila u shpërnda në gjithë këshillat dhe njësitet guerile të çdo fshati.

Kur autoritetet qeveritare e panë se në «kalamajtë», siç na quanin me mospérfillje, përbënëm një forcë kanosëse me rëndësi, filluan të tërhiqen dhe të kërkojnë të bien me ne në marrëveshje, duke e hequr veten si të arësyeshëm dhe të shqetësuar përfatim tonë e të kombit dhe se gjoja duhej të gjenim një rrugëzgjidhje të përbashkët.

Sigurisht ne nuk pranuam asnje bashkëpunim me ta dhe e dinim se në kohën më të volitëshme ata do ta humbisnin edhe atë pakë «arësy» duke e hequr dhe maskën e pseudopatriotëve.

Në një informacion që i drejtohej prefekturës së Gjirokastrës dhe që njësitet tona ua kapën ato ditë xhandarëve, thuhej «500 partizanë drejtohen nga komunisti Mustafa Matohiti dhe 200 të tjera nga Bexhet Mema». Edhe ky informacion tregonte se çfarë paniku kishte kapur armikun nga lëvizja jonë partizane që në hatap e para të saj.

### Nënprefekti vritet si tradhëtar

Ai që provoi i pari urrejtjen e popullit dhe lau gjynahet për tradhëtinë e tij, ishte kreu i administratës së qeverisë në Kurvelesh, nënprefekti Nevrus Taçi. Çdo ditë e më tepër për zotin nënprefekt «kalamajtë» beheshin më të paduruar dhe ai vetë bëhej më i tërbuar, më i egër, më i pamëshirshëm. Ne, natyrisht, nuk prisnim nga ai asnje të mirë; po, kur filloj të veprojë kundër nesh me aq zell, vetveti kjo e bënte personin e tij edhe më

të urryeshëm, mbi supet e tij akoma më tepër rëndonte mëkata. Me një fjalë, siç shprehej populli, ai na e kish bërë borxh gjysmën e lekut (plumbin).

Një herë ja ç'më ndodhi me të. Ishte ditë qershori. Nënprefekti hyri në kafene dhe të gjithë u ngritën më këmbë. Sa më pa, u drejtua nga unë dhe më shfryu me nervozizëm:

— Ç'janë ata sahanlëpirës që kthyen patrullat e mia? —

— Nuk e kuptoj pér kë e kini fjalën, zoti nënprefekt, — iu përgjegja unë, si i paditur.

— Pér ata sahanlëpirës, — vazhdoi ai me ton përbuzës, — që me një farë Mustafa Matohiti e Bexhet Mema me shokë, na dashkanë të na ngrenë edhe qeveri!

Unë nuk e prisja që ai të përmëndte emra. M'u duk sikur më ra tavani mbi kokë, më hypi gjaku në fytyrë dhe iu përgjegja aty pér aty:

— Sahani lëpirës, zoti nënprefekt, janë ata që hanë makaronat e Duçes dhe jo ata që luftojnë pér çlirimin e atdheut!

As nënprefekti nuk e priste këtë përgjegje, andaj u bë spec në fytyrë. Po, të paktën pér t'u dhënë të kuptionin atyre që ishin të pranishëm se ish një patriot dhe pér të ish një fyerje e rëndë ajo që i kisha bërë unë, filloi të tregojë se kishte luftuar në luftën e Vlorës, më 1920, dhe se Shqipërinë, po të qe nevoja, do ta bënte ai me shokë dhe jo ne. Ai më tha se e dintë me cilin kisha lidhje unë, ku i bënim mbledhjet, çfarë bisedohej në ato mbledhje dhe ish e kotë që të tregoheshë sikur s'kisha asnje dijeni nga ato punë.

Ne vazhduam të shkëmbenim me njëri tjetrin fjalë të ashpra. Nëse në fillim unë kisha parasysh se po bisedoja me një nënprefekt që mund të urdhë-

ronte aty pér aty tē më arestonin, më vonë e harrrova fare këtë dhe flisja zveshur dhe ashtu si duhej t'i përgjigjesha një kundërshtari politik.

— Të hedh prangat që tani!

Kjo qe fjala e fundit e nënprefektit të tèrbuar nga inati. Në atë kohë Riza Runa, një burrë rrëth gjashtëdhjetë vjeç, ndërhyri duke thënë:

— Kini tē drejtë, zotj nënprefekt, këta s'dinë q'është lufta. Këta duan tē bëjnë luftë me dyfëqe e pa fishekë. Këta janë kalamajtë tanë, s'na e mbushin dot as mëndjen, as xhepin. Mos u nevrikos, zoti nënprefekt, ky është fëmija jonë dhe lufta i duket shaka, kurse ne kemi plagë prej asaj që nga 1914 e gjer më 1920.

Nënprefektin e ulën pak këto fjalë ngushëllonjëse, po prapë nuk q'ë ndjente veten tē qetë. Si kisha guxim unë, një kalama, tē grindesha me një nënprefekt? Kjo e ulte autoritetin e tij dhe ai tha se këtë s'do tē ma falte, as mua, as shokëve tē mi. Në këtë mënyrë ai afronte ditën e vdekjes së vet.

Po atë ditë në mbrëmje ne bëmë një mbledhje. Mua më kritikuani shokët, se isha treguar i rrëmbyer dhe, nënprefekti, me fjalët që i kisha thënë, mund tē më arestonte dhe se se pasojat nuk do tē ishin tē mira. Po nga ai dialog i ashpër dilte ana tjetër: nënprefekti i dinte gjithë bazat tonë dhe i njihte shokët tanë. Kjo ish e rrezikshme dhe duhej marrë masa. Veç kësaj, nënprefekti po përgatitej pér tē goditur përkrahësit e Lëvizjes.

— Më tē na ndan vetëm gryka e maliherit! — tha komandanti trim i çetës parë tē Kurveleshit Bexhet Mema në atë mbledhje.

Në bazë tē udhëzimeve tē partisë, u muar vendim që nënprefekti tē vritej si një tradhëtar i at-

dheut e shërbëtor i fashistëve italianë. Dhe një grup shokësh, të drejtar nga Bexhet Mema, në ditët e para të korrikut të vitit 1942, i zunë priti në malet e Progonatit dhe e vranë. Ai aksion i guximshëm bëri përshtypie në të gjithë popullin. Tradhëtarët i kapi vaniku dhe pasiguria, po, n'anën tjetër, fashistët shtuan spiunët dhe veprimtarinë e tyre vërtë të zbuluar bazat tona, anëtarët e këshillave dhe të njësive guerile.

Nënprefekti i ri, gjithashtu e hiate veten si patriot. Ai duke pasur të freskët shëmbullin e paraardhësit të tij, më niérën anë, u nërpoo të vinte me ne në marrëveshje dhe pranoi kushtet tona që të mos i merrte popullsisë taksa xhelen, të dhjetën, të ndaloheshin arrestimet, internimet dhe të kthehei familia e Dalip Tares nga internimi. Po, më anën tjetër, në Kurvelesh kishin ardhur vërforcime me milicë, xhandarë, karabinierë. Nëpër fshatraarkullonin spiunë dhe ne nuk mund të mos ishim vigilentë kundrejt këtyre masave. Ne ishim të sigurtë se, navarësish nga ndoni lëshim që mund të bënte, nënprefekti i ri, vërtë demagogji, ose i detvruar nga rrethanat, në rastin më të parë, do të përpjegjë të shtypte lëvizjen partizane në Kurvelesh më forcën e armëve...

Në Gusmar, qëndër e nënprefekturës, kish ardhur spiuni fashist. Shefqet beu. Ai propagandonte plot urrejtje kundër Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, villte vrer kundër komunistëve. U muar vendimi që të vritej. U caktua njeriu dhe koha kur do të bëhej atentati, pikërisht në qëndër të nënprefekturës. Miku, ku flinte beu, ishte simpatizant i ynë. Ai ish porositur të largohej dhe beu të mbetej vetëm në çastin që do të qëllohet. Po beu spiun, si

duket, diçka nuhati dhe nuk iu nda për asnjë çast të njohurit të tij dhe atëntati dështoi, mbasi ish rrezik të merrte ndonjë goditje dhe simpatizanti ynë. Beu do të ikte të nesërmen, duke kaluar nga Shuri i Gusmarit. Atje mund të egzekutohej me lehtesi. Po Shefqet beu, si dhëlpër e vjetër, na që veshur si grua dhe na kaloi në pritë pa u dalluar dot. Ne, duke pritur beun, pamë të vijnë afro pësëdhjetë milicë e xhandarë, të cilët shoqëronin nënprefektin, komandantin e milicisë, të xhandar-marisë dhe kryetarin e komunës që shkonin për në Kuç. Kjo ish për ne e papritur. Vendosëm, me shokun Sali Tare, të qëllonim dhe të vrissnim komandanatin e milicisë, i cili sillej i egër me popullin. Po edhe ai u shpëtoi plumbave dhe në vend të tij u plagosën dy milicë.

Ne u zemëruam me veten tonë që na shpëtoi gjahu, por nga ana tjetër, na erdhi për të qeshur kur pamë sesi ua mbathën këmbëve të gjithë xhan-darët e milicët, me eprorët e tyre në krye, pa bërë as më të voglën qëndresë.

Kur u kthyem në mbrëmje, në qendër të nën-prefekturës, gjëndja ishte e alarmuar. Kishte ardhur lajmi që ishin qëlluar autoritetet e vendit në Shur të Gusmarit dhe milicët e xhandarët kishin grumbulluar thuajse gjithë burrat e i mbanin nën vrejtje. Disa që ishin farë e fis me partizanët i kishin arrestuar. Flitej se do të vinin forca të mëdha nga Gjirokastra e Tepelena; do të bëheshin inter-nime e arestime në popull, etj.

Ne, po atë natë, shpërndamë traktet, ku i bë-nim thirrje popullit të mos frikësohej nga kanosjet e armiqve, të përkrahte bijtë e tij që luftonin përlirinë dhe pavarësinë kombëtare.

Gjithashtu, më të dalë të fshatit Lekdush, gjatë udhës për në Tepelenë, në Gexhun, një vend i thepisur plot kthesa e shkëmbinj, i zumë pritë postës së nënprefekturës. Pas një qëndrese të vogël, kabinierët u dorëzuan. Në informacionin e përgatitur për prefekturën e Gjirokastrës thuhej se në Kurvelesh vepronin 1000 partizanë. Edhe xhandarët, të udhëhequr nga komandanti i xhandërmarisë, kapiten Ndëre Pali, që vinin nga Tepelena në ndihmë të nënprefekturës së Gusmarit, kur dëgjuan krismat e pushkëve në Gërjhun, u kthyen në panik përsëri nga ishin nisur.

### Autoritetet në panik

Po gdhihej dita e 6 nëndorit të vitit 1942. Aksionet tonë kishin bërë përshtypje në të gjithë Kurveleshin. Atë ditë, për të frikësuar popullin, autoritetet qeveritare kishin lajmëruar se do të bëhej një mbledhje në qendër të nënprefekturës. Do të vinin burra nga të gjitha fshatrat. Flitej se do të arrestoheshin 70 veta, do të internoheshin 30-40 tamilje. Një fshatar, me të takuar Mustafa Matohitin, filloj t'i bëjë fjalë për ato që fliteshin.

— Do të merret më qafë populli. Ne kemi më tepër hallin e fëmijëve se sa tonin; — vazhdonte të fliste fshatari.

Mustafai e dëgjonte me një buzëqeshje të hidhur. Pastaj nisi t'i flasë me një ton të qetë e të sigurtë:

— Tani fashistët kanë frikë për kokën e tyre. Askush të mos trembet. Ata nuk do të kenë guxim as të arrestojnë dhe as të internojnë njeri. Ata e dinë se çfarë i pret po hodhën dorë mbi burrat,

gratë dhe fëmijët e Kurveleshit. Nuk e kanë harruar se si u ndëshkua nënprefekti, çfarë pësuan xhandarët në Shur të Gusmarit, në Gërxhun etj. Mos u trëmbni, nga kjo propagandë frikësimi, po u qëndroni fashistëve dhe sahanlëpirësve të tyre me grusht përrpara turinjve.

Dhe pikërisht ne iu përgjegjëm fashistëve ashtu siç tha Mustafai me grusht turinjve.

Zërat se do të bëheshin internime, arestime, sekuestrime të pasurisë përhapeshin nga njerëz në shërbim të fashizmit. Kjo dëshmohet edhe nga disa prej dokumentave të prefektit të Gjirokastrës, të kuestorit dhe të nënprefektit të Kurveleshit, me datat 20 - 8 - 42 dhe 11 - 11 - 42, në të cilat thuhet: «të punohet me popullin e Kurveleshit se masat që duhet të merren janë të nevojëshme», «të fillojë arestimi i familjeve, i personave, të digjen banesat, të konfiskohet pasuria e luejtëshme dhe e paluejtëshme e këtyre personave: në Kuç, e Veledin Z. Banushit e Abdul Hakiut e Memo Metos e Ali Zenun Lalës; në Gusmar e Ago Çelës; në Bolënë e Ali Dalanit e Maze Rrapushit. Nga këta, ata që do të dorëzohen të përjashtohen nga masat.»

Këto urdhëra iu dhanë kapitenit të xhandërma-rië Ndue Palit që të vinte në Kurvelesh e t'i vinte në zbatim, si edhe administratës së nënprefekturës së Gusmarit.

Nënprefekti i ri, që zëvëndësoi nënprefektin që u vra, Selaudin Çabej, në këtë kohë thotë: «Njoftoj qeverinë që mos të preokupohet me gjëndjen e këtushme, se nga masat që do të marrim do të sigurojmë qetësinë». Po ky nënprefekt, imbas tri ditësh, më datën 23/8/42 thotë: «Janë duke u zhvilluar mbledhje të përgatitura nga komunistët këtu, por

duhet sinjalizuar dhe Vlora e Korça, që të mos zgjerohet kjo veprimtari subversive». Siç duket, në filim ishte plot entusiazëm se u bë nënprefekt nga sekretar dhe se ai çdo gjë do ta rregullonte.

Prefekti i Gjirokastrës, me datën 8/9/42 i thotë qeverisë: «Duhen marrë veprime të shpejta me efikasitet për paralizimin e kësaj organizate, prandaj dërgoni forca, se, sikurse dihet nga pikëpamja e qetësisë, vëndi më delikat i këtij qarku është Kurvelesh. Ky vënd paraqet rrezik nga komunistët e Vlorës dhe të Gjirokastrës».

Po në këtë kohë ky tradhëtar kërkoi ndihmën e shumë njerëzve që u shkonte fjala të dërgoheshin në Kurvelesh për të përçarë Lëvizjen nacional-çlirimtare, andaj u dërguan Zenel Beu e Shefqet Beu nga Kuçi, Bilal Nivica, Veip Runa nga Nivica.

## Armikut i digjen planet në duar

Po edhe këto plane qeverisë tradhëtare lëvizja nacional-çlirimtare në Kurvelesh ja dogji në duar, duke marrë masa të njëpasnjëshme kundër spiunëve dhe agjentëve të qeverisë. U vendos ndër të tjera, të vritej edhe Gani Shehu, spiun i regjur, armik i tërbuar i lëvizjes, që kohët e fundit ish hedhur në një aktivitet të pa përbajtur për të futur panikun midis njerëzve, për të zbuluar njerëzit tanë, për të diskredituar komunistët, etj. Aksionet e njëpasnjëshme, brënda tri ditëve i çorientuan milicët, xhandarët e spiunët. Më përpara në Kuç ishin vrarë Jupe Ibrahimini dhe një spiun tjetër, në Bolënë,

Safet Selimi. U vendos që spiuni të vritej ditën midis njerëzve. Atentatin do ta kryente Krokodili (pseudonimi i Hekuran Pobratit).

Midis një grumbulli njerëzish, në fshatin Rexhin kur po preqatiteshin për të ardhur në nënprefekturë, Krokodili nxori revolen dhe iu drejtua Gani Shehut, me fjalët: «në emër të popullit je dënuar me vdekje si spiun e tradhëtar».

Koha dhe vëndi ku u krye atentati nuk ishin mjaft të përshtatshme dhe një sipërmarrje të tillë mund ta kryente vetëm një trim i tërbuar, siç ishte Krokodili. Megjithatë edhe ai u vu në rrezik, pasi iu desh të kalonte midis xhandarëve e të afërmëve të spunit. Aty ishte edhe aspirant Daut Runa me 30 xhandarë. Ata iu ngjitën pas duke e qëlluar hap pas hapi. Krokodili arriti tek ne që e prisnim më të dalë të fshatit me gjysmëfryme. Mustafai e pushtoi në krahë dhe e puthi në ballë. Ne u dolëm përpara atyre që vinin me pushkë në duar, zumë pozicionë dhe qëlluan vetëm një herë, që ata të ndaleshin. Ne ishim vetëm pesë veta, kurse kundërshtarët tanë e kalonin numrin 100. Nënkuptohet që duhej gjetur mënyra për t'u tërhequr.

Më e keqja ish se në këtë përpjekje po merrnin pjesë edhe disa fshatarë të gjenjyer nga nxitja që u bënë agjentët e qeverisë se gjoja kishin vrarë njeriun e tyre dhe kjo, sipas zakonit të trashëguar, ish turp për ta që kishin qënë të pranishëm në atë ngjarje. Në radhë të parë ishte një mospërfillje përtta. Po, në përgjithësi, fshatarët e dinin kush ishte spiuni Gani Shehu; kush mund të organizonte aty një atentat dhe përsë bëhej ai atentat. Sidoqoftë, duhej krijuar një farë kohe për t'u larguar Mustafai, pasi ne kishim udhëzime që jetën e tij ta ruat-

nim me çdo kusht; (ai vuante nga mushkëritë dhe herë pas here villte gjak).

Është e vërtetë se Mustafai e kishte parashikuar që do të krijohej një situatë e tillë kritike. Ai na pat thënë se, duke e vrarë spiunin në mes të fshatit në orën 10 të ditës, elementët armiq do të përpinqeshin të shfrytëzonin zakonet patriarchale për të nxitur kundër nesh njerëzit e thjeshtë. Andaj kish propozuar që atentati të kryhej në kushte të tjera; por ne ngulmë këmbë që të kryhej dhe ai na u bind.

Fshati Rexhin është mjaft afër Gusmarit, 20 minuta më këmbë prej qendrës së nënprefekturës. Milicia dhe xhandërmaria që arrinin përmbi 300 vëta, kur dëgjuan krisma pushkësh, filluan të rrethojnë nënprefekturën dhe nuk guxuan të vinin në vendin e ngjarjes. Megjithëatë Sali Tarja e zuri shtegun nga mund të na vinin forcat qeveritare pas krahëve dhe të na vinin në rrezik të madh. Mustafai, edhe pse villte gjak, çohej dhe na jepte zemër:

— Mos u trembni: sado shumë që të jenë, ata s'guxojnë të afrohen. Shikoni se ç'tmer dhe panik i ka kapur; ne jemi 5 veta dhe ata 100.

Ne mundëm të tërhiqeshim; po njeri nga shokët tanë, Dalipi, na u shkëput. Në atë gjendje ishte tepër e vështirë të viheshe në lidhje me të, të merrje vesh ku ishte. Ne u ngjitëm në mal. Aty në Qafë të Serës kaluam edhe natën. Ishte një natë e bukur, siç janë netët tonë në male, me ajër të freskët, me qiell të kaltër e të kulluar.

Po të nesërmen me hidhërimin më të madh muarëm vesh se Dalipi na ishte vrarë. Të ndezur nga ndjenja e hakmarrjes, u betuam se do të zbrisnim në fshat dhe do të vrisnim cilindo që të gjenim

përpara. Mustafai ishte po aq i hidhëruar për humbjen e Dalipit. Ai na tha: «shokë si Dalipi janë martirë të atdheut, shëmbëll fryshtëzimi dhe krenarie për ne që kemi rrokur armët pér çështjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut. Ne betohemi se do t'ja marrim hakun. Po ne edhe në këto çaste hidhërimi dhe urrejtjeje, do të dimë të dallojmë armikun e vërtetë, do të dimë ta ndajmë atë nga populli, pamvarësishët se, në raste të caktuara, pas tyre mund të shkojnë dhe njerëz të thjeshtë, të frikësuar, të gënjer ose të ngacmuar nga ndjenjat e tyre patriarkale të besës.»

Mustafai të gozhdonte me logjikën e tij të fortë, me qartësinë e madhe politike.

Nga vëndi ku ishim ne dukeshin fshatrat. Duke parë këtë pamje, Mustafai me fryshtëzin e një poeti na thoshte:

«Këto male janë shumë krenare. Edhe populli që mbajnë në gjirin e tyre është trim, liridashës, me tradita të lashta, të lavdishme. Kanë luftuar brez pas brezi kundër çdo lloj armiku. Janë vënë të vriten me njëri tjetrin, kanë rënë viktima të zakoneve prapanike, të paditurisë dhe skamjes, viktima të pseudopatriotëve, të parësisë. Ne, bijtë e tij, do të ngremë një jetë të re në këto male, do ta zhdukim varfërinë, do t'i bëjmë njerëzit të jetojnë të lumtur, të barabartë, të lirë. Sot jemi pak, po nesër do të bëhemë më shumë, pasnesër edhe më shumë akoma. Ju e patë sa frikë na patën armiqtë edhe në një përpjekje të pabarabartë.

Aqë frikë kishin marrë forcat e xhandërmarisë dhe të milicisë sa që kur disa fshatarë u kishin thënë se ne nuk qemë më tepër se 5 veta, ata arritën t'i cilësonin ata fshatarë si «bashkëpunëtorë

tanët, që përhapnin në popull lajme të rreme përtë hedhur në kurth forcat qeveritare» dhe i ares-tuan.

## Në Kurvelesh të poshtëm merr fund pushteti fashist

Po atë natë ne dëgjuam të binin pushkë nga Kurveleshi i poshtëm, nga fshati i Kuçit. Pastaj plasën bomba. Dukej se po luftohej. Krismat e pushkëve dhe të bombave binin në mes të fshatit. Pastaj u ndez një zjarr i madh dhe të shtënët pushuan. Në letrën që na dërgonte Memo Metua pak më vonë, na njoftonte se në Kuç ish pushtuar posta dhe komunja. Në fshatin e Kuçit mori fund pushteti fashist. Shkëndijën për këtë aksion e kish dhënë arrestimi, nga komandantë i postës së karabinerisë, i shokëve Ali Lala dhe Velestin Zeka. Thirrjen përtë liruar shokët e burgosur, kapteri, një fashist i bindur e hodhi poshtë. Ai mbështetet në forcën e bajonetave të karabinerëve dhe të njëqind milicëve. Atëhere, pa humbur kohë, u grumbulluam të gjithë anëtarët e njësitet gueril dhe populli; u tretuan posta dhe qëndra e komunes. Tetëdhjetë milicë përparrë rrezikut të jetës së tyre u dorëzuan menjëherë, burgu u hap, shokët u liruan. Vetëm komandanti i postës me njëzet veta nuk pranoi të hidhte armët. Atëhere postës iu vu zjarri, lokali u dëgj krejt dhe çdo qëndresë mori fund.

Armiku çdo ditë ndodhej para të pa priturave. Prej aksioneve tonë të njëpasnjëshme, në vende të ndryshme, autoritetet kishin formuar bindjen se

në Kurvelesh po vepronin forca të mëdha. Ata nuk e kuptonin se forca jonë nuk qëndronte te numri, që ish ende i vogël, por te vendosmëria jonë për një çështje të madhe, te përkrahja që kishim në popull.

Mbas dy ditësh Memua ardhı dhe u takuam me të në Shur të Gusmarit. Mustafai, me që s'ish mirë nga shëndeti, u largua në një bazë të fshehtë.

Në mbledhjen që u bë në shtëpinë e Bame Mersinit, Memo Metua na foli rrëth gjendjes që ishte krijuar. Ai kish marrë udhëzime të hollësishme nga Mustafa Matohiti.

Djegëja e postës, prishja e komunes në fshatin Kuç ish një aksion mjaft i rëndësishëm, që tregoi se në Kurvelesh autoritetet qeveritare e kishin bazën shumë të dobët. Me t'u dhënë kushtrimi, fshatarët ishin ngritur më këmbë dhe bashkë me njësitin gueril i kishin detyruar të njëqind xhandarët të dorëzoheshin.

Tani na shtrohej detyra që të mos lejohei të ktheheshin përsëri komuna dhe posta e xhandërmarisë. Për këtë duhej të qëndronim vigjilentë, pasi fashistët mund të sulmonin në çdo rast.

Gjithashtu duhej të hidheshin poshtë me forcë parullat e panikut që përhapeshin nga parësia e fshatrave, nga njerëz të gënjiyer, të frikësuar, ose që bënin punën e armikut, se «ishte e udhës që të bëhej kompromis me qeverinë», «të lejohej të kthehej përsëri posta dhe komanda në fshatin e Kuçit», ose «kur të vinin forcat e milicisë e të xhandërmarisë, të mos priteshin me luftë». Ish hapur dhe fjalë se «po përgatitej një operacion ndëshkimor kundër Kurveleshit; forca të mëdha ushtarake do të vinin nga Borshi, nga Çorraji. Partizanët do të arrestohe-

shin. «ata që kishin strehuar do të internoheshin». Dhe parulla të tjera si këto, që kishin për qëllim të çorientonin dhe të frikësonin popullin.

Mbledhja vazhdoi gjer vonë pas mesnate. Atëhere të gjitha mbledhjet, të cilat organizoheshin me fshehtësinë më të madhe, zgjatnin shumë. Zakonisht flisnin që të gjithë me radhë dhe ndodhë që për ndonjë problem të kishte mendime të ndryshme. Atëhere diskutimet bëheshin më të zjarrta, por gjithmonë dilnim nga mbledhjet me një vendim të prerë, të detyrueshëm për të gjithë.

Në rrethanat e krijuara vodosëm që të shtojmë tepër nëpër fshatra punën sqaronjëse me popullin, të hidhним poshtë parullat që përhapeshin nga elementet armike. Tani që kishim kryer disa aksione njërin pas tjetrit dhe në autoritetet qeveritare ish krijuar pasiguri dhe panik, ne duhej të vazhdonim të mbanim në dorë inisjativën; të kishim forcat kurdoherë gati për të përballuar çdo të parpritur, të armatošnim popullin me armët që i kishim zënë armikut. U vodos gjithashtu që të gjitha njësitët të vazhdonin aksionet: t'u, bëhej pritë forcave armike, që thuhej se do të vinin nga Çorraji e Borshi. Dhe kështu u be. Ne dolëm dhe pritëm armiqtë me forca të armatosura, po ata s'erdhën. Atëhere u kthyem përsëri nëpër fshatra për të vazhduar punën në popull.

## Venua dhe xha Magripi: Figura tipike labe

Nuk do ta' harroj kurrë Venon, gruan labe me virtute të larta, fisnike, të zgjuar, trime. Kur qemë kthyer unë dhe pesë shokë nga Kurveleshi i poshtëm, ishim vendosur në një stan. Fatua, një aktiviste e Lëvizjes, kryetare e Organizatës së Gruas Antifashiste e fshatit Gusmar, ish ndërlidhësja jonë. Nga fshati ajo na binte bukë dhe gjellë, si përgjithë barinjtë e tjerë. Fatua kish dhe një shoqe, Venon, e cila ishte nuse e re, një vajzë esmëre, me një trup të hedhur, me sy të bukur, të zez.

Ne letrat ja jepnim Fatos dhe ajo i conte në bazat tona. Me këto letra, ne viheshim në lidhje me shokët tanë, u jepnim udhëzime, i sqaronim si duhej të vepronin në raste të ndryshme; kurse ata na vinin gjithashtu në dijeni për lëvizjet e forcave armike, për gjëndjen e krijuar, etj.

Në ato kohë, ky letërkomëbim bëhej në mënyrën më të fshehtë. Konspiracioni ishte një çështje e rëndësishme, që duhej mbajtur nga të gjithë shokët me rreptësi.

Venua ishte shoqe e Fatos. Por, megjithëse ajo na dinte që ishim partizanë, ne më tej nuk i hapeshim për asgjë. Edhe ndërlidhësja jonë ish porositur që të mos i thoshte askujt, për asgjë. Veç në vrenim se si Venua kish dëshirë të dëgjonte bisedat tona. Ajo trishtohej kur na shihte të lagur nga shiu dhe, bashkë me Faton, na sillte ndërresa nga fshati, duke u kujdesur për ne si për vëllezërit e saj. Por erdhi rasti kur Venua me zgjuarsinë e saj të rallë, na shpëtoi nga një vdekje e sigurt. Po më

þërpara le të tregojmë rrethanat që na çuan gjer në një ngjarje të tillë.

Në bazë të një urdhëri të lëshuar nga xhandërmaria, ish ndaluar natën çdo lëvizie në fshat. Kushdo që do të vepronë kundër këtij urdhëri, do të vritej në vend. Nëpër fshatra qarkullonin patrullat. Pra, ish shpallur një gjendje rrithimi të vërtetë.

Simpatizantët e Lëvizjes mbaheshin nën vrejtje. Ish dhënë urdhër që gjithë ato fshatra, që do të pranonin partizanët do të digjeshin; familjet që do t'i strehonin do të internoheshin; ndërsa partizanët do t'i arestonin. Nëpër popull kish hyrë një farë paniku. Ne duhej pa tjetër të viheshim në lidhje me njerëzit tanë; të demaskonim gjithë atë propagandë dhe, në të njëjtën kohë, të merrnim masa pér të kundërvepruar.

Mirëpo frika ish aqë e madhe sa disa baza u bënин bisht kërkeseve tonë pér të organizuar një mbledhje me gjithë aktivistët e Lëvizjes. Atëhere një pasdreke, kur Fatua dhe Venua, si zakonisht, na prunë ne e barinjve ushqim pér të ngrënë, u thamë aktivistëve: «Sonte natën do të sulmojmë nënprefekturën. Prandaj kërkojmë të vihemë në lidhje, sa më shpejt që të jetë e mundur, me forcat partizane që veprojnë në Progonat, Rexhin e fshatra të tjera.» E vërteta është se ne atëhere nuk ishim të përgatitur ende pér një aksion aq të madh, siç do të ishte një sulm kundër nënprefekturës. Por këjo ishte një manevër e jona pér të frikësuar forcat qeveritare, pér t'i detyruar të hiqnin gjithë masat ndëshkonjëse kundër popullit. Ne e dinim, gjithashtu, se edhe në popull një

lajm i tillë do të bënte një bujë të madhe. Parashikimet tona dolën.

Dhe ja nga fshati tek ngjiten dy gra me shpejtësi dhe të alarmuara. Janë Fatua e Venua. Ato na dhanë shpejt e shpejt tri letra për komandantin e njësitet. Fatua ish shumë e tronditur.

— Do të digjemi, — thosh ajo, — tani në ballë të dimrit! Përfaqësonjësit e fshatrave kërkojnë që të mos ta filloni sulmin pa u marrë vesh me 'ta.

Ndërsa Venua rrinte e qetë. Ajo me të vërtetë duhej të ish një grua trime. Në fund i tha Fatos:

— Edhe kështu nuk jetohet. Fashistët s'na lenë të marrim as ujë në krua. Më mirë të dalim edhe ne bashkë me burrat në mal.

I thashë Fatos të mos frikësohej dhe qe mirë të dëgjonte ç'thoshte shoqja e saj.

U kthyem letrave përgjegje, duke pranuar që, po atë ditë, të bënim një takim me përfaqësonjës nga të gjitha fshatrat. Takimi do të bëhej te Shkëmbi i Sheremetit, një gërxh plot thepa, që kontrollonte gjithë vendin përreth.

Ne mblodhëm edhe disa barinj dhe njësiti u shpërnda gjatë gërxhit në një mënyrë të tillë, që të jepte përshtypjen se ishim shumë veta.

Nga fshatrat erdhën më tepër nga sa parashikonim ne, gati 50 veta. Dhe vërtet ajo mënyrë si ishim shpërndarë atyre u la përshtypjen se ishim shumë. Dy nga shokët tanë, Beqir Gumeni dhe Sali Tarja e lojtën rolin mirë. Ata u thanë se kishim nevojë për ushqim dhe se po të kish ndonjë mundësi për të na ndihmuar, kjo llogari duhej bërë gjoja për 180 veta. Gjithashtu në mes të natës do të vinte gjoja Bexhet Memë me 200 veta. Këto forca ishin më se të mjaftueshme për të marrë

nënprefekturën e Kurvelesiht, me qëndër në Gusmar.

Unë u thashë të pranishmëve: — Forcat partizane kanë vendosur të sulmojnë sonte nënprefekturën. Po më parë deshëm të dëgjonim zërin e popullit. Këtu pothuaj ka përfaqësonjës nga të gjitha fshatrat. Ne kemi dalë nga gjiri i popullit, luftojmë për popullin dhe me popullin, andaj kemi nevojë për mendimin dhe përkrahjen aktive të tij.

Po të gjithë ata që muarën fjalën, kundërshtuan që nënprefektura të sulmohej. Shkaku i parë që paraqisnin ata ishte se në çdo fshat qarkullonin nga 50 xhandarë, përvëç forcave të qendrës. Pra, fashistët, duke e parandjerë rrezikun, kishin grumbulluar mjaft forca. Së dyti, në malet e Kurveleshit po afronte dimri. Ky sulm do të sillte dje-gëjen e fshatrave; familjet do të detyrohen në linin shtëpitë. Dhe kjo do të ishte tepër e vështirë për popullin, që s'do të kishte ku të strehuhej. Së treti, autoritetet qeveritare kishin paralajmëruar se për çdo turbullim që do të shkaktohej nga partizanët, do të merreshin masa të rrepta, do të arrestohen familjet e partizanëve, do të burgoseshin dhe do të internohen, bile, që atë natë thuhej se numri i familjeve që do të internohen ish 70-100. Si përfundim gjithë ata që diskutuan çfaqën mendimin se sulmi kundër nënprefekturës duhej shtyrë gjer në pranverë.

Ish e vërtetë se ne nuk kishim një plan konkret për të sulmuar nënprefekturën atë natë. Dhe as që ishim të preqatitur për një aksion të tillë. Por, siç shihej nga diskutimet, propaganda fashiste, kërcënimet kishin futur edhe në radhët e simpatizantëve tanë frikë dhe një lloj pasigurie në forcat tona.

Duke folur sipas udhëzimeve të partisë, duhej që, pa tjetër, këtë ide të disfatizmit ta hidhnik poshtë, duhej t'u linim të nënkuptonin se jo me rrugën e lëshimeve, po me qëndresë, mund të arrinim që ta shpëtonim popullin e Kurveleshit. Ne bijve të thjeshtë të popullit, partia na kish brumosur me besim dhe optimizëm dhe më kujtohet se iu drejtova me këto fjalë:

— Ju thoni se ne jemi më pak. Fashistët janë më shumë. Po më mirë le t'i llogaritëm. Ata kanë me vete 200-300 xhandarë dhe milicë, kurse ne kemi gjithë burrat dhe gratë e Kurveleshit. Si qëndkanë ata më shumë? Ata që do të luftojnë kundër nesh janë xhandarë dhe milicë, bashibozukë, njerëz të shitur, pa asnje ideal, kurse ne jemi bijtë dhe bijat e prindërve dhe gjyshërvë tanë trima, që jemi ngritur për lirinë e Shqipërisë kundër atyre që kanë ardhur për t'u ulur këmbëkryq në vatrat tonë. Pra, ku e morën zemrën ata bashibozukë të luftojnë kundër nesh?

Disa thanë se po të nisnin luftën, do të na arrestonin, do të na internonin familjet në masë. Po kush nga ne do të qëndronte duarlidhur dhe do t'i lejonte fashistët që të merrnin të atilla masa shtypëse? «Nëqoftëse duam të shpëtojmë popullin e Kurveleshit nga frikësimet, nga arrestimet, nga internimet, nga turpi dhe çnderimi, thashë unë, ka vetëm një rrugë: t'i lajmë hesapet me fashistët, t'i shporrim një herë e përgjithmonë nga malet tanë kreshnikë. Kështu e shtron punën partia komuniste. Tani ju pyes juve; ne bijtë e bijat e Kurveleshit, që gjithnjë nuk i jemi trembur borës e shiut, që kurrë nuk kemi pasur një copë bukë për fëmijët, po që kurrë nuk kemi pranuar t'i shtrojmë kurrizin

ndonjë armiku, ç'do të bëjmë sot? A do t'i përu-  
lemi fashizmit, të frikësuar e të poshtëruar, apo do  
të mbrojmë nderin tonë, duke i dalë përpara me  
grushte hundëve? Kështu ka ardhur puna sot. Tani  
na takon ne të gjithëve të zgjedhim njërën nga këto  
të dyja: rrugën e luftës, apo rrugën e çnderimit.

Për një farë kohë ra heshtje. Asnjeri nuk u  
ngrit të fliste. Pas pak u ngrit një burrë i moçëm që  
gjer atëhere nuk kish folur. Xha Magripi, siç e  
thërrisnim, ish një patriot i nderuar, kish qënë  
mësonjës i vjetër dhe fjala e tij dëgjohej në fsha-  
trat e Kurveleshit. Mua fjalët e atij plaku të  
mënçur, patriot, që simbolizonte interesin, dhe  
trimërinë e shqiptarit, më janë skalitur në mën-  
dje dhe nuk kam pér t'i harruar kurrë:

— Pse s'flisni? — u thotë ai përfaqësonjësve  
të fshatrave. Këtu përpara kemi një djalin tonë  
që na kërkon një përgjegje, në emër të partisë  
komuniste, atë përgjegje që duhet ta japë sot çdo  
shqiptar i ndershëm, kudo që të jetë. Kujt i  
dhimbset malli? Kujt i dhimbset shtëpia? Unë kam  
mall më shumë nga cilido prei iush që jeni këtu.  
Po kush e ve mallin në një ballancë me nderin e  
Shqipërisë? Kujt i ka hyrë lepuri në bark, le të  
ngrihet e të largohet nga radhët tona. Le ta mbu-  
lojë atë njeri turpi i këtyre maleve. Ne jemi që të  
gjithë gati të japim edhe gjakun tonë! Më shikoni.  
Më ka mbetur akoma edhe një dhëmb; po këtë  
dhëmb dua ta fut në kokë të armiqve. Le të bëhet  
ashtu siç thotë ky djali ynë. Vetëm unë them që  
ta shtyjmë pér disa ditë, pér t'u organizuar më  
mirë, në mënyrë që ta dëmtojmë armikun dhe vetë  
të mos dëmtohem.

Fjalët e xha Magripit bënë tepër përshtypje.  
Unë ndjeja një emocion të madh. E falënderova pér

qëndrimin e tij burrëror dhe thamë: — Forca jonë, forca e partisë, qëndron pikërisht në njerëz të ndershëm e patriotë si ju, që përfaqësoni popullin trim e liridashës të Kurveleshit. — Gjithashtu pranuam propozimin e xha Magripit që sulmi të shtyhej për t'u organizuar edhe më mirë. Po theksova se duhej të dilnim nga mbledhja me një vendim të prerë, që t'u jepnim të kuptonin fashistëve se nuk do t'i lejonim të bënин si do t'u donte qejfi me popullin e Kurveleshit.

Në fund u vendos që t'i dërgohej një letër në formë ultimatumi nënprefektit, ku të kërkohej:

1. — T'i tërhoqte forcat që kish vendsur në trembëdhjet lokale për të kanosur dhe trembur fshatarët.

2. — Të ndalonte patrullimet nëpër fshatra.

3. — Të mos kanoseshin simpatizantët e Lëvizjes, duke u mbajtur nën vrejtje; të hiqej ndalimi i qarkullimit.

Po të mos pranonte nënprefekti këto kushte, atëhere forcat partizane do të ndërmerrnin një sulm të armatosur kundër nënprefekturës.

Letrën, në emër të njësive partizane, do t'ja dorëzonte nënprefektit xha Magripi.

Më përpara se xha Magripi të takohej me nënprefektin ne bëmë një takim me Muhamrem Dukën, kryetarin e komunës. Ai, sa na pa, na përqafoi menjëherë, duke na puthur, por njëri nga shokët tanë, Sali Tarja nuk pranoi të përshëndetëj me të.

— Ju — i tha ky, — në prani të komandantit të xhandërmarisë dhe milicisë dhe të marshallit italian, për t'i nxitur këta kundër partizanëve, i thatë Selman Çelës se vëllai juaj desh të na vriste, po ne mund t'u vrashim juve më përpara. Tani

ç'është kjo përzemërsi kaqë e papritur? Na puth se na do apo se na ke frikën?

Muharrem Duka, dyllë i verdhë në fytyrë, si një spiun i regjur që ish, u përgjegj se ai e kish bërë atë për të mos u kuptuar se qëndronte me anën tonë. Sigurisht ne atëhere nuk mund ta parashikonim se Muharrem Duka ish një njeri i lidhur kokë e këmbë me fashizmin, siç u vërtetua më vonë, po, duke parë disa shënja simpatie që tregonte për Lëvizjen, u munduam ta tërhiqnim në radhët tona.

Muharremi shtoi: — po të dëshëroni ju, unë jam gati që tani të jap dorëheqjen nga detyra si kryetar i komunes.

Atë natë në shtëpinë e xha Rexhepit, që ish një bazë jona, ishin mbledhur shumë njerëz, të cilët i sqaronim mbi gjendjen e krijuar. Dallohej sidomos agjитatori i zjarrtë Birçe Sinomati, përgjegjës i aktivistëve. Atë natë do të takoheshim dhe me nënprefektin, po ai, si duket, i frikësuar, nuk erdhët në takim.

Të gjitha kushtet që i kishim vënët në letër, nënprefekti, më në fund, i detyruar, njoftoi se i pranonte. Në shtëpinë e xha Rexhepit ne bëmë takime me disa grupe të rinjsh. Dhoma ishte mbushur plot e përplot. Të rinjve u folëm mbi gjendjen e krijuar dhe mbi gadishmërinë që duhej të tregonin ata në raste të tillë kritike. Autoritetet qeveritare, me gjithëse i pranonin kushtet tona, mundej që papritur të fillonin raprezaliet. Për këtë ne urdhëruam njësitet tona të prishnim vijat telefonike me Gjirokastrën, Vlorën dhe Tepelenën.

Nënprefekti, i alarmuar, thirri xha Magripin në orën dy pas mesnate dhe i shprehu pakënaqësinë

e tij që partizanët, megjithëqë ai i kish pranuar kushtet e paraqitura në letër, kishin shkatërruar vijat e ndërlidhjes. Xha Magripi na tregoi se aty ishin dhe komandanti i xhandërmarisë, milicisë, marshalli italian dhe disa xhandarë. Ata paraqiteshin shumë të alarmuar.

Siq shihej, nënprefekti çfaqte tani vetëm pakë-naqësi dhe hiqte dorë nga gjuha e kanosjeve. Po, sidoqoftë, në qendër të nënprefekturës patrullat ishin dyfishuar dhe, sipas këshillës së xha Magripit, ne ish mirë që të largoheshim nga shtëpia, duke dalë jashtë qendrës së nënprefekturës. Po ish natë e errët dhe e keqe. Vendosëm që të flinim ndonjë orë e gjysmë dhe të largoheshim heret në mëngjes. Xha Rexhepi mori përsipër të na zgjonte. Po atij, bashkë me ne, i doli gjumi në orën shtatë të mëngjesit. Në një kohë të tillë ish e pamundur të largoheshim dhe detyroheshim që ta kalonim po aty edhe atë ditë.

Dhe tani le të kthehemë përsëri te Venua, përfshirë cilën folëm në fillim. Ajo erdhi dhe na ndezi zjarrin. Po, siq duket, oxhaku ish i papastruar nga bloza dhe mori flakë. Në nënprefekturë u dha alarmi. Pas pak, drejt shtëpisë së xha Rexhepit u drejtuan dyzet xhandarë e milicë. Ata po futeshin në oborr përfshirë ardhur në dhomë që po digjej, ku ishim strehuar edhe ne. Kjo e bente të pashmangëshme përpjekjen me ta. Ish krijuar një rrrethanë e çuditëshme dhe e paparashikuar. Ne nuk ishim më tepër se pesë veta. Po nuk mund të pranonim që xhandarët e milicët të hynin brenda, se kjo do të thoshte t'u dorëzonim armët vetë. Vendosëm të luftonim gjer në fishekun e fundit. Të zotëve të shtëpisë u thamë të largoheshin nga oborri dhe të mbylleshin

që të gjithë në dhomën tjetër. Përpjekjet e xha Rexhepit për t'i ndalur xhandarët e milicët të hy-nin në cborr, ishin të kota. Venua dhe e vjehra e saj hynin e dilnin nga dhoma jonë të shqetësuara.

— Ç'do të bëni? — na pyeti Venua.

— Do të luftojmë! — iu përgjegjëm ne.

Ajo shkoi e na pruri shpejt edhe një torbë me bomba dore, që i mbanin të fshehura në shtëpi.

— Do t'i hedh shumë mirë! — tha ajo, — po si t'ja bëj që s'kam dhe një dyfek.

Kur milicët dhe xhandarët mbushën oborrin dhe po bëheshin gati të hynin në dhomën tonë, Venua doli përjashta me nxitim. Ne zumë pozicione nëpër dritare, po në një mënyrë që të mos diktohemishim.

Venua mori një dru të madh. Të parit që desh të hynte te dera i dha një të shtyrë sa u rrëzua për tokë tok me pushkën edhe vetë.

— Kthehuni prapa! — bërtiste ajo, duke ngri-tur drurin lart; kthehuni prapa, të poshtër! Jam një grua dhe nuk lejoj të hyni në shtëpinë time! Zjarrin e shuajmë vetë. Kush të bëjë një hap përpara, do t'ja heq me dru kokës.

Njëri prej xhandarëve iu kanos me pushkë, po Venua ja goditi pushkën me dru, sa ja rrëzoit për tokë.

— Po je trim, përdore pushkën atje ku e përdo-rin trimat dhe jo kundër grave! — i bërtiti Venua.

Xhandarët dhe milicët u stepën përpara vendosmërisë së gruas. Ata filluan të dalin jashtë obo-rrit të ndjekur nga britmat e të sharat e gruas. Shpejt ajo u kthyte dhe i dha një kovë me ujë xha Rexhepit për të shuar flakën. Pastaj Venua hipi vetë mbi çati dhe e shoi zjarrin. Kështu ajo nuse

trime shtëmëngu një përpjekje që do të kishte për ne pasojë të rënda. Venua, siç e shikoni, nuk u tre-gua vetëm një grua me kurajo burri, po edhe e zgjuar, e mprehtë, diti të gjente mënyrën se si t'i ndalonte xhandarët e milicët për të mos hyrë në dhomën tonë. Dhe gratë si Venua qenë ato që rrëm-byen pushkët dhe dolën malit e luftuan krah për krah burrave me trimëri të pashoqe.

### Inisiativa kalon përfundimisht në duart tona

Inisiativa kish kaluar përfundimisht në duart tona. Forcat fashiste ishin vëguar pothuaj krejt në qendrën e nënprefekturës. Tani më xhandarët dhe milicët, autoritetetëve nuk u duhesin për të shtrirë pushtetin tej qendrës së tyre administrative, po vetëm për të ruajtur administratën e nënprefekturës nga çdo e papritur.

Njësitet guerile partizane kaluan nga Nivica e Rexhini edhe në drejtim të Progonatit, Lekdushit, Golemit, Picarit, Kolonjes, Medarit. Kjo e ngriti tepër moralin e popullit. Ne në çdo fshat që kalonim organizonim mbledhje me popullin, ku demaskonim pushtonjësit fashistë dhe gjithë tradhëtarët që i mbështesnin ata; tregonim se vetëm me luftë të armatosur do t'i detyronim pushtonjësit dhe tradhëtarët të shporreshin nga Kurveleshi dhe e gjithë Shqipëria.

Autoriteti i këshillave ishte rritur në masat. Tani ato ishin bërë pushtet i vërtetë në fshat dhe kryepleqve e pleqësive thuajse vetëm sa u dëgjohej emri. Në atë kohë autoritetet qeveritare kishin nxitur disa njerëz të degjeneruar, disa banda hajdu-

tësh, të vetëqojtura «çeta», që të grabisnin e të vidhnin, sidomos popullsinë e krishtere. Me anën e tyre autoritetet qeveritare kishin për qëllim të frikësonin popullin, ta përganin edhe sipas feve dhe, duke u paraqitur nga armiqtë tanë sikur gjoja kishin lidhje me partizanët, të diskreditonin Lëvizjen nacional-çlirimtare në sy të popullit. Ne i çfarosëm menjëherë ato banda hajdutësh. Në katundin Picar kapëm një farë Hasan Xheferi, kryetari i një bande të këtij lloji dhe e detyruam që të fliste përpara popullit, të tregonte se si ishte venë me qëllim nga autoritetet qeveritare pér të kryer një punë të tillë të ndyrë. Shumë nga këta njerëz të degjeneruar visheshin milicë. Po këta ishin shumë të pakët se në përgjithësi populli i Kurveleshit ushqente një urrejtje të thellë ndaj pushtonjësit.

Ja si i stigmatizoi me dy vargje ata pak të shitur këngëtarë popullor:

**Kusarët vishen milicë,  
Çështë kjo tradhëti!**

Çeta jonë, sipas udhëzimeve të Komitetit Qarkor, kaloi nëpër fshatra të Tepelenës, në një pjesë të Lunxhërisë dhe në Grykën e Këlcyrsë.

Aty riorganizuam ose organizuam në këto anë këshillat e kuqe (të cilat pas punimit të Vendimeve të Konferencës së Pezës, u quajtën Këshilla Nacional-Çlirimtare) propaganduam vijën e partisë në popull. Në fshatin Podgoran nga një kapiten fashist që kish mundur të grumbullonte disa fshatarë, na u bë një rrëthim. Por ne, jo vetëm që duallëm nga rrëthimi, po e detyruam kapitenin të dorëzohej me gjithë forcat e tija. Ai ish prej atij fshati dhe kish ardhur me lejë dhe kur mori vesh se po vinin par-

tizanët në fshat, me inisjativën e vet, mobilizoit oisa fshatarë, për të mos na lejuar që të hynim në fshat.

Kur edhe populli i këtyre anëve pa kapitenin të arrestuar, atëherë autoriteti ynë, besimi i tij te partizanët u ngrit dhe më lart. Ne premë gjithë vijat telefonike në Grykën e Këlcyrës dhe forcat fashiste u vunë në gjendje alarmi, të trëmbura nga një sulm i partizanëve. Kalimi i çetës sonë nëpër fshatrat e Tepelenës, Këlcyrës e Lunxhërisë, shtoi numrin e simpatizantëve dhe solli një organizim më të mirë të punës nga këshillat. Kudo populli na priti si bijtë e tij të vërtetë.

### Çështja e lirisë bën për vete zemrat

Papritur na vjen urdhëri nga Qarkori për t'u kthyer sa më shpejt në Kurvelesh. Korieri na tha se atje po zhvilloheshin ngjarje që e bënин të domosdoshme kthimin tonë. Kur arritëm në Qafë të Mricës ishte pasdite. Kishin rënë shira dhe Vjosa nuk mund të kalohej me këmbë. Lundra kish mbetur në anën tjeter të lumbit dhe njerëzit që e drejtonin, kishin shkuar në anën tjeter të lumbit, në Tegenë e Memaliajt, për një festë fetare. Atëherë dy nga shokët tanë kaluan lumin, duke vënë jetën e tyre në rrezik dhe e muarën lundrën. Çeta u ndodh matanë në orën pesë pas ditës. Kur arritëm në Memaliaj gjetëm popullin të grumbulluar pranë teqesë. Duke shfrytëzuar rastin, atje u folëm njerëzve për gjendjen politike dhe për detyrat që i dilnin çdo shqiptari patriot. U organizua edhe këshilli. Ne në Memaliaj qëndruam fare pak, megjithëse partizanët

ishin të lagur e të lodhur. Udhëtimin e bëmë natën. Në orën dhjetë të mëngjesit ne u ndodhëm në Nivicë. Atje muarëm vesh se, nën drejtimin e Mustafa Matohitet, i tërë populli i Kurveleshit ish ngritur dhe organizuar në çeta dhe batalione. Nga Kuçi i liruar kishin ardhur një pjesë e forcave, që komandoheshin nga Jaho Gjoligu, një luftëtar trimdhe i vendosur. Ai mbante një mitroloz në krahë. Xha Jahua nuk ishte vetëm trim, po dhe një komendant i zoti, që e njihte vendin me pëllëmbë dhe që dinte të merrte vendime të shpejta në gjëndjet më të vështira. Siç na thanë, forcat fashiste që kishin dashur të bënin një operacion në Kurvelesh, kur panë se gjithë populli ish i armatosur e u ngrit për t'i pritur me luftë, ishin detyruar të ktheheteshin nga qenënisur.

Në Kurvelesh zotëronte një atmosferë që vërtetë revolucionare. Tani autoritetet qeveritare nuk pyteshin për asgjë. Edhe forcat e milicisë dhe të xhandermarisë ishin grumbulluar në Gusmar, në qëndrën e nënprefekturës. Këshillat, të ngritura në të gjitha fshatrat, ishin të vetmet autoritete, që drejttonin dhe organizonin jetën nëpër katunde. Kurveleshi i poshtëm kishte kohë që ishte çliruar. Përpjekja për të kryer një operacion ndëshkimor me forca të ardhura nga Gjirokastra kish dështuar.

Gjithë pushteti i qeverisë tashti përqëndrohej vetëm në fshatin e Gusmarit. Nënprefektura s'kish asnjë lloj pushteti mbi Kurveleshin, ajo vetëm sa mbante me vështirësi administratën e vet. Në këto kushte në muarëm vendimin ta dëbonim krejtësisht nga Kurveleshi edhe atë mbeturinë të fundit të fashizmit, administratën e nënprefekturës. Sulmi kundër nënprefekturës do të kryhej natën e 28 nëndo-

rit, të vitit 1942. U vendos që në dy ditët që na mbeteshin të shpërndaheshim nëpër fshatra për të grumbulluar njësitë e armatosura, për t'i shpjetuar popullit planin tonë. Me anë të spiunëve të vet nënprefekti e kish marrë vesh se përgatitej një plan për të sulmuar administratën e tij. Gjithë vijat telefonike ishin prerë. Ish lënë vetëm ajo e Kuçit që ishte në dorën tonë. Nënprefekti mori në telefon Kuçin dhe i doli Avdul Hakiu, që kish grumbulluar në qëndrën e Këshillit njësitë e armatosura. Ai e pyeti në ishin të vërteta fjalët sipas të cilave partizanët do të sulmonin nënprefekturën dhe ç'qëndrim do të mbante Kurveleshi i poshtëm. Avduli iu përgjegj: I tërë Kurveleshi ka vendosë që të jetojë i lirë dhe kur ne u ngritëm kundër fashistëve aty, vëllezërit tanë të Kurveleshit të sipërm na ndihmuani. Edhe ne do t'u japim atyre çdo ndihmë për t'u çliruar nga zgjedha juaj e urryer.

Kjo e siguroi edhe më tepër nënprefektin se po i afrohej fundi. Por vendosi të lozë edhe kartën e vetme që i kish mbetur në duar. Gjoja për të festuar ditën e 28 nëndorit thirri dy-tre burra nga çdo fshat, ose, siç i quanin atëhere, parësinë e Kurveleshit. Në përgjithësi këta ishin anëtarë të pleqësive, kryepleq dhe njerëz të tjera që u shkonte gjer diku fjalët nëpër fshatra. Nënprefekti shpresonte t'i bënte përvete dhe, nëpërmjet tyre, të përcante forcat tonë. Ai u njoftoi se kish të dhëna që do të sulmohej nënprefektura dhe për këtë, sipas rregullave të maliësisë, parësia nuk ishte pyetur fare. Nënprefekti u kanos se po të bënин disa kalamaj një krim të tillë, do të digjej dhe do të shkatërrrohej gjithë Kurveleshi. Andaj ai e kishtë për detyrë që të lajmëronte parësinë, burrat më të mënçur e më të dëgjuar të

Kurveleshit, që të mos e lejonin kurrë të bëhej një çmënduri e tillë.

Kjo ish një manevër e hollë e nënprefektit. Sigurisht ne ishim përgatitur edhe për një diversion të tillë. Në parësi ne kishim shumë njerëz tanët, patriotë, që bënин pjesë në këshilla. Ne, edhe pa pëlqimin e parësisë, mund të ndërmerrnim me sukces një sulm kundër nënprefekturës, po Mustafa Matohiti na tha: «Meqënëse parësia dërgon dy përfaqësonjës të saj për të biseduar, ne mund të bisedojmë me ta. Kjo nuk do të thotë aspak se nga një takim i tillë do të ndryshojmë vendimin që kemi marrë. Ne e dimë se disa nga këta njerëz kanë ende njëlloj influence në popull, dimë gjithashtu edhe se një pjesë e mirë e këtyre njerëzve janë simpatizantët tanë, prandaj ne këtë takim mund ta kthejmë ndryshe nga ç'e ka parashikuar nënprefekti dhe kundër tij. Gjersa na paraqitet kjo mundësi, duhet ta shfrytëzojmë». Dhe ashtu u bë.

Më datën 27 nëndor shkova në takimin që kërkonte parësia. E ndjeja veten të emocionuar. E dija se do të kisha të bëja me burra të rrahur nga jetë. Disa prej tyre parashikohej që ta kundërshtonin ashpër planin tonë. Qëllimi i këtij takimi nuk ish që ne të njoftonim vendimin tonë të patundur, po të shfrytëzoheshin gjithë ato mundësi, që të shuhej edhe ajo shkëndijë shprese e autoriteteteve qeveritare se parësia nuk do ta përkrahte në asnje mënyrë planin tonë. I shkova nëpër mënd gjithë ato fytyra që i njihja, mendoja për temperamentin e secilit, për mënyrën se si mund të vepronin në çaste të ndryshme. Po kur hyra brënda gjithë ato që kisha përgatitur në mëndje, i harrova.

Remzi Kallarati, një burrë mbi gjashtëdhjetë

vjeç, ish i pari që më pyeti në ishin të vërteta fjalët e hapura se do të sulmohej nënprefektura. Unë e pohova se ish dëshira e popullit të Kurveleshit që 28 nëndori të festohej i lirë, pa fashistë dhe dallaveraxhinj dhe partia komuniste, duke marrë parasysh këtë dëshirë të popullit, kish vendosur që t'ja plotësojë gjer në fund.

Ahmet Aliu, një njeri me influencë midis parësisë, i zoti i fjalës, u ngrit dhe më kundërshtoi rreptësisht.

— A e pëlqeni ju që të bëjmë kështu siç thotë ky djali? — ju drejtua ai të pranishmëve. Pastaj m'u kthyte mua.

— C'janë këto vendime që marrka ajo partia juaj? Ju kokën e kini mbështetur te Moska, kurse Moska vetë po heq shpirt. Ju doni të luftoni kundër një fuqie të madhe me pesë dyfje të ndryshkur. Italia dhe Gjermania kanë sot nën vete gjithë Evropën. C'farë mund të bëjmë ne kundër saj? Partia juaj siç duket, shikon jo për të mirën, por për të keqen e popullit. Ju kërkoni ta lini popullin e Kurveleshit në prak të dimrit pa strehë, në mes të borës, sepse po të bëni ju atë marrëzi që kini ndër mend, këtu do të vijnë divizione.

Në shtëpinë ku ishim mbledhur ra një heshtje e plotë. Dukej se asnijë nga të pranishmit nuk kundërshtonë dhe ai çast ka qënë një nga më të vëshitrat në jetën time. C'duhej të thoshja? Si të filloja? Puna ish se duhej hedhur poshtë logjika e atij njeriu që i kish detyruar gjithë ata njerëz të heshtnin. Ndofta në atë rast do të kisha shumë nevojë për ndihmën e ndonjë shoku, për t'u këshilluar me të. Po isha vetëm. Dhe as mua nuk më kujtohet se nga më erdhën gjithë ato mendime që thashë:

— Unë, — fillova, — përfaqësoj këtu dëshirën  
dhe vullnetin e popullit të Kurveleshit. As unë dhe  
as ju nuk mund ta kundërshtojmë këtë. Vërtet,  
në krahasim me ju, unë jam djali juaj. Po juve,  
njerëzve më të moshuar, që jeni në këtë dhomë,  
çfarë trashëgimi ju kanë lënë gjyshrit dhe stërgjyshrit? Mos vallë këdo që të vjen e të futet me  
forcë në shtëpinë tënde, duhet ta lesh të shijë si  
i do qejfi, mjafton që të jetë më i fortë se ti?  
Turqit qenë shumë më tepër se ne nga numri, po  
Rrapo Hekali, Gjon Leka, Tafil Buzi e Hasan Labi  
me shokë, nuk u trembën, po luftuan si burrat në  
këto male. A guxoni ju baballarët tanë të na thoni  
ne bijve tuaj: «futuni në çitjanet e mëmave tuaja  
nga frika e këmishëzinje të Duçes, sepse ata janë  
më shumë dhe mund t'ju vrasin? A duroni ju të  
shihni vajzat, motrat, gratë tuaja të mos kenë gu-  
xim të mbushin as ujë nëpër kroje, sepse u vijnë  
rrrotull si qentë ushtarët e Duçes? Zoti Ahmet, as-  
kujt mos i jepni këshilla të tillë. Dhe në  
dhënci, një ditë as fëmijët tuaj s'kanë për t'u dë-  
gjuar. Dua të them këtu se nuk jemi të vetëm që  
luftojmë kundër fashizmit, po gjithë Shqipëria dhe  
jo vetëm gjithë Shqipëria, po gjithë popujt e shty-  
pur të botës. Dhe popujt do të fitojnë. Ata janë  
më të shumtë dhe më të fortë se ushtritë e Duçes  
dhe të Hitlerit. Ne kemi një parti të fortë në krye  
dhe një popull trim. Populli i këtyre maleve s'është  
trembur kurrë. Flisni, zotërinj. A mund të frikë-  
sohami ne nga një grusht bashibozukësh, siç janë  
xhandarët dhe milicët e Duçes?

Disa prej atyre burrave të moshuar unë i  
pashë të nxirrnin lotë. — Do të bëhet ashtu si thotë  
ky djali! — u ngritën e britën disa. — Në që s'jemi

trembur kurrë, s'do të trembemi as sot nga këmi-shëzinjtë e Duçes. — Të vdesim më mirë, se ne jetën me turp s'e kemi pasur zakon kurrë! — tha Fejzo Dalipi e të tjerë.

Tani ata që kundërshtonin nuk ishin veçse dy-tre veta. Mua erdhën dhe më përshëndetën, më përqafuan. Po në ato çaste unë isha vetë si një fëmijë i emocionuar, i mallëngjyer.

Pra, edhe karta e fundit e nënprefektit u dogj. Dhe ndjeja për këtë një gëzim dhe krenari të vëçantë. Ndjeja gëzim dhe krenari për partinë time, e cila na kish mësuar se popullin do ta bënim me vete vetëm kur ai ta shihte se rruga që ndiqnim ne ishte e vetëmja rrugë për të fituar lirinë, për të ruajtur nderin kombëtar. Dhe isha i bindur në atë mbledhje se nuk i fituan zemrat e atyre burrave fjalët e bukura që mund të kisha thënë unë, por ata i bëri për vete çështja e madhe e partisë, e lirisë së popullit, të cilën unë atje e mbroja.

Me të mbaruar këtë mbledhje prej fshatit Gusmar dolën edhe trembëdhjetë vullnetarë të tjerë për të sulmuar nënprefekturën.

## 28 Nëndori i 1942-së festohet në liri

Pas mbledhjes shkova te Mali i Mesëm, siç quhej vendi ku do të grumbulloheshin gjithë forcat tonë përpara se të niseshim kundër nënprefekturës.

Në ora tre pas mesnate ne ishim afër qëndrës së nënprefekturës. U ndamë në skuadra; u caktuan pozicionet për secilën prej tyre dhe në orën 4 të mëngjesit të datës 28 nëndor 1942, qëndra e nënprefekturës ishte krejt e rrethuar. Ne ishim gjithë-sejt 150 veta. Atë natë në fshatin e Gusmarit s'vuri

njeri gjumë në sy. Ajo që do të ndodhët ishte një ngjarje e jashtëzakonshme.

Çdo skuadër u pajis edhe me shishe me vajguri, që do të përdoreshin po të ish se xendarët me milicët nuk do të dorëzoheshin. Ne e dinim se xendarët dhe milicët ishin përqëndruar në 13 shtëpi. Po lufta do të fillonte në qëndër, ku banonte nënprefekti. Unë u caktova që të shkoja te shtëpia e nënprefektit dhe në emër të komandës partizane t'i kërkoja të dorëzohej. Bashkë me mua ishin dhe Krokodili, Bajram Kovarfi, Beqir Gumeni dhe Veipi, patrioti plak Ziflua që kish kërkuar të merrte pjesë në këtë aksion.

Shtëpia ku banonte nënprefekti ishte e rrethuar me mur. Dritaret e myllura kishin vetëm nga një vend sa për të dalë gryka e dyfekut. I bëmë thirrje për t'u dorëzuar pa luftë. Çdo qendresë ishte e kotë, pa asnje shpresë. Shtëpia e tij dhe krejt qëndra e nënprefekturës ishin rrethuar. Edhe pse u paralajmërua se po të vritej qoftë edhe një partizan, do të pushkatoheshin që të gjithë, nënprefekti nuk pranoi të dorëzohej. Ai tha se do të luftonte gjer në vdekje. Pastaj pyeti se kush isha unë. I tregova pseudonimin tim, siç ishte zakon në ato kohë. Ai më njoju.

— S'e prisja një tradhëti të tillë nga ju!

I nxehur, desha të hyja në shtëpi, sepse nuk m'u durua më që të dëgjoja vrejtje prej një njeriu të tillë, që ish tashmë nén mëshirën e armëve tonë. Po xha Veipi më kapi për krahu dhe më ndali:

— Largoju se unë i kam bërë ditët e perëndisë, — më tha duke më shtyrë, dhe shkoi vetë të dera.

— Nuk kemi tradhëtar ne! — iu përgjegj xha Veipi nënprefektit, po ti ke tradhëtar, që u qën-

dron si një qen besnik fashistëve për një çanak me makarona që të venë përpara!

Kur e pamë që nënprefekti kundërshtoi të dorëzohej, atëherë i bemë thirrje që të nxirrte jashtë gruan dhe fëmijët për të mos u dëmtuar. Po edhe këtë nuk e pranoi. U dha urdhëri të hapej zjarr mbi shtëpinë e nënprefektit dhe kjo ish shenjë e sulmit kundër qëndrës së nënprefekturës. Forcat e xhandarëve dhe milicëve që ishin përqëndruar në pikë të tjera, u dorëzuan pa luftë. Po edhe ata që ishin caktuar për të mbrojtur nënprefektin, me të dëgjuar urdhërin «të hidhen granatat!», flakën armët. Nënprefekti, kur e pa që mbeti vetëm, më në fund, u dorëzua edhe ai.

Sheshi në qendër të nënprefekturës ish mbushur me xhandarë, e milicë të zënë robër. Veç këtyre, atë mëngjes kish dalë në rrugë dhe i gjithë populli. Përtej maleve të larta u ngrit disku i madh i diellit. Në Gusmar gjëmonin këngët partizane. Njerëzit përshëndeteshin me njëri-tjetrin. Atje, ku gjer atë ditë ish ngritur flamuri i fashizmit, valonte krenar flamuri ynë i kuq me shkabë.

Qendra e fundit e fashizmit në krahinën e Kurveleshit ish shpartalluar. Populli i atyre maleve kreshnike e festonte 28 nëndorin i lirë, pa fashistë dhe tradhëtarë.

Në shesh gjithnjë e më shumë grumbulloheshin njerëz të ardhur nga gjithë fshatrat. Mustafa Matohiti iu drejtua atë ditë popullit të Kurveleshit me një fjalim të zjarrtë. Ai uroi bashkëpatriotët të festonin 28 nëndorin gjithmonë të lirë.

— Plaku i Vlorës, — tha ai — tridhjet vjet më parë ngriti në Vlorë flamurin tonë të shenjtë. Ish detyra jonë që sot flamuri i Ismail Qemalit të va-

lonte në malet e Kurveleshit, i panjollosur, pa së-patat e fashizmit. Ne duhet t'i detyrojmë fashistët, me forcën e armëve, të shporren nga toka jonë. Dhe unë u bëj thirrje të gjithë bijve trima të Kurveleshit të rrokin armët dhe të mbushin rrjeshtat partizane. Fashistët do të tërbohen për këtë disfatë që pësuan dhe do të vërsulen kundër Kurveleshit për ta nënshtuar. Ne nuk do t'i lejojmë më që të kthehen! Lufta jonë është në fillim. Gjersa të cilohet krejt Shqipëria ne s'do t'i lëshojmë armët nga duart.

Pastaj Mustafa Matohiti u foli italisht karabinerve italianë. Ai u tha: — Ju s'kini asnje të drejtë të vini që nga Italia në tokën tonë. Fashizmi s'është vetëm kundër nesh, po edhe kundër jush, edhe kundër vetë Italisë. Patriotët e vërtetë italianë kanë filluar që tani Lëvizjen e Rezistencës.

Fjala e Mustafait pritej me brohoritje. Ajo, me thjeshtësinë e saj, me forcën bindëse, të bënte përvete. Shumë nga xhandarët dhe milicët çfaqën dëshirën atv për aty për t'u hedhur në rrjeshtat partizane. Nënprefekti u detyrua të largohej menjëherë jashtë kufive të Kurveleshit me gjithë administratën e tij.

Ne, sipas udhëzimeve të Mustafait, u ndamë në çdo fshat që të popullarizonim rëndësinë e marrjes së nënprefekturës, që të preqatitnim popullin përluftërat e reja kundër fashizmit, për të shtuar radhët e partizanëve.

Po të gjykosh nga rr Ethanat, nga shkalla në të cilën gjendej Lëvizja nacional-çlirimtare, koha kur u prish nënprefektura dhe u arrit çlirimi i krejt Kurveleshit mund të thuhet se këto aksione ishin nga më të rëndësishmet për vëndin tonë. Kurveleshi ish

ndër të parat krahina të Shqipërisë që dëboi krejtësisht administratën fashiste që në nëndorin e viti 1942, kur koalicioni fashist ish në kulm të fuqisë së tij. Që prej asaj kohe u bënë orvajtje, me anë të operacioneve ndëshkimore, për ta kthyer përsëri administratën e nënprefekturës, po këto orvajtje qenë pa sukses. Kështu krahina e Kurveleshit mbeti përgjithmonë një fole e lëvizjes nacional çlirimtare, ankth dhe tmerr për armiqëtë e tradhëtarët.

### Bilbili i Maleve

Populli i Kurveleshit e quajti Mustafá Matohitin «Bilbili i maleve», se ligjerata e tij ish e bukur dhe e zjarrtë si kënga e bilbilit. Jehona e këngës së tij u përhap nëpër gjithë ato male kreshnike, në çdo burim e korie, në çdo gërxh e stan, në çdo kasolle dhe shtëpi. Poeti popullor i ka kënduar:

**Me shokë të pakë dole malit ti,**

**Bilbil Matohiti, që s'të shoh me sy.**

**S'le katund pa vajtur, kasolle, shtëpi,**

**Bilbil Matohiti, që s'të shoh me sy.**

Po, si kurdoherë, fillimi ishte i vështirë. Më kujtohet kur vinte në fillim Mustafai dhe na fliste kundër fashizmit. I pakët nga trupi, i zeshkët në fytyrë, i hequr, i dobët, nuk ta mbushte syrin fare. Ahere, kur ne ishim ende të rinj, të papjekur, kur fashizmi trumbetonte plot pompozitet forcën e vet, kur koalicioni italo-gjerman ish në kulmin e fuqisë, të dukej pak e besuar të mendoje se ne shqiptarët, një grup njerzish, pa fishekë e pa dyfekë, mund t'i

bënim gjë atij kolosi. Të dukej sikur ai burrë i shkurtër, i sëmurë, i dobët, kërkonte në këto male kallez nëpër borë. Por ai ish i dërguari i partisë, me besim të patundur tek ideali i tij i madh, tek idetë komuniste. Ai dinte të qante hallet me popullin, të gjente plagën dhe të tregonte ilaçin që mund ta shëronte. Mustafai, siç e kam thënë edhe më përpara, ishte i prekur në mushkëri dhe, megjithatë, sonfë e shikoje në fshatin Lekdush, në mëngjes e gjeje në Progonat, të nesërmen në një stan. Ashtu siç thotë dhe poeti popullor, ai s'la fshat, shtëpi, kasolle, stan, pa vajtur. Dhe në fillim doli malit me shokët të pakë, po shokët e tij shtoheshin çdo ditë. Mustafai ish i pajisur me një shpirt të gjerë, me një mendje të imprehtë. Malet e Kurveleshit nuk kanë parë komunist më të përgatitur, më të vendosur, më të zjarrtë. Ai, edhe në gjendjet më të vështira, dinte të orientohej me zotësi. Ai jetonte në gjirin e popullit dhe kur ishte nevoja thirrja e tij e ngrinte popullin më këmbë. Për armiqtë Mustafai qe i pamëshirshëm. Fashistët e kishin frikë, dhe kur dëgjonin se kish ardhur Mustafai dridheshin gjer në palcë. Ai ish për ta si një hero legjende oë ishte kudo dhe s'e gjeje dot asgjekundi.

Mustafai, si një i dërguar i partisë, shkrua gjithë dijenitë dhe shpirtin e tii për përparimin e lëvizjes revolucionare në ato krahina. Ne, që patëm mundësi ta njihnim, që punuam dhe jetuam me të, ruajmë kujtime të paharruara prej tij.

## Jo vetëm propagandist, po edhe trim i rrallë

Një herë, në qershor të vitit 1942, me Mustafanë shkonim për në Kuç. Rreth orës 11 ne e dinim që prej Kuçit shkonte për në qendrën e nënprefekturës, Gusmar, posta. Mustafain autoritetet qeveritare e kërkonin ta arrestonin, prandaj ne duhej të ruheshim se mos takoheshim me xhandarë e milicë. Po, pikërisht, në çastin kur ne bënim llogari të linim rrugën dhe të ktheheshim në një vend të fshehtë sa të kalonte posta e nënprefekturës, na dalin ballë për ballë një rreshter dhe tre xhandarë. Nuk ishim më larg se 7-8 metra prej tyre. Çdo orvajtje për të ikur ish e kotë dhe e dëmshme. Rreshteri na ndali. Ai e pyeti Mustafanë se kush ishte, nga vinte dhe ç'punë bënte. Ky iu përgjegj se ish nga Malëshova e Përmetit dhe merrej me kallaisjen e enëve. Për ne i tha se ishim shokët e tij që i duheshin për të ndihmuar e për t'i mbajtur veglat. Gjatë gjithë asaj bisede Mustafai fliste me një gjakftoftësi të atillë, sikur të mos ishte aspak përpëra një rreziku.

Rreshteri, siç duket, dyshoi dhe e urdhëroi të nxirrte dokumentat. Mustafai futi dorën në xhep sikur do të nxirrte letërnjoftimin, po në vend të saj nxori revolverin që e mbante fshehur në xhep dhe tyten e tij ja vuri reshterit mu në gojë. Fashistit i ra pushka nga dora dhe fjala i mbeti përgjysmë. Përpëra një veprimi të tillë të rrufeshëm edhe xhandarët që e shoqëronin, mbeten në vend si të ngrirë. Mustafai me revolver në dorë i urdhëroi që të hidhnin armët dhe xhandarët u çarmatosën pa bërë asnje fjalë. I tillë ish Mustafai,

agitator, propagandist, por edhe luftëtar i rrallë, ashtu si të paraqitej nevoja.

## «Prishësi» i gostisë

Disa kohë pas pushtimit te nënprefekturës të Kurveleshit prefekti i Gjirokastrës dërgonte një letër kanosëse. Me prefektin i kish takuar të bënte një duel sypërsy dhe tani është rasti që ta tregojmë këtë ngjarje, përpara se të rrefejmë si iu përgjegj Mustafai letrës së prefektit tradhëtar.

Prefekti i Gjirokastrës, Rasim Babametua, me një valixhe në dorë, nisej për në Kurvelesh, me një mision të shenjtë. Në atë valixhe ai sillte me vete një mall mashtronjës — paranë.

Në luftën italo-greke Kurveleshi kishte qenë shesh beteje. Dhe ato para ishin si dëmshpërbllim lufte. Një paradoks i zakonshëm: vetë fashistët kishin qenë shkaktarët e atij dëmi dhe ata vetë po tregoheshin gjoja të «mëshirëshëm», kërkonisht tē lanin gjynahet e veta me popullin e Kurveleshit. Po qëllimi ish krejt tjetër. Ata, duke njojur shpirtin liridashës dhe revolucionar të atyre malësorëve trima, mendonin se me atë mall përkëdhelës do t'i imposhtnin ndjenjat kryengritëse të Kurveleshit. Ky ishte misioni i prefektit. Ai arriti shëndoshë e mirë me veturë gjer në fshatin Fterë. E shoqëronin ordinanca e tij besnikë, togeri fashist Riza Kardhiqi dhe shumë xhandarë. Për darkë e priti një nga shtëpitë e para. Dhe domosdo, si e kërkonte zakoni, për prefektin do të shtrohej darka, do të therej mishi, do të bëhej muhabeti. Shtëpia ish mbushur plot me burra që mund të ishin të denjë për një

gosti të tillë. Po aty vetëm njeri bente përjashtim. Në fund të shtëpisë, i paftuar, qëndronte një burrë i zeshkët, i shkurtër, që nuk tërhiqte vemendjen e askujt. Filloj rakia, u ndez muhabeti. Dhe prefektit, siç mund të merret me mend, iu dha rasti për të çfaqur gjithë aftësitë dhe oratorinë e tij të rallë. Ai e hiqte veten si një patriot dhe si një bir të Kurveleshit. Si i tillë, kujt më tepër se atij mund t'i dhimbsej fati i këtij populli? Lufta italo-greke kishte shkakëtuar shumë fatkeqësi dhe ja pse kish ardhur ai, për të shëruar plagët e luftës; tregoi vallixhen.

— Këtu, — tha prefekti, — kam dëmshpërblimin për gjithë dëmet e luftës. Qeveria e do popullin e Kurveleshit dhe kujdeset për të. Edhe kjo është një provë e gjallë. Ne jemi të varfér, — vazhdonte të fliste ai, dhe kemi nevojë për ndihmë. Bota e qytetëruar jeton krejt ndryshe.

Prefekti në atë darkë, si njeri i ditur dhe si i shëtitur nëpër botë, pati guximin dhe mirësinë të tregonte si jetonin njerëzit në Amerikë, në Angli, në Francë, në Gjermani, në Itali dhe në vende të tjera të qytetëruara të botës. Këto vende kishin qytete të bukura, me pallate madhështore, fabrika moderne, shkolla, kinema, teatra, akademi dhe gjera të tjera të këtij lloji. Prefekti i përmblodhi këto me fjalët «se kjo është bota e qytetëruar» dhe për të krijuar një Shqipëri të qytetëruar, duhej ndihma e Italisë. Kjo ndihmë po na epej. Po duke folur për «parajsën» e botës së qytetëruar, ish e natyrëshme që prefekti nuk mund të mos fliste dhe për «skëterrën» e kësaj bote. Ai e quajti të nevojëshme, bile, detyrë, t'u fliste të pranishmëve mbi regjimin e egër në Rusi, në atë «burg popujsh».

Atje të gjithëve ua kishin grabitur pasuritë; një-rëzit jetonin nëpër kazerma si ushtarët. Prindërit nuk i njihnin fëmijët, gratë i kishin të përbashkëta, motra martohej me vëllanë dhe njerëzit jetonin si kafshët. Dhe ja, pastaj, shtoi me ironi, «edhe në vendin tonë na paskan dalë disa të shitur që na kërkuan një regjim të tillë». Pra dhe detyra vendimtare dhe patriotike e prefektit ish t'ua shpjegonte se këta njerëz jo vetëm që s'duheshin pasur pranë, po dhe duheshin përzenë me dru.

Po vallë, çfarë shenonte me një lapës mbi një blok të vogël në fund të shtëpisë ai burri i zeshket, me trup të vogël? Kjo i hoqi vrejtjen prefektit dhe pyeti pse i mbante ato shenime dhe kush ish ai njeri.

Burri zeshkan iu përgjegj vetë se ish mësuesi i fshatit të Çorravit dhe, natyrisht, fjalët e një prefekti do t'i hynin në punë dhe ja vlente që t'i mbante shenim.

Si duket, pas kësaj pyetje, prefekti nuk ja vari më atij njeriu dhe vazhdoi ligjeratën e tij edhe më me elokuencë.

Por, kur mbaroi, u ndodh përpëra një të papriture. Ai burri që rrinte në fund të shtëpisë nuk e la zotin prefekt ta pinte gjer në fund rakinë që i kishin shtruar në tryezë:

— Na lejoni, zoti prefekt, — nisi të flasë ai, — që gënjeshtrat që thatë, të mos i marrim pér të vërteta. Ju na folët pér një botë të qytetëruar, pér qytete të mëdha, pér fabrika, pér pallate. Po ju pse nuk treguat se pikërisht atë botë të qytetëruar, ato qytete të mëdha, ato fabrika dhe pallate i kanë krijuar njerëzit e thjeshtë, njerëzit e punës, punëtorët? Dhe pse nuk na thatë se atje ata vetë nuk kanë as-

një pasuri, përveç krahëve të tyre? Pse nuk na thatë se krijonjësit e gjithë atyre të mirave jetojnë simosmëkeq nëpër shtëpi të ndyra, nëpër bodru-me, nëpër rrugë? Regjimi kapitalist që ju na reklamoni është regjimi i shtypjes dhe i skllavërisë, regjimi i urisë dhe i kërbaçit. Ju shajtët Rusinë Sovjetike se trembeni prej saj si prej zjarrit. Në Rusi pushtetin e kanë punëtorët dhe fshatarët — jo si thatë ju, po vetëm atje njeriu e ndjen veten njeri të lirë, zot të vetes. Në vendet kapitaliste dhe jo në Rusi femija e shet veten për një copë bukë, fëmija fishket përpara kohe, femra mbetet nën mëshirën e ashpër të fatit. Ju na thatë se Italia fasiste na premtion begati, se në atë valixhe na paskeni prurë para. Por kur të ish ashtu, përsë Italia ta përdorte vendin tonë si një shesh lufte? Zoti prefekt! Ato para mbaji për vete. Vetëm ti ua di lezeten parave të Duces. Ne jemi mësuar me fatin tonë të egër, po as shitemi, as blihem. Andaj gabozeni rëndë kur mendoni se mund të bleni popullin e Kurveleshit me para.

Këto fjalë shkaktuan një habi dhe përshtypje të madhe. Prefektit i mbeti rakia në grykë. Ai u ngrit dhe bërtiti si i tërbuar. Për të zotin e shtëpisë dhe të ftuarit qëndrimi burrëror i Mustafait, fjala e tij e mprehtë, ishin diçka të pabesuara.

— Të arrestohet ai këlysh i Mustafa Matohitit — urdhëroi prefekti, i cili nuk dinte se ai që fliste ishte vetë Mustafai.

— Ju keni frikë të vërtetën, prefekt i fashizmit. Ky është zëri i popullit dhe zëri i popullit nuk arrestohet dot. Pra, ju s'do të mund të arrestoni dot gjithë popullin e Kurveleshit, iu përgjegj Mustafai i patrembur. Kjo ngjarje ish zhvilluar kohë

më parë. Askush, as xhandarët nuk guxuan të lëviznin dhe Mustafai doli. Darka u prish.

## Përgjigja e popullit

Dhe ja tani prefekti i Gjirokastrës i dërgonte një letër popullit të Kurveleshit. Dhe priste përgjegje.

Qeveritarët fashistë s'mund të pajtoheshin kurresi me atë akt dhune që kreu populli i Kurveleshit karshi nënprefekturës, andaj dërguan shumë agjentë dhe spiunë që të përhapnин frikë nëpër popull, se po të mos pranohej të vendosej përsëri nënprefekitura, do të dërgoheshin kundër Kurveleshit disa divizione të cilat çdo gjë do ta rrafshonin për tokë. Por qeveria do të tregohej zemërgjerë, do të falte gjithë ata që kishin marrë pjesë në djegien e nënprefekturës, mjaft që këndej e tutje të pranoheshin autoritetet qeveritare në Kurvelesh, të mos u mbahet vesh partizanëve, të cilët ishin të shitur te Rusia, greku, sérbi. Gjithashtu, për t'u ardhur në ndihmë popullsisë, do të ndahej miell, makarona, sheqer krejt falas.

Po në atë kohë u formuan edhe disa çeta kusarësh për të frikësuar popullin. Në krye të njërsës prej këtyre çetave ish Hasan Xhaferi, që ne e kishim kapur dikur në fshatin Picar dhe e kishim detyruar të jepte llogari përpara popullit. Ahere një nga partizanët, Velo Seferi, propozoi ta vrissnim atë kusar profesionist. Po ai pranoi të gjitha gabimet dhe premtoi se do të hiqte dorë nga një punë e tillë dhe se kish qënë thellësisht i gënijyer. Dhe ne e falëm. Po ja tek dilte përsëri në skenë. Banda e tij

formohej prej milicësh që merrnin rrrogë nga prefekturna, po visheshin civilë për të mashtruar popullin. duke e hequr veten se bënин çmos për të shpëtuar Kurveleshin nga një katastrofë. Në ato ditë aeroplanët fluturuan ultas mbi fshatra dhe hodhën fletushka, me anë të të cilave i bëhej thirrje popullit që të braktiste partizanët, që të pranonte të kthehej përsëri nënprefektura dhe të largonte kësh- tu një shkatërrim dhe gjakderdhje të madhe.

Por populli as frikësohej, as mashtrohej nga këto parulla. Në çdo fshat vepronin këshillat, të cilat zgjidhnin konfliktet, organizonin mbledhje me popullin, pajtonin gjaqet, duke e zgjidhur çdo gjë në mënyrë revolucionare. Këto këshilla çdo ditë e më tepër fitonin besimin dhe përkrahjen e fshata- rëve.

Po një rol të jashtëzakonshëm në organizimin dhe në mbajtjen lart të frysës revolucionare të popullit të Kurveleshit, lojti dhe kësaj here bolsheviku Mustafa Matohiti. Në ato ditë kur përhapeshin lloj lloj parullash, kur vinin lloj lloj kanosjesh u vendos që të bëhej një mbledhje e gjithë popullit në ish qendrën e nënprefekturës. Njerëzit vinin grumbuj nga të gjitha fshatrat e Kurveleshit. Të gjithë ishin të armatosur dhe kishin marrë me vete bukë për tri ditë. Në sheshin te Lisat e Kadhe ku do të bëhej mbledhje, këndonin, hidhnin valle. Gjithshka gjëmonte plot gjëzim, plot optimizëm revolucionar. Bilbili i maleve, në emër të partisë, në atë miting të madh do të këshillohei me popullin. Dhe pikërisht në kohën kur Mustafa Matohiti po fliste, i shoqëruar nga partizanë të armatosur, vjen Qemal Dudua, një nga agallarët e fshatit Lekdush. Ai tha se kish ardhur për të sjellë një letër nga prefekti i Gjirokastrës.

— Pse qenka shqetësuar, zoti prefekt? — i tha me buzëqeshje ironike Mustafai.

— U drejtohet burrave dhe patriotëve që u dhimbset populli i Kurveleshit, zoti Mustafa — iu përgjegj agai.

— Më duket se prefektit i dhimbset më tepër fashizmi! Ju jini korieri i tij... Ç'patriotë të kulluar...

Agai u mbërthye nga përgjegjet e shpejta plot sarkazëm të Mustafait.

Kur imbaroi se lexuari letrën, Mustafai iu kthye përsëri agait që priste ç'përgjegje do t'i jepnin.

— Më vjen keq që zoti prefekt nuk erdhi vetë për të parë popullin që iu dhimbska kaq shumë, për të marrë përgjegjen drejtëpërdrejt prej tij. Ja ku është populli! — dhe Mustafai zgjati dorën drejt turmës. — Ti, bedeli i prefektit fashist, hapi mirë veshët dhe çoji përgjegjen e tij. — Mustafai i tha Memo Metos ta lexonte letrën e prefektit përpargjithë mitingut.

Letra kish afërsisht këtë përbajtje:

Prefekti u bënte thirrje burrave të Kurveleshit që njihnin dhe zbatonin kanunet e malësisë, për të drejtuar popullin në rrugë të mbarë dhe për ta shpëtuar nga marrëzitë e disa djemve që vepronin pa menduar. Kur të vinte koha, edhe ai do të rrëmbente armët dhe do të luftonte kundër Italisë. Po një gjë e tillë nuk mund të bëhej ahtere se ishte e parakohëshme, e shpejtuar. Pra, ish detyra e atyre burrave të gjykuar, që pasi t'ja shpjegonin të gjithë popullit dhe t'i sillnin në vete «djemptë e rrëmbyer», «gjaknxehtë», të njoftonin menjëherë se pranonin të kthehej përsëri në Kurvelesh nënprefektura dhe rrëthkomanda e xhandarmërisë. Prefekti do të emë-

ronte menjéherë një njeri tjetër si nënprefekt. Si-gurohej gjithë populli, duke përfshirë dhe ata që kishin marrë pjesë në shkatërimin e nënprefekturës, se nuk do të merrej asnjë masë kundër tyre. Gjithashtu do të caktohej posaçërisht për krahinën e Kurveleshit një sasi malli si oriz, miell, makarona, etj.

Nëqoftëse nuk do të pranonin kthimin e autoriteteve qeveritare, do të kryhej një operacion shumë i rëndë, që do të sillte mjerime dhe shkatërrime të pafund. Prandaj përfundonte ai «Unë si një shqiptar i ndershëm, e kam për detyrë t'u lajmëroj që më përparrë për ato që do të ngjasin».

Letra u prit me të qeshura, me thirrje. Dhe në mes të një entusiazmi të tillë e mori fjalën përsëri Mustafa Matohiti. Fjalët e tij do të mbeten të pahruara.

— Ju e dëgjuat letrën e prefektit, — tha ai. — Ne jemi bij të popullit, kemi vendosur të punojmë dhe të luftojmë për të mirën e popullit dhe për çdo gjë i drejtëhemë dhe do t'i drejtëhemë popullit. Do të na duhet që në këtë luftë të shënjtë për liri dhe pavarësi të derdhim edhe gjakun tonë, gjakun e fëmijëve, të motrave, të baballarëve tanë. Po jemi të vendosur ta çojmë gjer në fund. Prefekti na quan ne «të qmëndur», «të rinj», «të rrëmbyer» dhe thotë se atij iu dhimska populli i Kurveleshit. Ai është një i shitur te fashizmi kokë e këmbë. Atij dhe përkrahësve të tij u dhimbën jo populli e Atdheu, po kolltuqet, sarajet, çifliqet që i kanë vënë me gjakun dhe djersën tonë. A e dini ju ç'do të thotë, sipas prefektit, «të presim gjersa të vijë koha, pastaj të dalim maleve»? Do të thotë që ta mbajmë den-baba-den pushtimin fashist në Shqipërinë e

dashur? Ai ka hall që ne të hedhim armët, se pastaj e ka më kollaj të na therë si kasapi. Dhe si ta bejë këtë, prefekti do të thotë: «S'ka nevojë fare të dalim në male.» Jo, zoti prefekt! I keni bërë llogaritë shumë gabim, kur keni menduar se mund ta bleni popullin e Kurveleshit me miell e oriz. Ju jeni një i shitur, një mbeturinë e Shqipërisë, një thikë pas shpinës së atdheut. Ne e dimë që ju s'do të luftoni kurrë kundër atij që ju ushqen si kaun në grazhd. Ju jeni një qen besnik i fashizmit. Dhe qeni që pret të zotin t'i hedhë të hajë në korite, nuk e kafshon kurrë atë. Si thoni, burra dhe gra trime të Kurveleshit, a mund ta shesim ne nderin dhe lirinë për disa thasë me makarona?

Populli filloj të thërrasë:

— Le të vijë prefekti i fashizmit. Ne do ta presim me pushkë!

— Dëgjoje ç'thotë populli! Kjo është përgjegjja e tij. — iu drejtua Mustafai, agait Qemal Dudo. — Ju jeni një kasnec i prefektit, i Ali Këlcyrés me shokë, jeni sahanlëpirës i fashizmit. Ju shani komunistët, shpifni kundër tyre, po shikoje, ne populli na do apo jo. Ju shpifni kundër nesh se e dini që do t'u shëmben sarajet e çifliqet, që populli do t'ju shkulë nga kolltuqet. Ju që hiqeni si miq të popullit, jeni armiq më të ligj të tij. E kini grabitur dhe poshtëuar në shekuj këtë popull. Nga djersa e ballit të tij keni mbushur xhepet me flori, e keni gjetur të paorganizuar, e keni përçarë, e keni tradhëtuar. Ju jeni tregëtarë të gjakut të popullit dhe, tani që ka ardhur fundi, kërkoni të mbështetni kryet në preherin e Duçes. Mjerë ju që do të zhuriteni nga mëria dhe urrejtja e gjithë brezave shqipëtare!

Agai mbeti i hutuar. Populli i priste fjalët e komunistit të zjarrtë me duartrokositje.

— Ja lulet me tē cilat do ta presim nënprefektin! — bërtiste turma duke ngritur pushkët lart.

Aty pér aty Mustafai hartozi përgjegjen e letrës. Letra iu lexua popullit dhe iu dërgua prefektit. Aty thuhej: **Së pari**, populli i Kurveleshit nuk e pranonte tē kthehej përsëri pushtetin fashist, ai e kish ndjekur me armë. Çdo përpjekje që tē bëhej pér ta rikthyer, do tē pritej me luftë tē vendosur. **Së dyti**, malet e Kurveleshit nuk kishin pranuar kurrë tē shisnin nderin e lirinë me miell e oriz. Mielli dhe orizi i fashizmit ishin helm pér popullin. Më mirë vdekje se sa tē hanin nga buka e tradhëtisë. **Së treti**, kërkohet tē ruhej jeta e shokut Shefqet Peçi që ishte arrestuar pér aktivitet revolucionar dhe tē lirohej menjëherë. Përndryshe, vetë jeta e prefektit vihej në rrezik.

— Ne e kemi provuar, — tha Mustafai, kur mbaroi së lexuari letrën, — se ato që themi jemi tē vendosur t'i bëjmë. Tani fjalën e ka trimëria jonë, armët tonë! A jeni gatë ju, burrat dhe gratë e Kurveleshit, pér tē zënë që sot kufitë e krahinës sonë dhe pér ta pritur pushtetin fashist me pushkë?

Turma duke ngritur përsëri pushkën lart brohoriti:

— Të gjithë jemi gati!

Dhe që atë ditë forcat u nisen në drejtim tē Lekdushit, tē Pilurit tē Himares, tē Salarisë, Kallarritit, Borshit, drejtime nga mund tē sulmonin forcat fashiste.

Mustafai si bir i partisë, ishte i bindur se populli ka në gjirin e tij një forcë tē pamposhtëshme,



Heroi i popullit Mustafa Matohti.

mjafton që të jetë i bashkuar. Armiqtë dhe tradhtarët ishin munduar me shekuj ta mashtronin, ta gënjenin, ta përçanin dhe pastaj ta shtypnin. Andaj Mustafai bente një punë të palodhur si një agitator i zjarrtë. Sa e sa herë kish dalë fitonjës edhe në duele politike publike me njerz që n'ato

kohë njiheshin si «patriotë të mëdhenj», si diplomatë e baballarë të kombit.

Ja një nga shembujt e shumtë:

## Ballë për ballë me Ali bez Këlcyren

Ishë marsi i vitit 1943. Mustafai ndodhej në një fshat të Permetit. I vajti lajmi se në vendin e quajtur Goricë, do të bëhej një mbledhje me popullin e krahinës. Në mbledhje do të fliste Ali Bej Këlcyra, një nga kokat politike të Ballit Kombëtar. Ali Bej Këlcyra e hiqte veten si patriot, ai kish mjaft influencë në atë krahinë. Shumë njerëz besonin ende se beu përpiquej për Shqipërinë. Dhe në atë mbledhje s'kish dyshim se beu për të mbjellë farën e përçarjes, do të përdorte gjithshka, demagogjinë, autoritetin e patriotit, influencën personale, frikën. Pra, duhej të mos lejohej që beut t'i priste palla më të dy anët. Duhej që t'i pritej gjuha edhe atje e përpara popullit. Të demaskohej fytyra e tij e vërtetë.

Në krye të gjashtëmbëdhjetë vetave ai u nis më këmbë duke udhëtar për tërë natën, gjersa të nesërmën arriti në vendin e mbledhjes.

Populli ish grumbulluar dhe beu ish gati për të folur. Rojet e ndaluan Mustafanë me tre shokët e tij, duke i thënë se nuk pranohej asnjë njeri i huaj, dhe se ajo ish një mbledhje e popullit të krahinës së Këlcyres.

Mustafai u tha rojeve të lajmëronin beun se përfaqësonjës të Frontit Nacional-Çlirimtar kërkonin të merrnin pjesë në atë mbledhje dhe nuk do të tërhiqeshin as edhe përpara forcës së armëve.

Në atë kohë shokët e tjerë të armatosur qëndronin pak më larg të gatshëm për çdo të papritur. — Beu do të flasë në këtë mbledhje për Shqipërinë dhe ne, si shqiptarë, duam të dëgjojmë se çfarë do të thotë! —

Kjo bisedë me rojet zhvillohej aqë afër sa tërroqi vrejtjen e popullit dhe të beut, i cili, kur e pa Mustafanë me ato rrobat e vjetra, të shkurtër, të dobët, tha me një ton nënvleftësonjës:

— I lejoni të vijnë! Prej tyre s'ka për të ndodhur asgjë.

Ndërkaq Ali Bej Këlcyra filloj fjalin:

— Unë, si njeriu juaj, që më keni dëgjuar në çdo kohë, dua të më dëgjoni edhe tani në këtë gjëndje të vështirë. Mua dhe shokëve të mi na takon që t'i tregojmë popullit rrugën e drejtë, ta shpëtojmë nga katastrofa ku duan ta fusin disa njerëz.

«Kur zbarkoi Italia në portet tona, unë u maliengjeva dhe nuk më mbaheshin lotët, O vëllezër! Në ato çaste mu kujtuan vitet e 1914-ës dhe të 1920-ës, kur së bashku luftuam kundra pushtonjësve grekë e italianë. Ne prap do t'i rëmbejmë armët. Po koha nuk ka ardhur akoma. Prandaj duhet të rrimë të qetë nëpër shtëpitë tona. Ushtritë italiane dhe gjermane kanë zaptuar botën. Kush guxoi të ngrihej kundër tyre, u dogj në zjarr e hekur. Tani ushtritë e Hitlerit dhe të Duçes janë në portat e Moskës. Po ç'rëndësi ka në qoftë se kryeqyteti i Rusisë nuk ka rënë akoma? Gjithë Rusia është pushtuar, pra, edhe Moska do të dorëzohet në një ditë të afërt. Veç ata që nuk u kanë kundërshtuar italianeve dhe gjermaneve, kanë mundur të jetojnë të qetë në shtëpitë e tyre. Po ç'mund të bëjmë ne, një grusht shqiptarë, një vënd kaq i vogël, kur janë

gjunjëzuar vende kaq të mëdha e të forta, si Franca, Rusia e të tjera? As unë nuk e dua Italinë këtu. Po, po të kapim sot armët kundër saj, sikurse thonë disa djemuri, kjo do të ishte një marrëzi e madhe. Kjo do të thotë të shuash gjithë popullin, jo vetëm të mos mbeten njerëz, po të mos mbijë as bar e as gjethë. Mos të dëgjojmë disa të pa shtëpi e prokopi; po të sigurojmë qetësi të plotë në krahinën tonë. Të mos na vriten djemtë tanë, të mos na digjen shtëpitë tona.

Aty pranë ish ulur Mustafai dhe mbante shënim në një blok. Ai kish shënuar 17 pika nga fjalimi i beut. Kur njerëzit u ngritën dhe u bënë gati për të ikur, se beu u tha «mbaruam» mund të shkoni», Mustafai u çua menjëherë në këmbë dhe thirri:

— Prisni, vellezër! Ju gënjen ujku plak!

Në atë çast sytë e turmës u përqendruan te ai burrë i shkurtër e energjik. Të gjithë qëndruan me një ndjenjë habie të papritur. Ato fjalë kishin shkaktuar efektin e plasjes së një bombe.

— Ju gënjen ujku plak, vellezër! — përsëriti Mustafai. — Oxhaku i Ali Këlcyrés eshtë oxhaku i turpit, i tradhëtisë. Në sarajet e tija kanë gjetur vdekjen qindra patriotë e njerëz të ndershëm. Ju e dini të gjithë se pranë sarajeve Ali Bej Këlcyra ka një sterë që del në Vjosë. Në atë sterë janë hedhur kufomat e kushedi sa njerëzve që kanë qenë të rrezikshëm për familjen e beut. Këtë punë xhelati, beu që foli këtu, e ka trashëguar që nga gjyshërit e stërgjyshërit e tij. Familja e Ali Bej Këlcyrés ka jetuar me punën tuaj, mbi kurrizin tuaj, me gjakun dhe djersën tuaj.

«Po kohët e fundit ti na qënke «shqetësuar» për

fatin e popullit, Ali Bej! Ty nuk të dhimbset populli, po vajton fatin tënd. Ti e di mirë, o beu tradhëtar, se po u shporr Italia fashiste, do të shemben dhe sarajet e tua, do të japësh llogari për të gjitha krimet dhe tradhëtitë që ke kryer mbi kurri zë të popullit dhe të atdheut.

«Ti na paske derdhur lot mallëngjimi atë ditë që Italia fashiste shkeli në truallin e tokës sonë mëmë. Ne nuk u besojmë lotve të tu. Ata janë si lotët e krokodilit. A nuk ishe ti, Ali Bej, me gjithë shokët e tu, që ja shite që me kohë Italisë fashiste Shqipërinë? A nuk je ti me shokët e tu, Ali Bej, që i ben thirrje sot popullit të mos luftojë kundër pushtonjësit fashist? Mjaft ke luajtur me fatin e popullit. Sado që të ndryshosh qimen, ne të njohim mirë, o ujku plak!»

Fjala e Mustafa Matohitit, e bilbilit të maleve, kish bërë që beu të mos qëndronte më në atë pozën e një oratori të sigurt, siç kish bërë gjer ahore, po me të marrë vesh se ai që po fliste ishte Mustafa Matohiti, iu afrua pranë dhe i tha mengadale:

— Zoti Mustafa! Nuk është mirë që këto gjëra t'i thoni në popull! Nëqoftëse nuk merremi vesh për disa gjëra, ne mund të merremi vesh veças me njëri tjeterin.

Mustafai, me gjithë vrullin revolucionar që e karakterizonte, iu kthyen menjëherë:

— Jo, beu tradhëtar! Unë me ty nuk mund të bie në asnje marrëveshje.

Dhe përsëri iu drejtua popullit:

— Vëllezër! Dëgjoni se ç'po më thotë beu i tradhëtisë. Të mos jua them hapur gjithë poshtëritë e tij, po të merrem vesh më të, kur të jemi vetëm. Jo, bej, ju jini mësuar të kurdisni plane

prapa kurrizit të popullit. Ju jeni nga ata që të vrasin natën e të qajnë ditën.

«Këtu, Ali Bej, para gjithë popullit, t'i shtrojmë të gjitha çështjet dhe ky vetë le të gjykojë mbi fatin e tij, ky vetë të vendosë se cila rrugë duhet zgjedhur. Ju e kini frikë të vërtetën, o beu tradhëtar! Ju e kini frikë popullin, fuqinë e tij, drejtësinë e tij!

«Vellezër! Ali Beu e bëri fashizmin si një lubi që ne të trembemi, të lëshojmë armët! Sado i fortë që të jetë fashizmi, s'do mundet kurrë të shuajë një popull! Kundër tij janë ngritur gjithë popujt e botës, duke përfshirë edhe popullin italian e gjerman. Është e vërtetë se fashizmi pushtoi një varg shtetesh, si Francën, Austrinë, etj. sepse popujt e këtyre shteteve u tradhëtuan nga njerëz të kallëpit të Ali Bej Këlcyrés. Tani fashizmi është vënë në mes zjarresh. Taktika e tij e «luftës rrufe» për të pushtuar, brenda pak kohëve, shtetin sovjetik dështoi. Nuk do të jetë e largët dita, kur fashizmi do të marrë grushtin shkatërronjës të urrejtjes popullore. Ne do të luftojmë dhe do fitojmë. Më mirë të vdesim se sa të rrojmë nën thundrën e fashizmit, që përkrahët nga tradhtarë, si Ali Bej Këlcyra, me shokë.

Shumë njerëz nga turma, të entuziazmuar, thërrisinin:

— Folë, o bilbil i vërtetë!

— Të lumtë goja!

— Ne jemi me Frontin Nacional-Çlirimtar.

Kështu Mustafa Matohiti plot zotësi, i patrembur, e ktheu atë mbledhje, që kish përgatitur prej kohësh Ali Bej Këlcyra, për të frenuar lëvizjen partizane, kundër tij.

Këto janë vetëm disa episode nga veprimitaria revolucionare e heroit të popullit Mustafa Matohiti. Gjithëjeta e tij do mbetet një shemboll i gjallë i devotshmërisë për çështjen e partisë, i patriotizmit të lartë revolucionar, i vetëmohimit për popullin, për atdheun. Ne që kemi pasur rastin të punonim me Mustafanë, na kanë mbetur të pashlyera gjithë ato vëgori të karakterit të tij që e benin atë një njeri të thjeshtë, të afërt, të dashur, të dashur me të gjithë. Sa kanë qenë rastet kur jepte xhaketën e vet, kur ndante goftë dhe një kafshitetë buke, kur shkonte i pari drejt rreziqesh, që mund t'i kushto-nin jetën dhe gjithmonë pa bujë. Po çdo fjalë, çdo lëvizje, çdo xhest, çdo veprim kish tek ai njeri një natyrësi të patreguar, që mund të rrjedhë vetëm nga një shpirt i madh e fisnik, nga një shpirt revolucionar, siç e kish Mustafai.

Nuk di pse kur e sjell ndër mend pas kaqë vjetësh më kujtohen gjithmonë me një ndjenjë mallengjimi e krenarie vargjet e popullit:

Bilbil Matohiti që s'të shoh me sy...

Dhe ai dijti të këndoja. E këngët e bilbilit s'vdesin kurrë.

## Operacioni i dhjetorit 1942

Fashistët, si e panë se me demagogji e frikësimë nuk arriten të mposhtin popullin e Kurveleshit, u versulën të tërbuar me ushtritë e tyre për operacione vendimtare. Operacioni i parë filloi më 2 dhjetor 1942. Ushtritë fashiste bashkë me prefektin e Gjirokastrës, Tahir Kolgjinin, sulmuani kundër maleve të Kurveleshit, nga të gjitha drej-

timet: nga Vlora, në drejtim të Kallaratit e të-Bolenës; nga Salaria, në drejtim të Nivicës e Re-xhinit; nga Borshi e Piluri, në drejtim të Kuçit; nga Tepelena, në drejtim të Lekdushit; nga Gjiro-kastra, në drejtim të Kolonjës e Golemit. Pika e takimit të të gjitha këtyre forcave: fshati Gusmar, ish qendra e nënprefekturës. Plani ish mjaft i studjuar. Forcat partizane, të sulmuara nga të gjitha anët, do të detyroheshin të hidhnin armët.

Komanda partizane e kishte parashikuar një operacion të tillë. Andaj me kohë populli u udhëzua të tërhiqte mallin, bagëtinë dhe njerëzit, përtë qenë jashtë çdo rreziku, të fshihej nëpër male. Megjithëse ish dimër, gra, fëmijë dhe pleq braktisën fshatrat. Në ato ditë të ftohta të dhjetorit, me shira të shpeshta, shpellat dhe pyjet ishin shtëpitë ku u strehua gjithë popullata. Nga urrejtja e madhe që kishin përfashistët, nuk pranoi të rrinteasnjeri nëpër fshatra, me përjashtim të disa pleqve mjaft të kaluar nga mosha.

Forcat partizane, së bashku me popullin, kishin dalë përtë pritur me luftë forcat fashiste të qarkut të Gjirokastrës të kombinuara dhe me ato të qarkut të Vlorës. Përpjekja e parë u bë në Buzë të Bredhit të Lekdushit. Pas disa sulmesh, armiqtë u thyen, dhe u tërroqën në Palçie të Luzatit. Pas dy ditësh forcat fashiste ndërmorën një sulm tjetër edhe më të gjërë. Luftimet vazhduan përtiri orë në Mal të Lekdushit dhe të Progonatit. Në atë kohë forca të tjera armike sulmonin nga Mali i Picarit, në shpinë të forcave partizane. Kështu forcat tona u tërroqën, pasi bënë edhe një përpjekje tjetër me ato që përparonin nga Lekdushi.

Fashistët, duke qëlluar me artileri forcat tona

në majë të Bohetinës të Progonatit dhe duke përparruar me forca të shumta, arritën të pushtonin fshatin e Progonatit. Tani pozicionet e partizanëve dhe vullnetarëve u vendosën në Brigjet e Kaleçkës. Forcat armike deshën që të kalonin në drejtim të Gusmarit, ish-qendrës së nënprefekturës. Atje u bë përsëri një përpjekje e ashpër. Ne sulmuam dhe i detyruam të zmbropseshin gjer ku janë sot Varezat e dëshmorëve.

Mirëpo, në bazë të njoftimeve që na erdhën, forca të tjera të shumta po vinin nga Golemi përtë dalë në Qafën e Gomarthes. Kjo do të thoshte që ne të viheshim në një darë që sa vinte e shterngohej më tepër. Nga ana strategjike ne nuk duhet të lejonim në asnjë mënyrë që ushtritë fashiste ta merrnin atë Qafë. Andaj organizuam një qëndresë të fortë. Partizanët trima dhe forcat vullnetare, megjithëse të paktë në numur, të armatosur keq, jo vetëm që nuk u tundën nga pozicionet, po edhe kundërsulmuam. Ahere fashistët u detyruan të hiqnin dorë nga plani përf të na dalë pas shpine dhe u kthyen përf t'u bashkuar me forcat që kishin zenë pozicione në fshatin e Progonatit.

Ahere komanda fashiste e drejtoi tehun e sulmit në një krah tjetër po aqë të rrezikshëm: që nga Tepelena u nisën forca të mëdha dhe dolën në Qafë të Kreshkës, d.m.th. në drejtim të fshatit Nivicë, Rexhin, Gusmar.

Ne përsëri viheshim në mes të dy zjarreve; pra, bëhej e domosdoshme tërheqja e forcave tona në pozita më të favorshme.

Komanda e forcave partizane e vullnetare, duke çmuar gjendjen e krijuar, vendosi që forcat tona të vendoseshin në këtë vijë fronti:

Nga Maja e Sqivovikut të Golemit, në Mal të thatë të Gusmarit, në Mal të Mesëm, në Gerxhin e Ledheve të Qesare, gjer në Majë të Hies së Zezë. Në këtë mënyrë ne formuam një kordon që nuk u lejonte pushtonjësvet fashistë të kalonin në Kurveleshin e poshtëm dhe në të njëjtën kohë mbronim të gjitha familjet që kishin lënë fshatrat dhe kishin gjetur strehim në Shurin e Gusmarit dhe të Kuçit.

Fashistët ndërmorën disa sulme, sidomos në drejtim të Shurit të Gusmarit, po nuk patën sukses.

Forca të tjera partizane e vullnetare impronin pozicionet në drejtim të Borshit e Pilurit e të Kallaratit. Këto drejtoheshin nga Jaho Gjoliku, Memo Metua, Bexhet Mema, Miho Xhani, Ali Lala, Avdul Hakiu, Barjam Kovarfi dhe Kadri Aliu.

Prefekti dhe fashistët u tërbuan që s'gjetën, kudo që shkelën, asnje njeri. Ai u përpoq me çdo mënyrë të vihej në lidhje me udhëheqës kryesorë të Lëvizjes, të fuste përçarjen midis tyre, po nuk ja arriti. Në një rast ai mori telefonin nga ishqëndra e nënprefekturës dhe kërkoi Kuçin, që ish në duart tona.

Aty i dolli shoku Memo Meto

— Kush jeni? — e pyeti Memua.

Prefekti, pas shumë ngurimesh, i tha emrin. Atëhere Memua iu përgjegj:

— Është mirë që të thoni emrin tuaj të plotë, zoti prefekt. Unë jam Memo Meto komunisti dhe ju jeni Tahir Kolgjin fashisti.

Prefekti mundohej të mbante gjakftohësine, duke i shpjeguar se duhej të merreshim vesh. Po Memua iu përgjegj: — Ne me tradhëtarët e pollit shqiptar s'mund të bëjmë asnjë marrëve-

të përdorim rrugën më të mirë në kushtet që ndodhemi.

Nënë Kafazja m'u përgjegj me një ton të prerë:

— Ne nuk i durojmë dot fashistët në vendet tona. Ju kini thënë se do të luftojmë. Tani pse tertiqeni? Edhe po të mos na merrni ju pas, ne do të shkojmë të lirojmë vendet tona.

Nuk e kam parë veten më ngushtë se sa ato çaste. Popullit i qe tronditur besimi ndër ne. I mbushur me urrejtje pér fashistët, nuk merrte para-sysh asnjë sakrificë. Burra e gra, të rinj e të reja, ishin gati që të gjithë pér të dhënë jetën në një përpjekje të pabarabartë me armikun. Shtëpia e Nënë Kafazes ishte një nga bazat tona më të vjetra. Sa herë na kish pritur e na kish përcjellë! Sa herë na kish dhënë bukën e fëmijëve! Ish trishtuar pér ne si një nënë e vërtetë. Po ja edhe ajo kërkonte përpjekje, përleshje drejtpërdrejt me armikun. Kjo ish nëna e Alem Kondit, e Rahimesë dhe e Vitos që kushedi sa herë bënин roje pér të na ruajtur ne kur bënim mbledhje.

Turma u nis në drejtim të Shurit të Kuçit dhe të Gusmarit, atje ku ish vija e frontit me ushtritë fashiste. Kur ne e pamë se çdo orvajtje pér t'i kthyer ishte e kotë, u detyruam të shkonim edhe ne pér të luftuar së bashku. Në këtë kohë duket një njeri i veshur civil, i shoqëruar nga dy partizanë tanët. Në fillim kujtuam se mos ishte ndonjë spiun që e kishin arrestuar partizanët. Por kur u afruan, e njohëm menjëherë se ai ish një nga të dërguarit e Komitetit Qarkor të Gjirokastrës. Ne i shpjeguam menjëherë si qëndronte puna. Populli qëndroi. Ne e paraqitëm të dërguarin e qarkorit.

Ai tha: Ne, bijtë tuaj, jemi shumë krenarë

për një popull të tillë trim, që s'trembet as përpara vdekjes. Partia Komuniste kërkon luftë të pandërprerë dhe pa kompromis me fashizmin. Ajo që ju kanë urdhëruar shokët tanë, nuk është ndërprerje e luftës, po zbatimi i luftës partizane, për t'iu përshtatur kushteve. Ne s'do ta lëmë armikun rehat, ai dhe atje ku është, ka gjetur vetëm katër muret e shtëpive, dhe, duke mos pasur asnjë mbështetje, do të detyrohet të kthehet në strofkën e vet.

Vetëm prania dhe fjalët e të deleguarit të Qarkorit mundën ta bindnin popullin që të pra-nonte takтикën e luftës partizane.

Në një grup ku ishte dhe nënë Kafazja me plakën 60 vjeçare Vito Gumeni, të dyja me nga një pushkë italiane të gjatë, dëgjova të thoshnin:

— Kishin të drejtë djemtë e varfër. Po ne s'u besonim. Lufta do tertip të madh.

Prefekti vazhdonte të përdorte demagogjinë. Ai u bëri thirrje familjeve që të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre, u përpinq të bënte pér vete njerëz të lëkundur, sidomos parësinë me të cilën filloj të krijonte lidhje. Po në mes të parësisë kish edhe nga simpatizantët tanë.

Patriotë si Zenel Mehmeti, Magrip Bana, Ben Mersini, Fejzo Dalipi, Feim Haxhiu, Halit Bisha dhe të tjera, i thanë hapur prefektit në mbledhjen që patën se partizanët nuk mund të asgjesoheshin. Me ata ish bashkuar i gjithë populli. Siç e shikonte dhe ai vetë, jo vetëm burrat, por edhe gratë e fëmijtë kishin shkuar pas tyre në male. Partizanët ishin një numër i madh, dhe në qoftë se prefekti s'donte gjakderdhje më të madhe, si shqiptar që ishte (pse ai ashtu e hiqte veten gjith-

monë), duhej të têrhiqeje menjëherë nga krahina e Kurveleshit.

Dhe prefekti në krye të tê gjitha forcave fashiste u detyrua më në fund të têrhiqeje, jo se ishte shqiptar dhe i dhimbsej krahina e popullit të Kurveleshit, siç thoshte me plot hipokrizi, po se s'gjeti asnje mbështetje dhe vazhdimisht ishte në kërcënimet e forcave partizane. U mjaftua vetëm tê caktonte dy njerëz vendas pér tê kryer përkohësish misionet e nënprefektit dhe tê kryetarit të komunes. Po detyrat e këtyre dy njërzëve, më tu larguar milicët dhe xhandarët, pushuan së qëni. Këtë e dinte dhe vetë prefekti. Po ai e bëri këtë emërim ndofta pér tê ngushëlluar veten sadopak dhe pér tê përligjur tê ashtuqojturën «sukses tê operacionit», që ishte një deshtim i plotë. Po prefekti la prapa spiunët e tij. Këta filluan tê thoshin: — Ne duhet ta pranojmë vendosjen e nën-prefekturës, pasi kjo është në interes tê luftës partizane. Ne do tê marrim nga qeveria miell, oriz, sheqer dhe, duke pasur populli, do tê ketë mundësi tê ushqejë edhe partizanët, do tê mundë t'i strehojë, e tê tjera. Këto mendime disfatiste, tê përhapura nga agjentët e fashizmit, u goditën ash-përsisht.

Pas operacionit tê dhjetorit numuri i partizanëve u shtua, popullit iu shtua akoma më tepër urrejtja pér fashistët dhe veglat e tija, iu forcua më tepër bindja dhe besimi te Fronti Nacional-Çlirimtar, te Partia komuniste.

### Operacioni i prillit 1943

Me këtë gjendje nuk mund tê pajtohesin fashistët. Ata katër muaj më vonë filluan një operacion tjetër, operacionin e prillit. Ky vërshim i

ri i forcave fashiste kundër krahinës së Kurveleshit tani bëhej në disa kondita të tjera. Për fashistët ish e qartë se andej e tutje asnjetë administratë e vendosur prej tyre nuk mund të kish jetë. Megjithëse u bë një operacion në muajin dhjetor, në një kohë të vështirë, ai nuk solli asgjë. Pra, duhej përqarë lëvizja nga brenda. Dhe kjo ish një takтикë e rrezikshme. Njerëz si Ismail Golemi, Dervish Rexhepi, Ali Këlcyrë, Hysni Lebenica, eksponentë të Ballit kombëtar, zhvilluan një veprimtari të ethëshme për të shkëputur një pjesë të popullit nga Fronti Nacional-Çlirimtar. Kështu ata formuan çeta me njerëz të shitur. Po në ato çeta kish dhe shumë veta të gënjer. Ato përdorenë si një kundërbalancë për çetat partizane. Atëherë organizata e Ballit kombëtar hiqej në popull se dhe ajo do të luftonte «kur të vinte koha» kundër Italisë për të mbrojtur Kurveleshin.

Operacioni i prillit të vitit 1943 ish më i egër edhe më i madh se ai i dhjetorit të vitit 1942. U ruajt rasti kur forcat partizane të Kurveleshit ishin hedhur në krahina të tjera. Veç kësaj, ato ditë, dhe këtu dukej që kish marrëveshje, erdhi në Kurvelesh çeta që drejtohej nga Seit Shehu, një ballist i tërbuar. Me t'u marrë vesh se forca të mëdha fashiste po sulmonin Kurveleshin nga të gjitha drejtimet, me thirrjen e këshillave nga të gjitha fshatrat, u formuan kompani dhe batalione dhe shkuan për të pritur forcat armike me luftë. Në Gusmar, ku ish komanda e forcave partizane, erdhi dhe çeta e Seit Shehut dhe Limos Runës. Ata thanë se kish ardhur koha që ta provonin atë që kishin thënë se: «do të luftonin kundër forcave fashiste». Andaj kërkuan që t'u caktoheshin

pozicionet e luftës. U dërguan në vendin e quajtur Buza e Bredhit të Lekdushit, në drejtim të Tepelenës. Aty ishte edhe një pjesë e forcave tona. Fashistët kishin qëndruar në pozicione dhe s'po sulmonin. Po natën e 4 prillit, njerëz të çetës së Seit Shehut bënë akte tradhëtie të vërtetë: ata u hoqën gjilpërat dy mitrolozëve dhe lanë të lirë disa stigje.

Këshiu forcat fashiste përparuan në drejtim të Lekdushit. Partizanët, si rrjedhim i kësaj tradhëtie, u gjendën të rrethuar. Gjithashtu forca të mëdha sujmuani edhe nga Kurveleshi i poshtëm dhë pushtuan Fterën, Çorrajin, Kallaratin dhe Kucin. U goditën me artileri të rëndë fshatrat e Lekdushit, Progonatit. Një regjiment u vendos midis Rexhinit dhe Gusmarit, një tjetër në fshatin Nivicë dhe i treti në Progonat. Artileria e tyre rrahu pyjet dhe shpellat, ku ish strehuar populli. Gjithashtu u mëtraluan të gjitha vendet me anë të aviacionit. Kurveleshi u dogj krejt. Mbetën vetëm shtëpitë e atyre që ishin simpatizantë ose spiunë të fashizmit. Fashistët pushkatuan 14 veta në fshatin Rexhin, vranë babanë e dëshmorit Dalip Tare, korieri Zigur Gjoka u zu befasisht dhe u masakrua. Vrasje të tilla kryera pothuajse në çdo fshat, si në Progonat, në Lekdush, në Kuç, në Kallarat, në Bolenë, etj.

Gjithë qëllimi i tyre ishte që, me anë të dje-gëjeve, vrasjeve, intrigave, të mposhtnin qëndresën e popullit, ta largonin nga Partia Komuniste. Këshiu, në një takim që pati Muhamrem Duka me patriotin Magrip Bana dhe Fuat Iliazi, e nisi bisedën kështu:

— Një herë ishin tre qe, një i bardhë, një lärush dhe një i zi. Një ditë u takuan me ujkun dhe

ai u tha që të beheshin vellezër. Pas shumë lutjeve të ujkut të tre qetë pranuan. Pas ca kohësh ujku u propozoi kaut larush dhe të zi të hante kaun e bardhë se ai dallohej që larg nga gjahtari. Si e hëngri atë, kërkoi të hante larushin dhe më në fund i erdhi radha kaut të zi, që kish mbetur vetëm. Por atë e hëngri pa e pyetur fare.

Tradhetari Muhammed Duka me ujkun personifikonte neve dhe në mënyrë të têrthortë kérkon te të dinte mendimin e xha Magripit. Ata më kishin organizuar një atentat, duke futur njerëz të tyre gjer në radhët e çetës sonë.

Patrioti Magrip Bana iu përgjigj Muhamremit: Ne i kemi dhënë fjalën Partisë dhe nuk e bëjmë dysh. Vetëm ti je një njeri me njëqind surrate.

Për 27 ditë që zgjati operacioni, fashistët treguan një egërsi të pashembelltë. Ata e ktheyen gjithë krahinën në një gërmadhë të vërtetë. Fashistët deshën t'i tregonin popullit të Kurveleshit se po të mos hiqte dorë nga lëvizja partizane, ata ishin të vendosur të merrnin masat më çnjerëzore, më barbare. Po morali i popullit nuk ra. Ai, siç kish bërë dhe në operacionin e parë, kish braktisur fshatrat dhe ish strehuar në folenë e përjetëshme të tij, në male. Egërsisë dhe barbarizmave të fashizmit populli iu përgjegj me shtimin e radhëve partizane, duke dërguar nëpër çeta bijtë më të mirë të tij, duke shtuar kompaktësinë rrëth Frontit Nacional-Çlirimtar.

Në ato ditë të furishme këngëtarët labë, sapo gjenin pak kohë, mblidheshin dhe ja merrnin një këngë:

**Bërtet nëna: — Djem ku jini?  
Merrni armët dhe u bini!  
Në mos keni armë, i mirri!  
Ja mirri atij qafiri!**

**Të tillë moral të lartë kishin partizanët trima e populli heroik i Kurveleshit.**

Këto episode të hidhura po i vinin re me keqardhje edhe ata që kishin ardhur me urën e zjarrit në dorë për të nënshtuar Kurveleshin. Karakteristik është një telegram që i drejton në atë kohë Ministrisë së Punëve të Brendëshme Koço Muka, kuestor i Qarkut të Gjirokastrës.

„Propaganda e zhvilluar nga komunistët është zhvilluar në masë të gjerë në Kurvelesh, mbasi ka qenë zonë e lirë që nga largimi i autoritetit më 28 Nandor 1942. Ushtria që ben operacionin duhet të përsohet më shumë dhe do të kemi konseguencia jo përtë mira. Po këtë mendim ka edhe komanda e operacionit. Tepelenë, 6 prill 1943.“

Sic shihet, kuestori ankohet për forcën e agjitationit komunist dhe ai, si të vetëmen mënyrë për të nënshtuar popullin, shikon forcën e armëve. Në mes të popullit të Kurveleshit dhe pushtonjësve e tradhtarëve bëhej luftë për jetë a për vdekje.

Nga dy operacionet kundër Kurveleshit ndodhi ajo që haset shpesh në historinë e gjithë popujve: Pushtonjësit barbarë, kur hasin në qendresë, shtojnë mizoritë e tyre dhe pikërisht kur ata presin nënshtrimin, popujt e martirizuar ngrihen me një urrejtje më të madhe, me një vetëbesim më të fortë. Me një fjalë, ata në Kurvelesh kishin mbjellë erën dhe kishin korruj stuhinë.

## Përçarja: arma e fundit e armikut

Tani për fashizmin dhe prefektin e Gjirokastrës ishte tepër e qartë se të rikthejë në Kurvelesh me forcën e armëve n/prefekturën, ish e pamundur. Dhe kur me shtypje dhe teror nuk arriten ku dëshironin, nxorën, në plan të parë, përçarjen e popullit me anë të tradhëtarëve.

Pas këtyre dy operacioneve, shtohen forcat e përherëshme të armatosura, të cilat në çdo rast të ishin gati për t'i bërë ballë armikut. Por edhe tradhëtarët, si Ismail Golemi, gjithashtu dalin fshat më fshat, duke grumbulluar kusarë dhe formojnë edhe ata çeta gjoja «për të mbrojtur Kurveleshin». Kjo ish e vetëmja mënyrë për të térhequr, për të gënjerëzit e thjeshtë, të lëkundëshmit. Një parullë tjetër që hidhni këta tradhëtarë në atë kohë ish se çetat e Kurveleshit nuk duhej të dilnin jashtë krahinës, pasi ato ishin krijuar thjesht për të mbrojtur kufitë e Kurveleshit. Ata kërkonin t'i jepnin Lëvizjes sonë një karakter regional.

Duhet të kujtojmë se në vitin 1943 nisi në vepriptari të hapët organizata e Ballit kombëtar. Dhe pikërisht në atë kohë njerëz si Ismail Golemi, Ali Bej Këlcyra, Zenel Beu, Dervish Rexhepi, Koço Muka, etj. ende e ruanin maskën e hipokrizisë, duke u hequr sikur «u dhimbsej populli» dhe ishin edhe ata «për të mirën e Shqipërisë», por thoshnin së «nuk duhej vepruar si partizanët».

Më kujtohet se më 11 maj të vitit 1943, në fshatin Progonat, tradhëtarë Ismail Golemi organizoi një mbledhje. Ishin mbledhur 500-600 burra.

Ismail Golemi tha se ish shumë i pikëlluar që e

shihte Kurveleshin të djegur e të shkatërruar. Ai u hoq si bir i këtij vendi, shprehu keqardhjen dhe lajmëroi se kish njoftim për një operacion tjetër më të tmershëm. Për këtë duhej të merreshin masa, u hoq sikur edhe ai dhe përkrahësit e tij ishin gati të luftonin, të bashkoheshin me partizanët, bile ai propozoi që të formohej një komandë e përbashkët dhe çetat të mos dilnin përtej kufive të Kurveleshit.

Duke folur në emër të Frontit Nacional-çlirimtar, ne hodhëm poshtë ato propozime hipokrite dhe antikombëtare.

Së pari, ne nuk pranonim që të formonim një komandë të përbashkët me disa çeta kusarësh, agjentë të fashistëve dhe të prefektit të Gjirokastrës, që pas të vjelash na kujtoheshin për të mbrojtur Kurveleshin. Së dyti, lufta jonë kish një qëllim kombëtar. Në Kurvelesh, në Skrapar, në Tropojë e Mallakastër, në qytete dhe në fshatra, kudo kjo luftë kish një qëllim të lartë: shpëtimin e Shqipërisë nga robëria fashiste dhe tradhëtarët e vendit. Prandaj çetat tonë, kur të ish nevoja, do të shkonin edhe jashtë Kurveleshit për të mbrojtur popullin, për të përkrahur dhe përhapur luftën kundër fashizmit, për të qëruar hesapet me agjentët e pushtonjësit.

Filluan diskutimet në popull. Ata pak përkrahës të Ismail Golemit u ngritën ta mbronin. Po gjetën një qendresë shumë të ashpër. Ata që përkrahnin Ismail Golemin ishin fare të pakët dhe populli i de-tyroi të largoheshin menjëherë.

Ismail Golemi shkoi thua jse fshat më fshat të Kurveleshit dhe organizoi mbledhje të tillë. Në Gusmar bile ai tha se partizanët të cilët ishin të gjithë çobanë, kurrë s'do të qenë në gjëndje të qeveris-

nin, të drejtonin ushtrinë, kurse ai dhe miqtë e tij ishin njerëz me «kulturë», të aftë për të udhëhequr kombin.

Kështu ai vërtetonte edhe karakterin klasor të luftës sonë. Ne, vërtet ishim çobanë e bij çobanësh, po Partia, vetë kërkesat e kohës na kishin mësuar dhe na mësonin si të udhëhiqnim forcat e armatosura dhe si të qeverisnim. Dhe në atë kohë kur Kurveleshi ish djegur dhe shkatëruar, këshi-llat fare mirë merreshin me administrimin e vëndit, rregullonin gjithë hallet dhe nevojat që u delnin fshatarëve, kujdeseshin për t'u siguruar bukën famili-jeve, zgjidhnin çdo mosmarrëveshje që mund të lindëte. Pra, populli e shikonte vetë me sytë e tij se sa pa themel ishin thëniet e renegatëve, se partizanët s'qenkeshin në gjendje të qeverisnin, të udhëhiqnin.

Ne verën e vitit 1943 ndodhi një incident i rëndë. Me urdhër të Shtabit të zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër në Kurvelesh erdhi çeta partizane e Bregut. Sikur e kemi theksuar dhe më parë, krerët e Ballit, si Ismail Golemi me shokë, duke hedhur idenë që çetat e Kurveleshit s'duhej të dilnin jashtë krajinës së tyre, jepnin si shembull çetën partizane të Bregut, e cila gjoja e kufizonte tërë veprimtarin e saj në zonën e vet. Po ja që u ndodhën para një të papriture. Profkat që ata lëshonin për të çorjentuar popullin, po u hidheshin poshtë. Të tërbuar nga inati, u përpoqën të përdornin edhe format më të ndyra për të kundërvepruar.

Në atë kohë çeta jonë ndodhej në Humelicë të Gjirokastrës. Në Kurvelesh ndodheshin të ashtu-quajturat çeta të Ballit, të udhëhequra nga tradhëtarët Seit Shehu e Limos Runa.

Çeta e Bregut kaloi fshat më fshat, gjersa arri-  
ti në Gusmar, ku ishin vendosur këto çeta të Ballit.

Me anë të këshillit të fshatit u lajmëruan fsha-  
tarët se paradite, në vendin e quajtur Gurët e  
Xhamisë, do të bëhej një mbledhje me fshatarët.  
Në mbledhje do të merrnin pjesë edhe përfaqëso-  
njësit e Ballit.

Shoku Andrea Varfi, komisar i çetës së Bre-  
gut, duke folur në emër të Lëvizjes Nacional-  
Çlirimtare, pasi theksoi qëllimet e Luftës Nacional  
Çlirimtare, demaskoi përpjekjet e fashizmit dhe të  
Ballit Kombëtar, për ta paraqitur të bardhën të  
zezë. Ai tregoi se çetat partizane, që ishin krijuar,  
nuk kishin si qëllim vetëm çlirimin e krahinave ku  
ato ishin formuar, por çlirimin e plotë të Shqipë-  
risë nga pushtonjësit e huaj. Ai e demaskoi orga-  
nizatën e Ballit duke e quajtur si shkaktare për  
djegien dhe shkatërrimin e Kurveleshit. Ai tha se  
ishin ballistët ata që u kishin treguar shtigjet dhe  
rrugët fashistëve për t'ju dalë prapa krahëve par-  
tizanëve, se ishin ballistët me agjentët e tyre që  
nuk linin gur pa lojtur kundër Lëvizjes Nacional  
Çlirimtare. U ndez një debat i ashpër midis për-  
faqësonjësve të Lëvizjes dhe atyre të Ballit.

Në këto çaste vjen lajmi se fashistët po orga-  
nizonin një operacion të ri kundër Kurveleshit.  
Ahore çeta partizane e Bregut vendosi të zinte të  
vetëmin shteg të lirë nga mund të vinte armiku,  
në Qafën e Kreshës. Ballistët, gjoja «të prekur» se  
Kurveleshi nuk kishte mbetur pa burra që të vinin  
bregasit për ta mbrojtur, «deklaruan se nuk do të  
lejonin që të «huajtë» të luftonin në shtëpitë e  
tyre dhe iu kanosën çetës partizane të Bregut, se  
po të guxonë të hapte zjarr kundër fashistëve,  
ballistët do ta sulmonin prapa krahësh.

Kur Limos Runa dhe Seit Shehu shkojnë në pozicionet e çetës së Bregut dhe se gjoja në emër të popullit të Kurveleshit kërkojnë të largohen partizanët bregas, shoku Andrea Varfi u përgjigjet: «Për ne Shqipëria nuk është e ndarë në kantone. Ne jemi një formacion i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare. Ne nuk marrim urdhëra, veçse prej Komandës sonë. Po të kini ndonjë ankım u drejtoni në Shtabin e Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër.

Kjo përgjegje i tërboi edhe më tepër dhe menjëherë forcat balliste zunë vend prapa shpinës së partizanëve të Çetës së Bregut.

Në Kurvelesh u dha kushtrimi nga Këshillat Nacional-Çlirimtare. Kur forcat fshatare muarën vesh se ballistët kërkonin t'u binin partizanëve të Çetës së Bregut pas krahëve sapo ata të hapnin zjarr kundër forcave fashiste që do të sulmonin Kurveleshin, u zemëruan në kulm. Gratë e Kurveleshit u thanë burrave: «Po të ngasin edhe një qime të djemve të Bregut, t'i shuan me maç e me kuç të gjithë ballistët». Brenda pak orëve në Gusmar u mblozhën përmbi 1500 veta të armatësor nga të gjitha anët. Partizanët e Bregut kurrënuk do ta harrojnë atë dashuri të popullit të Kurveleshit. Ja ç'qëndrim mbante populli ndaj partizanëve.

Demaskimi që iu bë Ballit në Nivicë me atë rast qe me plot gojën vdekje prurës për të. Kushdo e kuptoi se Balli nuk ishte tjetër veçse agjenturë e fashizmit. Edhe çeta, ku unë isha komisar, mori urdhër që të kthehej menjëherë në ndihmë të çetës partizane të Bregut. Të nesërmen, kur takova rrugës forcat teritorjale me komandant Jaho Gjoli-

gun, mora vesh prej tij se forcat e Ballit, të demaskuara keq, kishin iku me «bisht në shalë» përpara rrezikut që të shkatëroheshin plotësisht. Edhe forcat fashiste, duke parë gjithatë përgatitje, nuk guxuan të hidheshin në sulm; prandaj u tërhoqën nga gryka e Salarisë. Kështu çeta partizane e Bre-gut vazhdoi punën e saj në Kurvelesh dhe në sek-torët e tjerë, kudo e pritur me dashurinë më të madhe.

Edhe Ismail Golemi me shokë, me çetat që formuan, e demaskuan shumë shpejt vetveten në sy të popullit, si çeta në shërbim të pushtonjësit.

### Batalioni pagëzohet me zjarr

Batalioni që mori emrin e heroit të popullit «Asim Zeneli» u formua më 7 gusht 1943, te Rrepert e Kardhiqit. Bërrthama e atij batalioni ishin çetat e Kurveleshit, të formuara që në fillim të vitit 1942, ato të krahanës së Kardhiqit dhe të krahanave të tjera për rreth.

Dita e 7 gushtit u kthye në një festë të vërtetë popullore. Nga fshatrat e lokalitetit të Kardhiqit dhe të krahanës së Kurveleshit vinin burra e gra me desh dhe me cje përpara. Ata na puthnin e na përqafonin ne, partizanëve, që kishim arritur atje që më përpara. Sheshi gjemonte nga këngët dhe vallet. Gëzimi ishte i madh.

Formimi i batalionit kishte një kuptim të the-lë. Dikur nëpër malet e Kurveleshit, dolen dy tre veta, si Mustafa Matohiti me shokë, për të propaganduar luftën kundër pushtonjësve. Ahere nuk ishin të pakët ata që thoshin se s'kish çfarë t'i bënte «goxha Dovletit», Italisë, një dyfek i ndrysh-

kur; ose ç'do bënin 5-6 kalamanj që kishin marrë malin. Dhe ja tani nga guerilet, njësitet, çetat, po formohej një batalion. Populli po shikonte me sytë e tij, si partia po krijonte njësi të mëdha të ushtrisë nacional-çlirimtare. Më 10 korrik ishte formuar Shtabi i Përgjithshëm. Pak më vonë Shtabi i Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër. Dhe populli për këto ishte krenar, se gjaku dhe sakrificat e tij nuk shkonin kot.

Më kujtohet se atë ditë kishin ardhur jo vetëm të rinj, po dhe burra të kaluar në moshë, megjithëse duhej të bënin një rrugë të gjatë në këmbë, si Ilaz Memeti, Ahmet Daci, Magrib Bana, Riza Buzhga, etj. Njeri prej tyre, Ilazi, që më njihte, më përqafoi si një prind dhe më tha:

— Ju më parë ishit vetëm një çetë me trima dhe tmeruat fashistët. Tani kush do të guxoje t'i dalë përpëra këtij batalioni me luanë? Të luftoni si kini luftuar gjer tani me trimëri! Mos harroni se, kur ta dojë nevoja, edhe ne pleqtë jemi partizanë.

Pas katër orësh feste të vërtetë, ra boria dhe batalioni u rrjeshtua.

Komisari i batalionit, shoku Shefqet Peçi, tha se batalioni do të shkonte të bënte inaugurimin e tij, të merrte pagëzimin e zjarrit në luftë me fashistët. Që atë çast batalioni do të nisej për në Libohovë, ku fashistët dhe Balli kombëtar përndiq-nin, popullin, plaçkitnin dhe e frikësonin që të mos i përkrahte partizanët. Dhe ne duhej që armikun të mos ta linim të merrte frymë, duhej t'i tregojnë vendin, si ushtarë të popullit që ishim.

Vetëm kompania «Avni Rustemi» do të qëndronte për të mbrojtur bazën e Cepos.

Cepua ka qenë një nga bazat tona më të rën-dësishme e më të forta në jugë. Kush ka udhëtar nga Tepelena në Gjirokastër, kur arrin te Ura e Kardhiqit, mund t'i ketë rënë në sy, se më të djathët të xhadesë, në një grykë të ashpër, në fund të Malit të Gjërë, ngrihen disa qiparize. Ne që atje provuam armët tona, na lidhin me atë vend shumë kujtime. Sa herë e rrahu topi dhe mortaja Cepon! Sa herë u përleshëm grykë për grykë me italianët e ballistët! Çdo pëllëmbë toke e Cepos është larë me gjak. Ajo ish kthyer në një simbol të qendresës, të heroizmit. Dhe megjithëse Cepua nuk ishte shumë larg nga rruga automobilistike, thua jse nën hundë të tyre armiqtë e tradhtarët ishin detyruar të pajtoheshin me gjendjen e krijuar.

Si duket, forcat fashiste kishin marrë vesh që batalioni «Asim Zeneli» ish larguar dhe se Cepua mbrohej nga forca të pakta, prandaj me forca të mëdha ata ndërmorën një sulm kundër saj. Më 9 gusht italianët sulmuan nga tre drejtime: nga Mashkullora, nga Cepua, nga Palokastra.

Në këtë mënyrë Cepua dhe forcat e pakta partizane ishin të rrrethuara në mes tre zjarresh. Çeta ish e detyruar të zinte vendet në një sektor mjaft të gjerë. Fashistët po u afroheshin pozicioneve tona. Urdhëri ish që të hapej zjarr kur të afroheshin sa më pranë.

Lufta filloi e ashpër. Partizanët kundërsulmu-an dhe i detyruan italianët të tërhiqeshin. Ata u çorientuan sidomos nga kryqëzimi i zjarrit të katër mitrolczave tanë. Italianët hodhën forca të reja. Tre sulme të tyre me radhë arritëm t'i thyenim. Po kundërshtarët tanë kishin epërsi të madhe forcash dhe armatimesh. Përpjesëtimi ishte 1 partizan kundër 7-8 italianëve. Armiku i qëllonte pozicionet

tona me mortaja të lehta dhe të rënda. Po partizanët qëndronin të patundur në pozicionet e tyre.

Po shkonte ora 12 dhe lufta vazhdonte. Partizanëve po u mbarcheshin fishekët. Dhe në raste të tilla, si gjithmonë, ne i drejtoheshim popullit. Ai ishte mbështetja jonë, burimi i forcave tona. Në fshatrat e Humelicës, Plesatit dhe Mashkullores u dha shenja e kushtimit partizan që ishte pesë pushkë dhe një bombë. Menjëherë nga këto fshatra na erdhën në ndihmë burra të arniatosur, të udhëhequr prej Xha Veipit nga Mashkullora, Feta Burbë nga Plesati dhe Neshat Çarçanit nga Fusha e bardhë e Vasil Rapit nga Humelica.

Ahere ne u hodhëm në kundërsulm dhe italia-nët i zuri paniku. I ndoqëm gjer në Fushën e Valaresë. Një pjesë të forcave italiane shoku Fejzo Dalipi i shpuri gjer në Virua, afër Gjirokastrës, duke i shpartalluar krejtësisht. Gjatë kësaj përpjekje zumë robër një nëntoger italian, dy nënöficerë, tre ushtarë, si dhe një sasi e mirë municioni ushtarak si pushkë, fishekë, bomba, mitroloza, mortaja të lehta, etj.

### Përpjekja e parë me gjermanët

Me 10 shtator të vitit 1943 Italia fashiste ngriti duartë. Kur u përhap lajmi i gjunjëzimit të njerës prej fuqive më kryesore të aleancës fashiste, batalioni ynë ndodhej në Kurvelesh. Ishte mbrëmje. Lajmi shkakëtoi një gëzim të madh midis partizanëve dhe popullit. Filluan të qëllonim me pushkë për hare. Populli doli nëpër rrugë, njerëzit përqafoheshin me njeri tjetrin. Në këtë disfatë të maqinës fashiste, populli ynë kish dhënë kontributin e

vet. Ne partizanët e ndjenim veten krenarë për lavdinë e armëve tonë, për lavdinë e Partisë sonë që na udhëhiqte. Dikur tradhtarët na kishin frikë-suuar se ishte një marrëzi të ngriheshim kundër një kolosi, siç paraqitej në atë kohë Italia fashiste. Dhe ja kolosi përmbysej i bërë shkrumb e hi. Po ne e dinim se përpara kishim një tjetër «kolos», Gjermaninë hitleriane, edhe më të egër, edhe më barbare. Po edhe atë e priste i njëjtë fund i palavdihëm.

Po atë mbrëmje batalioni mori urdhërin nga Komiteti Qarkor që të kthehej sa më shpejt në Cepo, për t'i zënë pritë ushtrisë italiane që mund të largohej nga garnizoni i Gërhotit.

Udhëtuam për gjithë natën. Megjithëse afati ishte i shkurtër, rruga e vështirë, batalioni arriti në kohën e caktuar, dhe u zuri pritë autokolonave te Ura e Kardhiqit, pasi mendonim se garnizoni mund të largohej në drejtim të Vlorës. Kishim marrë me vete dhe dy robër italianë, dhe një oficer dhe një nënoficer. Batalioni u vendos në disa prita. Në kohën që do të vinte autokolona, përpara saj do të dilnin dy robërit italianë dhe, në rast se ajo nuk do të ndalej, do të hapej menjëherë zjarr. Por, ndërsa ne prisnim autokolonën italiane, ajo na doli autokolonë gjermane. Lufta filloi shumë e ashpër prej orës gjashtë të mëngjesit gjer në orën 11 të ditës. Gjermanët ishin të shumtë në numër dhe të armatosur gjer në dhembë. Ata arriten që të na i merrnin disa pozicione në buzë të xhadesë. Aty na mbetën të rrethuar dy nga shokët tonë: Duk Duka dhe Nevruz Shefua. Solidariteti partizan ka qenë i pashembëllt. Dhe nga kjo anë ka qindra shembuj heroizmi, kur shoku për shokun ka rrezikuar jetën.

Ne kundërsulmuam disa herë për të shpëtuar jetën e dy shokëve tonë që luftonin trimërisht të rrethuar nga të gjitha anët. Partizanët trima Halil Imeri e Sejdi Xhafua, etj, duke u vërsulur kundër ushtarëve gjermanë me bomba dore, arritën që t'i nxirrin të dy shokët nga rrëthimi. Po lufta vazhdonte të ashpërsonej me sulme dhe kundërsulme nga të dy anët. Gjermanëve u erdhën forca të reja. Trimakina me ushtarë erdhën nga Tepelena, dhe gjermanët zunë pozicione në anë të Urës së Kardhiqit. Batalioni ynë u vu në mes të dy zjarreve. Vetë komisari, shoku Shefqet Peci, me guxim dhe trimëri, duke shkuar nëpër bresherinë e plumbave dhe të bombave nga një pozicion në tjetrin, drejtonte luftimet. Po duhej të paralizohej pa tjetër zjarri i ri që na vinte që përtej Urës së Kardhiqit. Me zevendës-komandantin e kompanisë «Avni Rustemi», trimin Halil Imeri, dhe partizanët sypatrembur Dervish Myftarin dhe Seflo Pogaçen, u dolën gjermanëve papritur përrpara dhe zumë 32 robër. Disatë tjerë mundën të na shpëtonin. Ahere filloi çthura e gjermanëve. Me Halilin ne kapëm dhe një motçikletë dhe një xhips.

Gjermanët u detyruan të largoheshin me humbje të mëdha, kurse ne na u plagos vetëm trimi Sadik Buzo.

Ky ish pagëzimi i parë i batalionit tonë me pushtonjësit e rinj, gjermanët. Dhe ky pagëzim provoi se as gjermanët, sado trima që të ishin, nuk mund të luftonin me atë heroizëm dhe vetëmohimin e partizanëve që mbronin një çështje të shenjtë, nderin, lavdinë dhe lirinë e atdheut tonë.

Më kujtohet se ndër armët e shumta që kishim zënë, unë zgjodha një pushkë automatike, ndërsa

Halili një gjysmë automatike dhe n'ato çaste na dukej vetja sikur do të kishim mundësi të vrisnim trefish me tepër gjermanë. Por u dha urdhëri që të dorëzoheshin gjithë armët e kapura, dhe ne u dësh-përuam shumë. Në fillim kundërshtuam, po urdhëri partizan ish ligj i prerë. Më vonë, na i kthyen përsëri këto armë. Dhe ne përsëri u gëzuam si fëmijë. Kjo ish e natyrëshme. Pushka ish shoku ynë besnik. Po, siç e provuam dhe më vonë, pushka loste një farë roli, po rolin vendimtar në asgjesimin e armiqve e loste zemra e partizanit, vendosmëria, guximi trimëria, çështja për të cilën luftonim. Kështu ne që ishim të armatosur shumë keq u kapnim armët më moderne armiqve.

Po gjermanët nuk na e falën disfatën që u shkaktuam në përpjekjen e parë. Ata kërkonin pa tjetër të vinin në vend «prestigjin». Andaj këtë herë erdhën dhe na sulmuam me forca edhe më të mëdha. U hap një front i gjérë lufte, duke filluar që nga Mashkullora te Ura e Leklit, në Hormovë, Shtepëz dhe gjer në Cepo. Për të ndihmuar batalionin tonë erdhën dhe batalionet teritoriale të Kurvelleshit, Tepelenës, Kardhiqit dhe Lunxherisë, të cilat grumbullohen në menjëherë kur forcat e përherëshme partizane binin në përpjekje të rëndësishme me pushtonjësit, ose kur kërkohej ndihma e tyre përkryerjen e ndonjë aksioni. Lufta vazhdoi për tri ditë rrjesht pa ndërprerje. Ditën e parë u hodhën në sulme gjermanët që kishin ardhur nga Vlora dhe Gjirokastra. Forcat këmbësore i shoqëronte zjarri i dendur i artilerisë, që godiste pa reshtur pozicionet tona. Në 50-60 metra vend binin 10-15 predha. Ne nuk na kish takuar kurrë gjer ahtere të ishim nën një breshër aq të dendur goditjesh. Megjithëse partiza-

nët trima, nuk lëviznin nga pozicionet, ata pothuaj se i mbulonte dheu dhe gurët që shpërndaheshin nga plasjet e predhave.

Në ato çaste kritike, shoku Shefqet Peçi urdhëroi që batalioni të hidhej në sulm, pikërisht kur fillonte zjarri i dendur i artilerisë. Në këtë mënyrë do të ndalonim sulmin e këmbësorëve gjermanë dhe do t'u shpëtonim goditjeve të artilerisë.

Komisari i batalionit, shoku Shefqet Peçi jo vetëm që sulmonte në vijën e parë të zjarrit, po shkonte nga një sektor në tjetrin për të udhëzuar partizanët, të cilët nuk kishin përvojë të një lufte frontale, siç ishte ajo.

Natën luftimet pushonin dhe të dy palët qëndronin në pozicionet që kishim. Një pjesë e partizanëve qëndronin në pozicione për të kontrolluar lëvizjet e armikut, një pjesë tërhiqnin të plagosurit; merrnin masat përfurnizim me municion dhe ushqime, çvendosnin armatimet në vende më të përshtatëshme. Çdo partizani i takonte të bënte dy orë gjumë. Vetëm komisari nuk flinte. Ai, duke shkuar nga një sektor në tjetrin, interesohet për armatin, për ushqimet, për pozicionet, parashikonte se nga çfarë pike mund të sulmonte armiku të nesërmen, dhe merrete masat e nevojëshme.

Të nesërmen gjermanët filluan të rrahin përsëri me topa dhe mortaja jo vetëm pozicionet tonë, po edhe bazën tonë të Cepos. Aq i dendur që zjarri, sa thuajse pylli me gështenja u pre si me sharrë nga breshëria e predhave. Ndaj mesdite gjermanët morën Humelicën, që mbrohej nga forcat teritoriale. Komisari i batalionit, shoku Shefqet Peçi, shkoi vetë në atë sektor. Qëllimi i gjermanëve ish që të na merrnin krahët në drejtim të Humelicës



Shoku Shefqet Pegi.

e Mashkullorës. Dy herë Humelica kaloi në duart tona me anë të disa kundërsulmeve. Po aty u përqëndruan forca të mëdha dhe s'ishte e mundur që të mbahej më. Në Mashkullorë luftonin me një trimëri të pashoqe dy kompani tonat. S'dalloje trimin nga trimi. Nga të dy anët bëheshin sulme dhe kundërsulme të pandërprera. Rreth orës tre pasdite gjermanët na pushtuan Bregoren e Shehe. Kjo ishte një pikë e rëndësishme dhe humbja e saj i viinte në pozitë të vështira forcat tona. Urdhëri i komisarit të batalionit ish që të rimerrej me çdo kusht. Komandanti i kompanisë, Sadik Buzo, që luftonte në atë sektor, zgjodhi për të sulmuar bregoren: Halil Imerin, Dalip Haxhinë, Çune Mehillin, Medi Memën, Feim Sadikun, Gaqo Lulën. Shkova edhe unë bashkë me partizanin italian Luigj Mario, që dinte ta përdorte aq mirë mitrolozin e rëndë dhe që dallohej për guxim e trimëri. Pra, gjithësejt ishim 8 veta, kurse bregorja mbrohej nga 100 gjermanë. Shokë të tjerë nuk kishim, pasi ata ishin përhapur gjatë vijës së luftimit. Koha nuk priste. Gjermanët ndodheshin jo më tepër se 10 metra larg nesh brenda disa llogoreve të vjetra. Në fillim ne i qëlluam me bomba. Kur na u mbaruan bombat, Feimi u ngrit në këmbë dhe qëllonte me mitrolozin. Po aty filloi t'i bjerë gjak nga mjekra dhe nga nofulla e majtë. Dëgjova të më thoshte:

— U plagosa, shoku komisar, po merr mitrolozin!

Feimi njerën dorë e kish hedhur mbi supin tim dhe me tjetrën mbante mitrolozin. E urdhërova të tërhiqej. Gjermanët që ishin të shumtë në numër kërkonin të na merrnin krahët për të na zënë të gjallë, po Marioja me mitrolozin e tij «Breda» i ko-

rri që të gjithë. Gjermanët e vrarë zevendësoheshin nga të tjerë. Topi ynë që nga Cepua qëllonte me shumë saktësi tre katër metra para nesh. Kishte çaste kur ne u përziem me gjermanët dhe ishte rrezik të vrisnim shoku shokun. Plumbat vinin nga të gjithë anët. Vetëm Sadik Buzos i shpuan kapotën mbi 20 plumba, po asnje nuk e kapi në trup. Pak më tej, në krahun tim, u plagos djaloshi 17-vjeçar, Medi Mema.

Kur shkoi të tërhiqte Medium e plagosur, Halil Imeri u ndodh aq afër me një gjerman, sa e kapi për rrÿpin e xhaketës dhe po e tërhiqte me forcë. Po Halili, me një veprim të rrufeshëm, e vau gjermanin. Lufta vazhdonte e ashpër. U plagosëm edhe unë, Gaqua, Feimi, Emini, Çunia. Po, siç duket, gjermanët kërkonin të na kapnin me dorë të gjallë dhe po na afroheshin nga të gjithë anët. Në atë çast jashtëzakonisht kritik, Dalip Haxhiu, me një mitroloz në krahë, arriti papritur, dhe hapi zjarr mbi gjermanët që na kërcënonin. Një pjesë i vau dhe të tjerët u ndalën menjëherë në pozicionet e tyre. Mitrolozi i Dalipit dhe i Marios qëllonin nga të gjitha drejtimet. Kjo krijoi mundësi që shokët të na tërhiqnin ne të plagosurit duke na marrë në krah.

Por para se të arrija në spital në Cepo pashë, pranë një qiparizi, pieqtë patriotë Ahmet Dacin dhe Iljaz Mehmetin, pjesëmarrës të çetës së Çerçis Topullit, në luftën kundër grekëve më 1914 dhe në luftën e Vlorës kundër italianëve më 1920, që po ndiqnin zhvillimin e luftimeve.

Qëndrova me gjithë Dalipin që më shoqëronte.

— Ku je plagosur? — më pyetën.

— C'rëndësi ka, — u përgjegja unë. — Vësh-

troni si luftojnë partizanët, me ç'trimëri të pashoqe!

Në Bregoren e Shehe kishin shkuar shokë të tjerë dhe atje sulmet vazhdonin me ashpërsi. Ishin të gjithë djem 16-17 vjeçarë, shokë të Mediat, që 20 minuta më përpara ish vrarë.

— Ju lumtë djema! — thanë pleqtë. — E paçi hallall qumështin e nënave. Ju i kaluat edhe trimëritë tonë!

Në atë kohë dy aeroplanë gjermanë po mitralonin pozicionet tonë.

Tilmani, një major i misionit englez aleat, që bashkë me përkthyesin rrinin aty pranë, po ndiqte luftimet me dylbi.

— Pse nuk na vijnë në ndihmë aeroplanët tuaj?  
— e pyeta majorin.

Nuk di pse më lindi një ndjenjë neverie në ato çaste për atë njeri, që rrinte si një spektator i ftohtë përpara atyre luftimeve të furishme. Ai s'bënte gjë tjetër, veçse, nga që i lodheshin sytë, hiqte dhe vinte dylbitë vazhdimisht.

Pas tri ditësh luftimesh të ashpra me gjermanët, batalioni «Asim Zeneli» u kthye përsëri në Cepo.

Ato dy përpjekje me gjermanët patën një rëndësi të madhe. Ato e hodhën poshtë legjendën se gjoja qenkishin të pathyeshëm ushtarët e Hitlerit.

Partizanët u përlleshën grykë për grykë me 'ta, të bindur se edhe për ushtrinë hitleriane do të vinte pa tjetër një 10 shtator. —

## Ballistët për plaçkë lënë koskat e tyre

Italia fashiste u gjunjëzua. Sipas udhëzimeve të Shtabit të Përgjithëshëm, që na u komunikua prej Shtabit të Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastër, forcat partizane duhej të çarmatosnin ushtritë italiane, t'u bënин thirrje ushtarëve që të hidheshin në radhët partizane. Po të kishte qëndresë dhe forcat italiane s'do të pranonin të dorëzoheshin, atëherë duheshin asgjësuar. Divizioni Peruxhia ishte i përqëndruar në kazermat e Gérhotit.

Batalioni «Asim Zeneli», i mbështetur edhe nga batalionet teritoriale të Kurveleshit, Kardhiqit, Lunxherisë e Gjirokastrës, në 15 shtator, me urdhër të Shtabit të Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër, bëri rrëthimin e plotë të garnizonit. Sido-mos forca më të shumta u vendosën nga ana e Viroit dhe nga ana e Fushës së Dropullit, ku kahonte xhadeja. Forcat partizane arritën gjer më 1500 veta, ndërsa në garnizonin italian të Gérhotit forcat ishin më tepër se dhjetëfishi ynë. Mirëpo tani që «kalit i ranë thonjtë» «vraponte Balli t'i hiqte patkonjtë».

Balli kombëtar, kur e pa se padronuit «i ranë thonjtë», u hoq se edhe ai na paskej qenë kundër Italisë fashiste, dhe se, si përfaqësonjës i vërtetë i kombit, duhej pikërisht atij t'i dorëzohej garnizoni i Gérhotit. Me marrëveshjen Dalmaco-Këlcyra, me qëndrimin e tij gjatë gjithë kohës së pushtimit fashist italian, për cilindo ish e qartë se Balli kombëtar ishte krijuar pikërisht prej pushtonjësit fashist për të paralizuar luftën e popullit shqiptar; ai jo vetëm nuk kish hedhur asnje pushkë kundër

italianëve, po i kish ndihmuar dhe vepron te sipas udhezimeve te tyre. Ish e qartë pra, se Ballistët kërkonin te përfitonin nga rasti, te bëheshin edhe ata pjesëtarë te luftës sonë, për te ngritur sadopak autoritetin e organizatës se tyre te diskredituar në sy te popullit.

Për këte qëllim forca te shumta balliste kishin arritur gjer në portat e Gërhosit. Mirëpo, si bashibuzukë që qenë, ballistët u grindën me njëri tjetrin se në ç'mënyrë do te ndanin plaçkat që do te kapnin dhe një pjesë e forcave, si përfundim i këtyre grindejeve, po largohej nga Gërhoti në drejtëm të Urës se Kardhiqit.

Në xhade kishte lëvizje. Vetura me ballistë venin dhe vinin duke kaluar përmes italianëve. Komandantë te shtabit te Ballit mundoheshin tu mbushnin mendjen forcave që ishin larguar, si përfundim i grindejeve, që te kthehet ktheshin përsëri në Gërhot.

Këto lëvizje te shumta te vetravet ne na vunë në dyshim dhe unë se bashku me Dalip Haxhiun, zbrita te Ura e Viroit dhe vetravet e parë që po kthehet në drejtëm te Gjirokastërës e ndalëm menjëherë.

Një ushtar, me gradën e majorit, më foli me plot fodullëk: — si guxon te ndalni vetravet e shtabit te Ballit kombëtar? Largoju nga rruga! Nise! — e urdhëroi menjëherë shoferin.

— Ne kemi te drejtë te ndalim cilindo, se jemi përfaqësonjës te popullit dhe jo Ballin e tradhëtarëve.

Kur e pa se nuk ish aq lehtë ta niste vetravet, majori zbriti dhe, duke venë njëren dorë mbi revolver, me një pozë prej kapadaiu tha:

— Ku e kini marrë këte te drejtë ju partiza-

nët komunistë që të ndalni makinat e «qarkorit të Ballit kombëtar»?

— Gjersa këto vetura dalin nga komanda fashiste, ne kemi plotësisht të drejtë t'i ndalim, dhe ju t'ju arrestojmë menjëherë si major i fashizmit.

Shoku im e njihte majorin. Ai na qënkej Bilbil Haini.

— Mos bërtit, Bilbil, ule zerin! — i tha Dalipi, se juva pamë hynerin, me fashizmin ishit dhe me fashizmin jini!

Në atë kohë hapi derën e veturës dhe doli njëri nga ata të tre që ishin ulur prapa. Unë e njoħha menjëherë. Ishte Ismail Golemi.

— Prisni, more djem, — foli mengadalë, — ju po vriteni me njëri tjetrin. Edhe ky është kurvelleshas si dhe ju. Kjo është vetura e shtabit të Ballit, — shpjegoi ai.

— C'janë gjithë këto lëvizje? — e pyeta unë.

— Duam të kthejmë një pjesë të forcave që na ikën nga Gérhoti. Kemi shkuar disa herë, po nuk u mbushet mëndja disa brashnjakhive. Nganjëherë kini të drejtë ju partizanët që na shani si «brashnjamëdhenj». Po nuk janë të gjithë ashtu. Ne, si përfaqësonjës të kombit, do na dorëzohet garnizoni i Gérhotit.

— Ju jini përfaqësonjës të tradhëtarëve. Keni bashkëpunuar me fashizmin — iu përgjegjëm.

— Jo, more djalë, nuk është ashtu, ju jeni djem të rinx dhe i merrni punët rrëmbyer, — tha Ismaili gjithnjë me një ton të butë, sikur donte të shprehte, me atë ton, atë urtësi që kërkonte t'i vishtë organizatës së tij tradhëtarë.

Dikush nga makina i foli Ismailit të hyntë brënda, se koha nuk priste.

Ne kërkua që të kontrollonim pa tjetër se

kush ishte brënda, përpara se t'i lejonim të largoheshin. Në veturë ishin ulur prapa Hysni Lepenica dhe nënkolonel Neshat Kolonja, që përbënин shtabin e Ballit.

Tani majori, që në fillim na u drejtua duke hedhur njérën dorë mbi revolver, nuk fliste më, po priste se kur do t'i lejonim të largoheshin. Bashibozukët e Ballit, pas përpjekjeve të mëdha të komandantëve të tyre, më në fund u kthyhen përsëri.

— Pse iktë kaq në rrëmujë nga fronti, o ushtria e djallit, — u thamë:

Një plak, që, siç duket, ish mërzitur, na u përgjegj:

— Jo ushtria e djallit, po e birit të djallit.

Kur shkuam në pozicione, nga Gerhoti u kthye oficeri rob italian, i cili ish dërguar për të njoftuar komandantin e divizionit Peruxhia, gjeneralin Kiminello, në pranonte për të biseduar që të na dorëzonte pa ndonjë gjakderdhje krejt armatimet e garnizonit. Njerëzit që do të shkonin në atë takim ishin caktuar që më përparë. Midis të tjerëve bënин pjesë Shefqet Peçi, Kadri Baboçi dhe unë.

Në fillim unë mendoja se takimi do të bëhej në pozicionet tona, mirëpo gjenerali na priste në Gérhot. Bashkë me gjeneralin Kiminello ishin dhe dy oficerë të tjerë madhorë. Te dera bënин roje oficerë italiane.

Gjenerali pranonte të na i dorëzonte ne të gjitha armatimet, po për këtë kërkonte kushte përsigurimin e ushtarëve, gjersa të kalonin në Sarandë, nga do t'i merrnin anijet për në Itali.

Sipas gjeneralit, ne duhej t'i merrnim armatimet pjesë pjesë, gjer në arritjen e ushtrisë italiane

në Sarandë, kurse ne ngulnim këmbë që ushtria të çarmatosej krejt dhe forcat partizane t'i garantonin në kalimin e tyre gjer në Sarandë. Në atë kohë ra telefoni.

Gjeneralit i telefonuan se forcat balliste kishin kapur rojet, i kishin çarmatosur me forcë dhe kërkonin dorëzimin e tyre. Gjenerali, i inatosur aty për aty, urdhëroi që kundër forcave të Ballit, që gjer atëhere hynin e dilnin lirisht në Gerhot, të hapoj zjarr. Gjenerali italian na deklaroi se «po të dorëzohem, do t'u dorëzohem vetëm partizanëve, që kanë qënë kundërshtarët tanë të vërtetë dhe që përfaqësojnë popullin shqipëtar, ndërsa Balli Kombëtar ka qenë aleati dhe bashkëpunëtori ynë».

Si përfundim, gjenerali tha: — Forcat italiane do t'u dorëzohen partizanëve, po tani për tani duhen larë hesapet me ata që i kemi ushqyer vetë dhe tani kërkojnë të hiqen sikur janë kundërshtarët tanë.

Gjatë këtij incidenti u vranë 70 ballistë, veç të plagosurve. Në mes të tyre, edhe Hysni Lepenica e Hasan Xhaferi. Ngjarja kish ndodhur kështu:

Kur komanda e Ballit pa se po shkonin të dërguarit e partizanëve për të marrë në dorëzim garnizonin, për të mos u shpëtuar zogu nga dora, vendosi të vepronin sa më shpejt. Në të vërtetë ish se forcat e Ballit futeshin edhe më përpëra lirisht në Gerhot. Dhe duke përfituar nga kjo, i thanë postës italiane që të gjitha armatimet do t'i merrnin ata në dorëzim dhe filluan që t'i çarmatosnin rojet.

Këtë incident ballistët do ta paraqesin sikur ata i kishin pasur kundërshtarë fashistët italiane. Mirëpo, me të ardhur Gjermania hitleriane, në qoftë se gjatë pushtimit italian ishin përpjekur me lloj lloj manevrash për ta ruajtur në një farë lloj më-

nyre maskën e «patriotëve», pastaj e hoqën krejt dhe u rrjeshtuan krah për krah forcave gjermane. Asgjë s'kish ndryshuar për ta, kish ardhur një padron i ri, ndërsa shërbëtorët ishin të vjetër.

### Balli dhe porta e Kalasë

Ndërkohë batalioni «Misto Mame» dhe batalioni «Asim Zeneli» çliruan qytetin e Gjirokastritës dhe qëndruan aty për tetë ditë. Populli i priti partizanët me gëzim e brohoritje.

Siq ndodhët në çdo zonë, qytet, fshat që çlironin, forcat partizane edhe këtu vunë në veprim menjëherë organet e pushtetit popullor të ardhëshëm.

Po në Gjirokastër këshillat ishin ngritur që me kohë, po tanë ushtronin funksionet e tyre lirisht. Kompania «Avni Rustemi», ku unë isha komisar, qëndroi gjatë atyre ditëve për të mbajtur irregullin. Në ato pak ditë populli na ndihmoi për të kapur njerëz të shitur e spiunë, për të vendosur qetësinë në qytet.

Po në atë kohë, kur Italia fashiste kish hedhur armët dhe pritej që të vinte një pushtonjës i ri, gjermanët, ish dhënë urdhëri që të grumbullohen në armët, ushqimet, medikamentet dhe të shpërndaheshin nëpër bazat partizane. Në ato ditë gjirokastritët na ndihmuin, jo vetëm për t'i zbuluar depot, po edhe për t'i grumbulluar dhe për t'i nisur për në Kurvelesh, Cepo, Suhë, Zagori. Na erdhën në ndihmë edhe banorët e fshatrave për rrëth, duke marrë me vete edhe kafshë për mbartje. Ne fishekët, bombat, pushkët, mortajat e topat gjithmonë ua kishim marrë armiqve. Dhe ja tanë, që

makina fashiste italiane ish, bërë copë e çikë, po-pulli i Gjirokastrës dhe i fshatrave përreth u tregua i gatshëm, duke punuar pa pushim, ditën dhe natën që depot e armatimeve të zbrazeshin sa më shpejt. Për këtë punë vinin aktivistë nga çdo lagje, të rinj, të reja, burra e gra, bile edhe me moshë të thyer.

Vetëm forcat e Ballit kombëtar ishin mbyllur në Kalanë e Gjirokastrës, si zogu në kuvli. Siç thoshin me ironi nëpër qytet, si duket, «ballistët ishin në zi se Italia u la shëndetin». Te porta e kalasë ishin vendosur grykat e mitrolozave; rojet e ruanin ditën dhe natën.

— Porta e kalasë mund të hapet vetëm me urdhër të shtabit të Ballit, përndryshe derdhet gjak!  
— thoshte një farë Medar Pula, që rrinte roje te porta.

— Ju ua hapët portat pushtonjësve italianë dhe do t'ua hapni dhe pushtonjësve gjermanë, që do të vijnë; kurse ne, që jemi shqiptarë të vërtetë, kërkoni të na i mbyllni? Po ne do ta hapim me forcë, — i tha një partizan.

Në zyrën, ku qëndronte shtabi i Ballit kombëtar, shkuan shokët Shefqet Peçi, Avdul Hakiu dhe unë për t'u dhënë ultimatum që të hapnin menjëherë portën e kalasë.

Zyra e shtabit të Ballit ish një dhomë e mobiluar bukur. Aty gjetëm Koço Mukën, Bahri Oma-rin, Neshat Kolonjën, që mbante gradën e nën-kolonelit dhe dy oficerë. Biseda ishte tepër e shkurtër dhe e prerë. Ata na thanë se derën e kalasë nuk mund ta hapnin pasi aty ishin dislokuar forcat e armatosura të Ballit kombëtar të qarkut të Gjirokastrës, armatimet, dhe sendet e tjera të ne-vojëshme. Shoku Shefqet Peçi, duke iu përgjegjur,

u tha: — Kalaja éshtë e popullit dhe jo juaja. Aty do të strehohen gjithë familjet për t'u mbrojtur gjatë luftës me gjermanët. Urdhërojmë të hapet porta e kalasë menjëherë, pérndryshe Shtabi i Ballit nuk do t'i ketë punët mirë!

Kur e panë punën keq, ata filluan të zbuten, të na këshillonin që të mos ta merrnim punën aq me gjaknxehtësi, po të prisnim sa të nxirrin urdhërin... Po nuk pranuam të prisnim për asnjë arësy. E detyruam shtabin e organizatës tradhëtare që të vinte menjëherë bashkë me ne dhe të urdhëronte rojet të hapnin portat e kalasë. Sheshi i kalasë u mbush plot me popull dhe partizanë. Aty në një mënyrë krejt të vetvetishme u organizua një miting. Përfaqësonjësi i Komitetit Qarkor, duke folur, demaskoi Ballin kombëtar si bashkëpunëtor me fashistët italianë. Ai gjer një ditë më parë në bashkëpunim me ta, burgosi, persekutoi dhe vrau patriotët, bijtë e vërtetë të popullit.

Koço Muka, që u përpoq të mbronte Ballin, u prit me të qeshura.

— Ku ishe gjer dje ti patriot i kulluar?

— Si ju dhimbset populli i Çamërisë dhe i Kosovës, kur ju, në bashkëpunim me fashistët italianë, s'latë poshtërsi pa bërë në Shqipëri? Nuk na hidhni dot hi syve!

Në këtë mënyrë i përgjigjej fjalimit demagogjik të Koço Mukës vetë populli.

Përfaqësonjësit e Ballit, kur u vunë përrpara me të qeshura, u ankuau se ata do të organizonin një mbledhje tjetër, ku do të fliste Ali Bej Këlcyrë, njeriu i tyre me autoritet të madh. Ata ankoreshin se po u binin kot më qafë, se qënkeshin gati të luftonin për Shqipërinë.

Ata mbanin pozën e Krishtit të kryqëzuar. Po ne u përgjegjëm se fundi i tyre do të ishte edhe më i vajtueshëm dhe se ne ishim gati të ballafaqoheshim përpara popullit, i cili e njihte fare mirë edhe beun tradhëtar të Këlcyrés...

— Një lloj është, — tha një zë i fortë, — ju thoni këtu ç'kini për të thënë që tani se ne nuk kemi kohë të merremi me fjalë. Ju që i kini dhënë luftës fund që me kohë, nuk kini ç'bëni veçse të llomotisni.

Turma përsëri shpërtheu me të qeshura.

— Kush është ai djalosh i vogël, — tha plaku patriot Lipe Bogai, — që i thumboi aq bukur? Më duket se më ka ardhur në shtëpi? Mos është Haki Toska?

Kështu u larguan me bisht nëpër shalë autoritetet e Ballit gjithnjë duke shpresuar te oratoria e Ali bej Këlcyrés që do t'i fliste popullit të nesërmen.

### Shpresa e Ballit: Oratoria e Ali beut

Në orën 9 të ditës së nesërme sheshi i qytetit të Gjirokastrës që mban emrin «Çerçis Topulli», ish mbushur plot me popull dhe partizanë. Pas pak minutash arriti Ali bej Këlcyra, i shoqëruar nga një kolonë ballistësh, nën komandën e Neshat Kolonjës.

Ali beu, duke marrë fjalën tha: — Balli kombëtar ka ndjekur një politikë aq të urtë, sa që e shpëtoi popullin nga djegëjet dhe vdekja e sigurt. Ne bemë një politikë të madhe për shpëtimin e kombit kundrejt italianëve. Pikërisht tani ka ardhur koha pér të luftuar.

Këto fjalë u pritën me të qeshura, aq sa beu nuk mundi ta vazhdonte fjalimin. U deshiën shumë ndërhyrje për të vënë popullin në heshtje.

Ali beu, si për t'u çfajësuar përpara popullit, vazhdoi me këto fjalë:

— Ata të Lëvizjes nacional-çlirimtare më akuzojnë mua dhe kolegët e mi si tradhëtarë, si të shitur te fashizmi. — Ai filloj të numëronte emrat e disa udhëheqësve të Ballit, si të Mitat Frashërit, etj. — Kundër italianëve kam luftuar që më 1920. Nga plumbat e fashizmit kam mbetur sakat dhe, siç e shihni, e heq këmbën zvarë.

U dëgjua një zë i mprehtë nga turma:

— Ju jeni bërë sakat nëpër kabaretë e Francës, kurse luftën e ka bërë populli, o beu dallaveraxhi.

Ishte partizani Sotir Papuli. Kjo ndërhyrje shkaktoi përsëri të qeshura.

Beu tregoi disa «hynere» të Ballit, se forcat e tij të armatosura paskëshin çarmatosur ushtarë italianë dhe se kishin luftuar me ta në kohën e duhur, kur kapitulloi Italia.

Fjalimi i Ali bej Këlcyrés, mënyra si ai përpiquej të mbronte Ballin, tingëllonin me të vërtetë qesharake. Pikërisht ai që fliste tanë me «urrejtje» për Italinë fashiste, që hiqej sikur na paskësh luftuar kundër italianëve, në mars të vitit 1943 kish nënshkruar me gjeneralin Dalmaco një marrëveshje tradhëtie, pikërisht ai «patriot» hynte dhe dilte në qytetin e Gjirokastrës i shqëruar nga autoritetet fashiste. Ç'paradoks! Gjernjë ditë më parë Ali Bej Këlcyra me shokë jetonte nën mbrojtjen e bajonetave të Musolini, i bënte thirrje popullit të mos luftonte kundër Italisë se ishte një marrëzi e vërtetë, sulmonte

Partinë Komuniste si të shitur dhe se paskej për qëllim që të shkatërronte kombin me thirrjet e saja për luftë, kurse tani... beu kërkonte t'i mbush-te mëndjen popullit se ish ai dhe Balli kombëtar që paskeshin luftuar. Përsëri «ujku plak» kërkonte të notonte në ujëra të turbullta, të mashtronte pullin me demagogji. Tani ish e qartë: padroni i vjetër kish vdekur dhe po i pregetitej funerali. Tek ai s'mund të mbështeteshin më. Dhe i vdekuri jo vetëm që s'duhej të mbrohej, po duhej edhe sharë; duhej të hiqeshin edhe si armiq të tij, sa t'u vinte një padron i ri.

Duke iu përgjegjur në emër të Partisë, të Frontit Nacional-Çlirimtar përfaqësuesi i Qarkorit de-maskoi demagogjinë e Ali bej Këlcyrés dhe të organizatës tradhëtare të Ballit Kombëtar. Vetë vepri-taria e asaj organizate dhe e krerëve të saj, si Ali bej Këlcyra, në qarkun e Gjirokastrës tregonin qartë punën e tyre përçarëse, tradhëtare. Ata duhej të jepnin llogari për djegëjen e Kurveleshit, për vrasjet e plaçkitjet e kryera në bashkëpunim me fashistët, për tradhëti të lartë kundrejt at-dheut. Si mund të na mbushte mëndjen beu tradhëtar se ballistët kishin luftuar me italianët, kur ata kishin qënë shokë armësh? Si mund të bindeshim se beu e paskej urryer fashizmin kur ai vetë kish shtruar bankete me gjeneralët fashistë? Nuk do të ish keq të kujtonim një ngjarje. Në maj të vitit 1943 një njësit partizan ndali te ura e Kardhiqit një autobus. Aty ish dhe Ali beu. Njësiti e arrestoi beun dhe e mbajti për disa ditë në një qendër partizane. Kur u lirua nga forcat partizane, beun e priste një kolonel italian. Ai u puth me të buzë më buzë. Bile, forcat ushtarake të Italisë fashiste kërcënuan se po të vritej Ali

beu do të ndërmerreshin raprezalie të mëdha. Ky episod tregoi se çfarë patrioti ish Ali bez Këlcyra. Ne një gjë të tillë e dinim me kohë. Po pastaj e pa edhe i gjithë populli i krahinës sonë dhe u bind përse u shqetësuan aq shumë fashistët italjanë për jetën e beut «patriot».

Beu dhe organizata e tij tradhëtare, ish e kotë që, tanj kur Italia fashiste kishte dorëzuar armët, të paraqiteshin sikur gjoja dhe ata kishin luftuar, pra, dhe ata kishin qënë patriotë.

Populli filloj të bërtiste:

— Po, ashtu ka qënë: Ata gjer dje kanë shetitur nëpër rrugët e Gjirokastrës së bashku me pushtonjësit italianë.

— Ata na kanë vrarë dhe djegur.

Si rrjedhim i këtij demaskimi publik, që iu bë Ali beut, në radhët e ballistave ndodhi diçka e papritur. Ata filluan që të prishin rrjeshtat dhe disa bërtisnin:

— Ali beu na ka gënjer. Ne nuk do ti shkojmë më prapa.

Dhe pikërisht në atë çast filluan dezertimet me shumicë.

Një numër i madh i ballistëve shkuan nëpër shtëpira. Ndërsa një pjesë u hodhën në rrjeshtat partizane.

Kështu u shua dhe ajo shpresë që kishin krejtë e Ballit te «oratoria dhe autoriteti» i Ali beut.

Edhe në ato pak ditë që qëndruam në Gjirokastrën e çliruar radhët tona shtoheshin për ditë. Populli na shikonte si bijtë e tij të vërtetë që ishim, si çlirimtarët e tij. Ato nuk qenë ditë pushimi, po e kundërtë. Në ato tetë ditë, në bashkëpunim të ngushtë me popullin grumbulluam forca të reja, material luftarak, ushqime, për tu përgatitur për

një luftë edhe më të përgjakëshme me pushionjësit hitlerianë.

Tani përgjithë njerëzit e ndershëm ish bërë edhe më e qartë se e vetëmja parti që luftonte përgjëشتjen e vërtetë të popullit ishte Partia Komuniste, që kish grumbulluar rrëth Frontit Nacional-Çlirimtar gjithë ato forca që urrenin shtypjen, robërinë dhe shfrytëzimin. Organizata e Ballit kombëtar në qarkun e Gjirokastrës kish mbetur e damkosur me vulën e turpit dhe të tradhëtisë.

## Fundi i një Divizioni

Dhe pikërisht në një nga ato ditë e lamë Gjirokastren dhë u nisëm me disa partizanë për në Sarandë, ku italianët u detyruan që të na dorëzonin armët. Siç e kemi përshkruar më parë, garnizoni italian nuk pranoi të na i dorëzonte menjëherë të gjithë armatimet. Tani forcat italiane ishin grumbulluar në Sarandë dhe prisnin vaporët për të shkuar në Itali.

Kur arritëm në Qafë të Gjashtës në dëgjuam kriisma pushkësh. Si zbritëm pak më poshtë, takuam rojet partizane. Ata na thanë se forcat partizane të komanduara nga Jaho Gjoligu e Avdul Hakiu kishin hyrë brenda në qytet. Në të dy anët e rrugës ishin shpërndarë ushtarë italiane. Dikush kish shtruar batanien dhe ish shtrirë, dikush tjetër zjentë gjellë, dikush flinte. Armët i kishin lënë anës së rrugës të mbledhura togje togje. Qyteti gjithashtu ish imbuskur plot me ushtarë. Italianët fëvizin pa drejtiim, në një rrëmuje të plotë.

Ish me të vërtetë një tabullo e gjallë e një ushtari me krejt të gorganizuar. Ushtfarët ishin lëdhur nga

lufta dhe gjëja më e urryer për ta në ato çaste ishte pushka. Ata i kishin hedhur armët sheshit. As që donin t'ja dinin më për oficerët, veç prisnin me ankth për t'u nisur në atdheun e tyre, në Itali. Kishin humbur aq tepër besimin te vetja, sa që nuk ishin më të aftë as për të mbrojtur dhe jetën e tyre, po shikonin plot mëshirë.

Në qytet takuam xha Jahon, që po vinte me disa partizanë. Ai na tha se sapo kish mbaruar përpjekja me gjermanët. Ata kishin zbarkuar në port për të penguar forcat italiane që të largoheshin për në Itali. Në atë çast ne pamë motobarkën gjermane të lundronte shumë larg nga brigjet.

Xha Jahua kish luftuar kundër gjermanëve vetëm me një skuadër, dhe i kish detyruar që të tërhiqeshin në panik. Në mol ne pamë dhe tre gjermanë që kishin mbetur të vrarë. Italianët nuk kishin hedhur asnje pushkë. Ata i kish kapur tmeri me të dëgjuar që kishin zbarkuar gjermanët.

Kur e pyetëm xha Jahon se ku ishin partizanët e tjerë, ai na u përgjegj se i kish lënë nëpër depo, ku ngarkonin armë dhe ushqime dhe i nisnin për në bazat partizane.

— Kjo fara e drejt, — tha xha Jahua për italiane, — as që pyet më për armë, i kanë hedhur sheshit. Vetëm për depot me ushqime bënë ca fjalë.

Shkuam dhe u takuam me gjeneralin. Na shqëroi një kolonel. I deleguari i Komitetit Qarkor i tha Gjeneralit se armatimet duhej t'ua dorëzonë të gjitha forcave partizane. Gjenerali përsëri kundërshtoi. Ai tha se armët i duheshin për t'u mbrojtur nga çdo e papritur dhe se ai e kish përdetyrë të mbronte nderin dhe dinjitetin e ushtarit italian.

Ne e garantuam përsëri gjeneralin se forcat

partizane do të siguronin jetën e ushtarëve të çarmatosur. Debatet qenë shumë të ashpra. Xha Jahua, i inatosur, tha se do t'ja numëronte në kokë atij edepsëzi. I deleguari i Qarkorit i tha më në fund gjeneralit: «Po nuk dorëzuat armët, me të cilat kini luftuar kundër popullit shqiptar, ne do t'u detyrojmë t'i dorëzoni ato me forcën e armëve!»

Më në fund gjenerali pranoi që forcat tona të merrnin gjithë depot e armatimeve, vetëm t'u li-heshin ushtarëve pushkët. Po ne i çarmatosëm dhe ushtarët. Partizanët u dilnin përpëra kolonave me ushtarë italianë, i ndalnin dhe ato pa e zgjatur i hidhni pushkët vetë.

Kështu arritëm të merrnim në dorë pjesën më të madhe të armatimeve të divizionit italian Peruxhia.

Fati i ushtarëve italianë qe shumë i ashpër. Gjermanët kapën një pjesë të madhe të tyre dhe i pushkatuan. Ata nuk ishin në gjendje të hidhni asnjë pushkë. Vetë gjeneralin dhe shtabin e tij gjermanët i therën me thika.

Ky barbarizëm i hitlerianëve kundër një ushtrie që ishte dorëzuar, nuk ishte i jashtëzakonshëm. Ata ishin kriminelë të vërtetë, kriminelë të të gjithë popujve dhe për 'ta krimi ishte një punë profesionale.

### Në një përpjekje me xhepitët

Batalioni «Asim Zeneli» në 15-ditëshin e parë të tectorit, mori urdhërin për të shkuar në Ramicë të Vlorës, ku, së bashku me batalionin «Halim Xhelo», formoi Grupin e parë të Zonës së Parë operative Vlorë-Gjirokastër. Dhe siç ndodhë zakonisht, formacionet tona luftarake pagëzoheshin

në zjarrin e luftës me armikun. Po atë natë morëm urdhërin për të sulmuar forcat balliste që ndodheshin në Velçë, si dhe fraksionin e tradhëtarit Sadik Premte. Këto forca reaksionare plaçkitnim popullsinë vëndase, terorizonin fshatarët, pengonin Lëvizjen nacional-çlirimtare dhe bashkëpunonin me forcat gjermane. Ballistët dhe xhepistët brenëndë pak orëve u shpartalluan dhe u larguan për të rigrumbulluar forcat në drejtë të Gjormit.

Besniku (pseudonimi i shokut Hysni Kapo) na urdhërci që të kontrollonim gjithë shtëpitë e ballisteve, ku, sipas disa të dhënave, ata kishin grumbulluar mjaft medikamente. Këto nevojiteshin për partizanët e sëmurë dhe të plagosur. Medikamentet u gjetën. Ato mbroheshin nga disa ballistë të armatosur, po ne i detyruam ata të dorëzoheshin dhe i arrestuam menjëherë. Ata që kishin kryer krime në popull i pushkatuam.

Besniku, me të marrë vesh se disa ballistë ishin pushkatuar, na kritikoi për atë veprim të nxitiuar. Ai na tha se, duke vepruar me kaq shpejtësi, kishte mundësi që ne të kishim pushkatuar edhe njerëz të pafajshëm, të cilët, të gënjyer ose të frikësuar nga propaganda e Ballit, kishin qënë detyruar, për rrethana të ndryshme, të vinin në radhët e asaj organizate tradhëtare.

— Këta njerëz, — tha Besniku, — ne nuk duhet t'i përzicjmë me kriminelët e vërtetë, me njerëzit që kanë shitur ndërgjegjen dhe nderin e Shqipërisë. Ai kërkoi menjëherë dokumenta për të gjithë ata që ishin pushkatuar. Unë për herë të parë e shikoja Besnikun të fliste me aq nervozitet. Nënkuptohej se ai, megjithëse ish kohë lufte kur ngjarjet nuk të lejonin për të hetuar të gjitha çështjet me hollësi, prapseprapë kërkonte nga ne që drejtësia par-

tizane të ish e kulluar, që plumbi ynë të vriste vetëm armiqtë e vërtetë.

Ne, edhe pse në kushte të vështira lufte, ishim të porositur me rreptësi që të dinim të dallonim mirë njerëzit e thjeshtë nga armiqtë e betuar të atdheut. Dhe nga verifikimi i dytë që u bë, sipas kërkesës së Besnikut, doli se të gjithë të pushkaturat kishin qenë grabitës, vrasës, bashkëpunëtorë të pushtonjësve.

Më 5 nëndor 1943 ne i sulmuam forcat balliste dhe xhepistët në Gjorm. Armiqtë kishin pozicionë të sigurta dhe armatime të shumta. Atyre u kishin ardhur nga Vlora përforcime me ushtarë dhe municione. Një patrullë jona kapi dy shoferë që po vinin me kamiona nga Gjormi. Në bazë të informave të tyre nga Vlora kishin ardhur çeta e Azis Çamit, dhe një farë Namik Numani, një çifligar nga Gumenica.

Forcat tona i kishin zenë pozicionet në brigjet plot prralle të Gjormit. Ne sulmuam disa herë. Luftimet sa vinin e ashpëroheshin. Armiqtë thuajse në çdo pëllëmbë kishin vendosur një mitraloz.

Lufta kish dy ditë që vazhdonte e ashpër. Disa kundërsulme të armiqve u thyen. Megjithëse pozicionet tona ishin në goditjet e forta të zjarrit të armikut, partizanët trima nuk u tundën.

Natën e tretë u vendos që forcat tona të kallonin në sulm. Partizanët ishin grumbulluar në skuadra, dhe kishin marrë udhëzime secila në ç'drejtë do të msynte me t'u dhënë urdhëri i sulmit. Ishte një natë e errët, e ftohtë, me shi. Isha me Besnikun. Gjatë një pushimi të shkurtër herë njeri e herë tjetri filluan të bënim ndonjë shaka. Tani kjo mund të duket pak e çuditëshme

që edhe n'ato çaste kur mund të gjëmonte pa-pritur aty pranë një predhë topi, kur ndofta ndokush nga ne gjatë asaj përleshjeje mund të gjente edhe vdekjen. Gjenim kohë edhe për të qeshur për të bërë ndonjë shaka.

Po ja që kështu ndodhët, sado që të duket sot si pak e besuar. Lufta kundër armikut ish qëlli-mi ynë. Po ne provonim edhe gjëzimet dhe hidhërimet e jetës; në një pushim të shkurtër pas sulmit, provonim hidhërimin për shokun që na mbe-tej në fushën e betejës; dhëmbjen e plagës, nga-zëllimin e fitores. Njeriu, nga vetë natyra e tij, është i vritur kurdoherë, në çdo rrëthanë, për çdo gjë njerëzore.

Pastaj Besniku filloj të më flasë se si armiqëtë kërkonin ta minonin Partinë tonë nga brenda dhe ç'rrezik paraqiste fraksioni i Sadik Premtes. — Po historia ka treguar se tradhëtarë ka pasur kudo, — më thoshte Besniku, — andaj ne gjithmonë duhet të hapim sytë që ta ruajmë prej tyre Partinë.

Në ato çaste bashibuzukët e Sadik Premtes e të Ballit Kombëtar lëshuan disa bomba aty pranë.

Partizanët u hodhën menjëherë në sulm. Besniku u hodh në sulm i pari duke thirrur vazhdimeshit:

— Para, partizanë!

Ai shtinte më këmbë. Unë i fola që të ulej, po ai s'dëgjonte. Në një rast e kapa dhe e dety-rova që të shtinte shtrirë. Po ai u ngrit përsëri dhe, duke kapërcyer kaçubet me mare dhe prrall, sulmonte përpara më këmbë, duke thirur herë pas here:

— Para, partizanë!

Dikush nga bashibuzukët e njoju dhe i foli me emër, duke e sharë dhe hodhi një bombë që plasi diku në krah të tij.

Partizanët ishin hedhur të gjithë në sulm. Dëgjoheshin thirrje, krisma që të shurdhonin, duke shën flakët që dilnin nga grykat e pushkëve dhe mitralozëve.

Dëgjohej gjithashtu zëri i Tërmetit (pseudonimi i shokut Shefqet Peçi) që u jepte kurajë partizanëve. Në një përleshje Tërmeti mori një plagë nga një bombë. Besniku më tha që t'i shkoja, në ndihmë. Po dëgjoja vetëm zërin e Tërmetit që thërriste — Para, partizanë! Dhe asgjë më te për. Nata ishte pus e errët. Dhe unë shkova atje vetëm pas zërit të tij. Forcat tona me sulm arritën gjer në buzë të lumi Shushicë, po nuk mund të kalonin më tej, pasi zjarri i forcave armike ish i dendur dhe mund të kishim humbje.

Shtabi i grupit vendosi që t'u merrte krahët dhe për këtë u nis një skuadër në drejtim të Bratjt. Në krye të skuadriës ish militant i vjetër antifashist Abaz Shehu (sot hero i popullit) dhe Delo Balili, me një mitraloz grek në krahë. Në orën tre pasdite, u morrëm krahët dhe kur na dhanë parrullën u hodhëm me një herë në sulm. Të gjetur në befasi, të vënë midis dy zjarresh, xhepitët dhe bashibozukët e Ballit u shpartalluan krejtësisht. Ata ikën në panik krejt të çorientuar.

Kështu mbaroi kjo luftë e ashpër me fitoren tonë.

### Ish Dervishi partizan

Si u bë spastrimi i rrëthimit të fshatit nga forcat armike, unë u ktheva në Gjorm. Atje gjeta të arrestuar partizanin Dervish Myftarin.

Ai, sa më pa, i ndritën sytë nga gëzimi dhe m'u lut që të ndërhyja ta shpëtoja.

Kérkova të më shpjegonte si qëndroni puna. Ai më tha se gjatë asaj nate të ftohët kish marrë një batanie në një familje, që do t'ia kthente të nesërmen. Mirpo u diktua se një veprim të tillë e kish bërë pa urdhër, andaj u arrestua dhe do të ndëshkohej rëndë. Nuk mund të lejohej që një partizan të mirrte një batanie pa leje. Dervishi ish në rrezik të pushkatohej. Partizanët kishin shumë rregulla të rrepta. Ata kishin një disiplinë të çeliktë, të ndërgjegjëshme. Dhe kjo qe një nga kushtet që i bënte forcat tonë më të organizuara, më luftarake, më eprore se armiku. Edhe një veprim sado të vogël mosdisipline të kryeje, dënoheshe menjëherë nga opinioni partizan.

Dervish Myftari ish një burrë rrëth 50 vjeç. Nganjera këmbë ishte sakat. Ai nuk e thyente dot gjurin e këmbës së djathitë. Kur erdhi në çetë ish dervish. Ai mbante edhe mjekër. Po, me punën e organizatës së Partisë, ai e preu mjekrën dhe u bë ateist. Dervishi nga natyra ish pak grindavec, nuk është fort ta kritikoje. Kish ndodhur që kur e kritikonin në ndonjë mbledhje, të ish ngritur e të ikte. Po në anën tjetër, ai qe një luftëtar i guximshëm. Megjithëse sakat, ndodhej i pari ku të parqitej rreziku më i madh.

Mua më erdhi keq për partizanin plak dhe bisedova me komandantin e kompanisë, Sadik Buzon, dhe zevendës-komisarin, Velestin Zenelin, sësi mund ta arësyetonim gabimin e tij për ta shpëtuar nga pushkatimi.

Veledini më tha se ajo punë kishte marrë fund dhe ishte e kotë çdo përpjekje.

Pyeta se ku ishte Besniku. E gjeta majë një bregu së bashku me shokët Shefqet Peçin e Abaz Shehun. Ata bisedonin së çfarë drejtë duhej të

merrte Grupi dhe rrreth përpjekjeve të reja që duheshin bërë me armikun.

Unë gjeta rastin dhe ndërhyra. U thashë se ish arrestuar një partizan i kompanisë sime.

Besniku m'u përgjegj se e dinin një gjë të tillë dhe për këtë kish dhënë urdhër Shefqeti, i cili nga ana e tij foli shumë ashpër për Dervishin. Ai tha se veprime të tilla i kryenin vetëm ballistët dhe tregoi raste të tjera të mëparëshme mosdisiplinimi të tij. Mendimet e tija i mbështeti dhe Abazi. Pra duhej pushkatuar. Vetëm Besniku nuk fliste. Në fund e mora fjalën unë dhe tregova se si Dervish Myftari kish ardhur në çetë me mjekër dhe ish bërë një partizan trim i vendosur. Ai kur kishte ardhur puna për luftë kundër armiqve nuk e kishte kursyer as jetën. Ish e vërtetë se Dervishi kish treguar ndonjë akt mosdisipline, po gjithnjë shkonë duke u ndrequr. Dhe ja tani kishte bërë një gabim. Ne duhej që t'i jepnim mundësi që ai ta shlyente atë dhe premtova, si komisar i kompanisë, se e merrja përsipër punën edukative me të dhe shprehja besimin se do t'ja zhdukja disa të meta që kishte.

Pas një heshtjeje Besniku tha:

— Le të vendosim të marrim një masë tjeter, për gjersa Agua na premton edhe e merr përsipër vetë edukimin e tij.

Dhe kështu u bë. Dervishit iu hoq arrestimi menjëherë, shkoi e i çoi familjes batanien dhe i kërkoi falje.

Partizani Dervish Myftari u zotua se do të bënte gjithshka që ta shlyente përpara Partisë gabimin e tij. Dhe vërtet ashtu ndodhi. Pas kësaj ngjarje Dervishi u bë një trim edhe më i tërbuar

dhe vazhdoi me besnikëri në rrugën që i tregoi partia. Ai shkoi dhe luftoi gjer në Mal të Zi dhe u dallua për guxim, për trimëri, për heroizëm.

### Kur populli të ka në zemër

Si qëruam hesapet me xhepistët, Grupi u nis për në Tërbaç dhe që andej do të shkonte në Dukat. Ndërsa në fshatin e parë populli na priti si bijtë e tij. Në Dukat, ku reaksioni kish influençë të madhe, na kundërshtuan që të hynim në fshat, duke nxjerrë shkaqe të ndryshme. Ata e bënë këtë për të fituar kohë. Kur ne prisnim një përgjegje prej tyre, ata dërguan dhe lajmëruan gjermanët për arritjen tonë. Sikur ne të kishim marshuar menjëherë, ata pak ballistë nuk do të kishin marrë kurrë guximin të shtinin kundër Gru- pit.

Kur e pamë se nuk po na vinte asnjë përgjegje (kish ardhur pasdrekja), Grupi u vendos në njëshkolonë dhe marshoi për në fshat. Përpara ishin borizanët dhe pastaj pararoja. Unë isha urdhëruar aë me pararojën të qëndroja sa më afër borizanëve. Po futeshim në fshat. Borizanët u binnin borive me plot krenari.

Përpara u duk një plak me një fëmijë. Ai mbante një shkop. Plaku nga një herë ngrinte lart shkopin. Kjo na ra menjëherë në sv. Fëmija me këmbë të zbathura, afro 10 vjeç, filloi të vrapon te përpëra plakut. Dy partizanëve që takoi të parët u tha: «Jini të rrethuar nga gjermanët dhe ballistët!» Plaku ngrinte gjithnjë shkopin lart, shenjë që tregonë se ne duhej të ndaleshim. U takova me të. Ai më tha se në të dy përrenjtë që shtriheshin në të dy anët tona ishin gjermanët.

në dhe ballistë. Fjala shkoi gojë më gojë të partizanëve gjer te Komisari i grupit, që ish nga mesi i kolonës.

Ballistët dhe gjermanët filluan të qëllonin. Menjëherë u dha urdhëri që Grupi të shpërndahej në formacion luftimi.

Partizanët, megjithëse në një lëndinë, të pambrojtur, sulmuani me ashpërsi ballistët dhe gjermanët. Tërmeti që kryente funksionet e Komisarit dhe të Komandantit të Grupit, na urdhëroi që të kapnim menjëherë Qafën e Shëngjergjit, pasi ka-pja e saj prej gjermanëve rrezikonte gjithë Grupin të mbetej në një rrëthim pa rrugëdalje. Bashkë me zevendës-komandantin e kompanisë, Halil Imerin, Dalip Haxhinë, Sinan Xhemilin, arritëm në Qafën e Shëngjergjit. Sapo arritëm, shikojmë të vijnë në Qafë dy civilë me disa gjermanë. Ne mëzi merrnim frymë nga lodhja. Në Qafë u bë me ta një përpjekje e shkurtër. Vramë dy prej gjermanëve. Të tjerët ua mbathën këmbëve. Kështu arritëm të siguronim Qafën. Parashikimi i Tërmëtit kish qenë i drejtë.

Grupi, duke u ndodhur midis zjarreve, luftonte në tërheqje, gjersa doli në Qafën e Shëngjergjit, duke dalë në një mënyrë të shkëlqyér prej rrëthimit. Dhe manovrimi qe aq i përsosur, sa nuk pësuam as edhe një humbje. gjë që mund të bëhej vetëm kur kishe të bëje me njerëz trima, të vendosur, siç ishin partizanët, me kuadro të afta, të kalitura në fushat e luftës së përherëshme me armiqjtë, siç ishin kuadrot tona.

Nëpër një shi të madh u kthyem në fshatir Tërbaç. Aty na priten mirë, na strehuan, na dhanë pér të ngrënë. Fshatarët kishin dëgjuar luftimet dhe na pyetën se ç'na kish ndodhur. Unë u fola me

admirim për atë plakun me shkop dhe për fëmijën këmbëzbathur, që ishin një shembull i qartë se, sado punë të ndyrë që të kishin bërë tradhëtarët dhe reaksionarët e ndryshëm kundër nesh, njerëzit e thjeshtë, si ai plaku me fëmijën e mitur, të cilëve për fat të keq s'pata dot mundësi t'u mësoja emrat, na donin dhe na mbronin nga çdo rrrezik si njerëz të tyre që na kishin.

## Një letër nga Qarkori i Gjirokastrës

Po në atë kohë vjen një letër nga Qarkori i Gjirokastrës, me të cilën kërkohej ndihma e Grupit, pasi gjermanët, së bashku me ballistët, kishin filluar të masakronin popullin e qytetit të Gjirokastrës dhe të krahinës. Tërmjeti na bëri thirrje që, me gjithë lodhjen e kushtet e vështira që paraqiste të vajturit atje, t'i përgjigjeshim letrës së Qarkorit. Partizanët u ngritën që të gjithë njëherësh më këmbë dhe thanë se ishin gati të niseshin në cast. U nisëm nëpër shi, natën, të zënë dorë për dore, pasi ish rrrezik të rrëzoheshim se nata ish pus e errët. Aq e keqe ish nata, aq vështirë ish të udhëtoje, sa që ne të 4 orët që zgjat zakonisht udha Tërbaç-Kuç, i bëmë në 12 orë. Në mëngjes arritëm në fshatin Kuç, në drekë në Golem, darka na zuri në afërsi të Mashkullorës dhe, për gjithë natën, rrrethuam Gjirokastrën. Atje i shpartalluam ballistët dhe gjermanët dhe çliruam qytetin. Pastaj morëm urdhër për të shkuar në Dëshnicë kundër forcave të Ali Bej Këlcyrës, q'an-dej në Suhë, Polican, Sheper e Leshicë të Përmetit.

Ish muaji nëndor. Ne dolëm gjer në Qafë të Dhembelit, ku takuam dhe Grupin e Çamërisë, që udhëhiqej nga Mustafa Ma'tohiti.

Ky qe një itinerar i vështirë. Ndofta në kon-dita normale një udhëtim i tillë prej Gjormit në Tërbaç, në Dukat, Kuç, Golem, Mashkullorë, Gjiro-kastër, Dëshnicë, Suhë, Dhembel, do të dukej si i pamundur. Dhe këtu duhet pasur parasysh se partizanët ishin të veshur keq, të pangrënë, vendet ishin malore dhe, veç këtyre, ne nuk bënim një marshim të thjeshtë, po gati në çdo vend luftonim dhe fitonim kundër gjermanëve dhe bashibozukëve të Ballit. Vetëm shpirti partizan mund të bënte atë që ne sot na duket gati e pamundur.

Po më mirë le të tregoj edhe një episod të vogël që lidhet me këto ngjarje dhe që është mjaft-kuptimplotë.

Forcat e Grupit tonë po pushonin në Qafë të Dhembelit. Partizanët ishin shumë të lodhur, të rraskapitur nga pagjumësija, nga uria. Kishin djer-situr. Bënte ftohtë.

Me kompaninë tonë, që ish në fund të Grupit, qëndronte dhe oficeri i ndërlidhjes, majori anglez; Tilmani. Atë e shoqëronin dy veta, emërat e të cilëve nuk më kujtohen. Majori kishte me vete kaf-shë, ushqime. Ai deshi të qëndronte në Qafë të Dhembelit për të ngrënë dhe për të pushuar. Kësh-tu u detyruam që të qëndronim edhe ne që nuk kishim as ç'të hanim dhe as mund të pushonim dot, pasi të priste një erë e ftohtë.

Anglezi urdhëroi të shkarkonim thasët dhe tok-me shoqëronjësit u largua 40 metra nga kompania e filloj të hante. Kish shtruar përpara bukë gruri, biskota, çokollata, konserva, e të tjera.

Partizanët kishin disa ditë pa ngrënë. Ajo mos-përfillje, ajo qetësi me të cilën hante anglezi, ishte mjaft cinike. Sidomos nuk i rrihej më vend zeven-dës-komandantit të kompanisë, Halil Imerit.

— Si shpjegohet kjo, shoku komisar, që ai anglezi këtu përpara syve tonë të haje ç'ti dojë goja dhe ne të mbajmë barkun me dorë. Do vete të paktën t'i marr një cigar.

Dhe ai shkoi dhe e mori. Pastaj erdhi dhe mbështeti barkun pas një guri.

Të gjithë partizanëve qendrimi i oficerit anglez nuk u pëlqeu. Atyre u dukej se ai që paskej ardhur si përkrahës i Luftës antifashiste, tallej me sakrifitat e partizanëve.

Mua s'm'u durua dhe shkova tek englez, përt'i kërkuar të më jepte diçka për partizanët. I kërkova me anë të shoqëronjësve të tij të më jepte disa pako biskota t'ua ndaja partizanëve. Ata ja thanë këtë majorit po ai nuk pranoi. Ahere unë jo vetëm ndjeva për të neveri, po dhe u revoltova, aqë sa mora vetë tri pako biskota, dy kuti larde, 3 çokollata dhe dy copa sallam.

Anglezi më shikoi me inat, por nuk foli, ndërsa dy shoqëronjësit filluan të më qërtonin. Po unë u përgjegja: «Ju s'keni asnjë arësy që të hani kaq mirë, ndërsa të tjerët, që kanë tri ditë pa ngrënë, t'ju shikojnë ju». Megjithëse u binte nga një pjesë fare e vogël, unë ua ndava gjithë partizanëve. Anglezi vazhdonte të hante me një heshtje të ftohtë, cinike.

### Me batalionin «Asim Zeneli»

Në dhjetor të vitit 1943 Tërmeti u largua nga batalioni «Asim Zeneli». Ai u emërua komandant i brigadës së 5-të S, në vënd të Abas Shehut, që kishte rënë heroikisht në krye të detyrës në praktikë inaugurimit të Brigadës. Tërmeti e kish udhëhequr batalionin me trimëri dhe zgjuarësi. Sa herë

kishim rënë në situata të vështira! Sa herë kishim marshuar netë të tëra, të zveshur, të uritur, të lодhur, pa gjumë! Po Tërmeti, kurdoherë vetë i pari, jepte shëmbullin për gjithë partizanët. Ai ndodhej në atë pikë të luftimit ku ish rreziku më i madh. Marshonte vetë në krye të kolonës. Mua nuk do të më harrohen ato çaste të vështira, në të cilat ndodhej grupi ynë në Dukat. Ndodheshim të rrëthuar nga të gjitha anët, në lëndina të zveshura, nën zjarrin e kryqëzuar të ballistave dhe gjermanëve. Tërmeti, pa humbur kurajën asnje çast diti që ta drejtonte aq mirë Grupin sa doli nga rrëthimi pa asnje humbje, ashtu si në ato ditët e para të shtatorit në përpjekjen e parë me gjermanët, që shkonte nga një sektor luftimi në tjetrin, udhëzonte, çmonte në çast situatën, aty për aty vepronë, duke kaluar përmes plumbave dhe bombave të armikut.

Nën drejtimin e tij batalioni «Asim Zeneli» ish bërë tmer për armiqëtë ndërsa partizanët kishin besim të patundur te komisari i tyre. Po ja, Tërmeti do të largohej. Dhe secili provonte atë ndjenjë që provojnë kur ndahen shokët e armëve. Miqësia partizane ish një miqësi e thellë, luftarakë, vëllazërore. Ne kishim të gjithë një ideal të përbashkët, luftonim për një ideal dhe ky ideal i madh i përbashkët na vëllazëronte. Miqësia partizane ish pagëzuar dhe kalitur në zjarrin e luftës. Kështu ne partizanët f. v. ndanim një copë bukë në kafshata të barabarta, një cigare e kalonim dorë më dorë përtjera të këtij lloji.

Po unë provoja dhe një ndjenjë tjetër. Më ish ngarkuar detyra e komisarit të batalionit. A do të isha vallë në gjëndje që ta kryeja atë detyrë, ashtu siç e kish kryer Tërmeti? A do

të mundesha, së bashku me komandantin e batalionit, shokun Riza Veipi dhe zv-komisarin, shokun Velestin Zeneli, të mbanim lart shpirtin revolucionar të pamposhtur të partizanëve trima, që batalioni të ish po aq i tmershëm për armiqtë, siç kish qënë? Nuk mund të fsheh se ndjeja një lloj frike dhe pasigurie për detyrën që më ish ngarkuar, se komandanti nuk kish një përvojë partizane.

Po me partizanët trima mund të merrej përsipër çdo detyre, çdo mision dhe mund t'i dilej në krye. Ne në detyrën që na kish caktuar partia, u përpinqëm të jepnim gjithshka që mundëm, në këtë mënyrë bëmë që t'i rritet edhe më shumë lavdia e armëve të batalionit «Asim Zeneli».

E di që është tepër vështirë, sado kujtesë të fortë që të kesh, për të treguar gjithë përpjekjet, heroizmat dhe sakrificat, devotshmërinë e lartë patriotike që kanë treguar përballë armiqve partizanët e batalionit «Asim Zeneli». Po, dhe sikur t'i kujtosh të gjitha, s'ka dyshim se nuk është e mundur t'i përshkruash me tërë madhështinë e tyre; megjithatë e kemi për detyre që të tregojmë qoftë edhe një pjesë të asaj që ka ndodhur.

## Në Rrëzoma të Delvinës

Më 14 dhjetor të vitit 1943, batalioni mori urdhër të nisej në drejtim të Delvinës. Qëllimi ishte që të spastroheshin nga forcat balliste fshatrat e Rrëzomës, dhe të forcoheshin Këshillat Nacional-çlirimtare. Nga Gjirokastra e çliruar populli na përcoll me gëzim e dashuri. Ne do të kalonim në drejtim të Malit të Gjërë. Nata na zuri në Qafë të Sopotit. Kishim, veç armatimit të lehtë, pesë mortaja të rënda dhe një top malor. Pas 24 orë udhë-

timi, afër të gdhirit, arritëm në Senicë. Aty vendosëm mortajat dhe topin. Që nga Senica, ne kontrollonim gjithë vendin dhe, në rast rreziku, kishim mundësi të tërhiqeshim fare lehtë në drejtim të maleve. Nga informatat që morëm forcat e Ballit ndodheshin në fshatrat Kopaçez e Palavli. Plani ynë ish që të shpartallonim ballistët përpëra se të vinin gjermanët nga Delvina dhe kështu u veprua. Kur po zbardhë dita ne rrëthuam Kopaçezën dhe Palavlinë. Forcat e Ballit u shpartalluan keqas. Një pjesë e tyre u vra, ndërsa pjesa tjeter që mundi të shpëtonte, ua mbathi këmbëve për në Delvinë.

Pas një ore, në ndihmë të Ballit erdhën forca gjermane nga Delvina. Lufta u ndez e ashpër dhe vazhdoi për tri ditë. Partizanët, me gjithëse të veshur keq, të pangrënë, në ato ditë të ftohta, treguan trimëri të madhe. Gjermanët dhe ballistët sulmuani disa herë për të pushtuar fshatrat e çliruara, por nuk mundën. Batalioni ndërmori një sulm të përgjithshëm duke i thyer gjermanët dhe ballistët, të cilët i ndoqi gjer afër Delvinës.

Ne qëndruam në fshatrat e Rrëzomës tetë ditë. Lufta dhe fitorja jonë mbi gjermanët dhe ballistët në atë krahinë pati rëndësi të madhe. Ajo ngrihti moralin e popullit, u forcuan këshillat, u spastruan njerëz që ishin të shitur te pushtonjësit. Në Rrëzomë, që ish afër qytetit të Delvinës, tradhëtarët kishin një influencë të ndjeshme. Ata vazhdimisht prishnin këshillat, posa largoheshin partizanët, frikësonin dhe arestonin përkrahësit tanë. Po pas asaj lufte ballistët e humbën krejt kredinë e tyre.

Më 22 dhjetor batalioni u kthye në Fushëbardhë. Populli i këtij katundi, që kish marrë vesh mbi luftën në Rrëzomë, na priti me gjëzim të madh. Aty

batalioni u nda në dy pjesë: u formua edhe batalioni i ri «Abas Shehu» me komandant Sadik Buzon dhe komisar Avdul Hakiun, dhe Zv/komisar Mitro Xhanin.

### Asnjë minutë qetësi për armikun

Marrim urdhër të nisemi në drejtim të Këlcyrës, në ndihmë të batalionit «Naim Frashëri.» Bënte të ftohet i madh, binte shi me dëborë. Por partizanët u nisen me këngë në gojë. Çaste të tilla ishin të paharruara. Askush nuk donte t'ja dinte se bënnte ftohet. Është e qartë se ata njerës nuk ishin prej hekuri, aq më tepër kur qenë veshur keq, por vullneti për fitoren i kalonte të gjitha. Kish diçka madhështore, të shënjtë kur shikoje kolonën që çante përpara dhe kënga partizane gjëmonte.

Kaluam në fshatrat Kardhiq, Koron, Shtepëz, ku u detyruam të qëndronin dy ditë, pasi nga shirat e shumta që kishin rënë, lumi i Drinos kish dalë jashtë shtratit dhe ish e pamundur që të kalohej. Po nuk mundëm të pritnim sa të binte lumi. E vetmja mënyrë për t'u hedhur në krahinën e Këlcyrës ish që të kalonim Urën e Leklit, e cila kontrollohej nga gjermanët.

U nisëm në orën 12 të mesnatës të datës 29 dhjetor të vitit 1943. Vazhdonte dimër i ashpër. Ndofta gjermanëve nuk ua merrte mendja se forcat partizane mund të lëviznin në një natë me mot aq të keq. Ata e kishin liruar Urën e Leklit dhe ishin vendosur në Shkallën e Zezë. Kaluam Urën pa asnjë rrrezik dhe marshuam gjatë xhadesë, gjersë arritëm në fshatin e Kodrës. Meqë partizanët ishin rraskapitur nga udha dhe të ftohit, si u kthy-

em 200-300 metra larg nga xhadeja, batalionit iu dha urdhër që të pushonte. Një patrullë partizane u dërgua në drejtësim të Urës së Dragotit për të verifikuar po qe se ajo mbahej nga forcat partizane vullnetare të fshatrave përreth. Po kur gdhinte, patrulla jonë ra në kontakt me gjermanët. Partizani trim Gjysho Aliaj erdhi e njoftoi menjëherë batalionin.

Gjermanët, siç duket, kishin diktuar kalimin e urës nga forcat partizane dhe ishin vënë në ndjejkje; ishin 50-60 veta. Batalioni i rrithoi menjëherë dhe u preu mundësinë për të kaluar nga Ura e Dragotit. Një kompani, nën komandën e Shaban Idrizit, dhe një pjesë e kompanisë «Çerçis Topulli» me komandant Fejzo Dalipi u dërgua për të zënë Urën e Leklit për t'i ndaluar forcat gjermane që mund të vinin në ndihmë nga Shkalla e Zezë.

Lufta me gjermanët filloi e ashpër. Ishte e qartë se nazistët luftonin për jetë a për vdekje. Atyre u ish prerë çdo rrugë. Pas shpine kishin Vjosën që kish vërshtuar jashtë shtratit të vet. Gjermanët kishin zënë pozicionet në disa gurishte te Mulliri i Kodrës, para kishës së fshatit. Partizanët sulmuan disa herë, po ata u mbrojtën me vendosmëri. Gjermanët shpresonin t'u vinin në ndihmë nga Shkalla e Zezë dhe ashtu ndodhi. Po forcat tonë, me gjithë përforcimet që muarën gjermanët, nuk i lejuan që të kalonin urën, dhe pse ata përdorën artilerinë pa ndërprerje, duke hedhur në çdo breshëri 10 predha përnjëherësh. Në atë kohë arriti Mustafa Matohiti që ndodhej në Hormovë. Partizanët sulmuan përsëri me bomba dore dhe i detyruan gjermanët të linin pozicionet dhe të strukeshin gjatë buzës së Vjosës.

Përpara kishës, afër mullirit, gjetëm një nën-

kolonel gjerman të plagosur në njëren dorë dhe në shpatull. Mustafai i foli frëngjisht, që t'u jepte urdhër ushtarëve të dorëzoheshin, pasi ata kishin ardhur si pushtonjës dhe bënин një luftë të pëdrejtë. Nënkoloneli gjerman, po në frëngjisht, iu përgjegj: «Nuk mund t'u jap një urdhër të tillë ushtarëve, qoftë edhe sikur ju të kini të drejtë, pasi ushtari gjerman zbaton vetëm urdhërat e Hitlerit».

15-20 metra më larg partizanët vazhdonin të përlesheshin me gjermanët. Unë vura re se si Mustafai e vështronë me plot nervozitet nazistin fanatik. I lidhëm plagën dhe bashkë me dy ushtarë të tjerë e morën partizanët në prapavijë.

Të 50-60 gjermanët u asgjësuan, shpëtuan vetëm katër. Dy mundën të shpëtonin në mes të plumbave, duke kaluar Urën e Dragotit, ndërsa dy të tjerë e kaluan Vjosën me not. U kapën 20 veta të gjallë, prej të cilëve 11 ishin të plagosur. Këta menjëherë u nisën për në Komandën e Zonës së Shtabit operativ. Në këtë përpjekje, ushtarët gjermanë kur e panë se s'kishin asnjë shpresë shpëtimi, u dorëzuan vetëm pasi i hodhën pushkët dhe mitrolozët në Vjosë. Fanatizmi dhe qëndresa e atyre mekanizmave që kishin humbur çdo ndjenjë njerëzore, që kishin hedhur poshtë çdo parim njerëzor dhe kishin vënë mbi të gjitha Hitlerin e hyjnizuar, u mposht nga heroizmi partizan edhe kësaj here. Forcat e tjera gjermane, kur panë se forcat e rrëthuara u asgjësuan, hoqën dorë nga përpjekjet e mëtejshme. Vetëm artileria e tyre vazhdoi të rrahë gjithmonë e më shumë pozicionet tona. Po përvçeç djegëjeve të disa shtëpive, ne nuk patëm asnjë humbje.

Gjermanëve iu gjetëm edhe një thes me para që kishin grabitur. Prifti na tha se ja kishin grabitur kishës, dhe ne ja dorëzuam atij.

Pas dy ditësh, në mesnatën e 31 dhjetorit, batalioni mori urdhër që të shkonte në ndihmë të forcate që drejtosheshin nga Birçe Sinomati në Tendën e Qypit. Mirëpo atë pozicion të rëndësishëm e kishin kapur forcat gjermane-balliste, të cilat sulmonin në drejtim të fshatit Kajcë. Me një sulm të rrufeshëm batalioni ynë i mori ato pozicione të armiqve dhe i përzuri ata gjer në Qafë të Shkozës.

Të nesërmen armiku erdhi me forca të mëdha, të shoqëruara me tankse në drejtim të xhadesë, përtë kapur Këlcyrën.

Forcat partizane zunë pozicione në Qafë të Kiçokut, ndërsa një kompani u la në Tendën e Qypit. Bombardimi pëllëmbë për pëllëmbë i Qafës së Kiçokut bëri të pamundur qëndresën tonë në atë pozicion dhe u detyruam të tërhiqemi gjer në Ballaban të Këlcyrës. Atje u zhvillua një nga betejat më të ashpra që vazhdoi për 4-5 orë. Armiku sulmonte me tankse, qëllonte me artileri dhe hidhte në sulm forca të shumta. Kjo qe një betejë e rreptë, ku përparrë tanksit, topit dhe mortajës, triumfonte vendosmëria partizane. Më në fund gjermanët dhe ballistët u detyruan të tërhiqen në Qafë të Kiçokut. Por, duke humbur pozitën në Tendën e Qypit, ata ishin në pozita të vështira strategjike dhe përkëtë u detyruan të lenë edhe pozicionet në Qafen e Kiçokut.

Forcat tonë, duke pasur inisjativën, i ndoqën gjermanët këmbla këmbës prej Bubësit gjer në Paraspuar të Beratit. Atje ata kundërsulmuani disa herë me forca më të mëdha, po u thyen keqas nga

forcat partizane, gjersa u detyruan të ktheheshin në qytetin e Beratit.

Mbas këtyre luftimeve të ashpëra, batalioni «Asim Zeneli» kaloi nëpër të gjitha fshatrat e Dëshnicës. Ne zhvillonim mbledhje me popullin, rionganizonim këshillat, demaskonim organizatën tradhëtare të Ballit kombëtar dhe arestonim agjentë dhe spiunë.

### Luftë e papritur në pyll

Si kaluam fshatin Kajcë, gjer në Bus, u kthyem në fshatrat e pjesës së poshtme të Dëshnicës. Po pranë fshatit Kuqar, krejt papritur, ndodhemi ballë për ballë me gjermanët, që vinin në drejtim të Përmetit. Batalioni në atë kohë udhëtonte nëpër një pyll dhe në një ditë me shi. U hapëm menjëherë në formacion luftimi, por shokët që kishin armatimin e rëndë, mitrolozët dhe mortajat, u çorientuan. Vec kësaj, duhet theksuar se ishte mjaft e vështirë të veprohej nëpër pyll me kafshë dhe me armatime të atij lloji.

Po edhe pse nuk u vu në përdorim armatimi i rëndë, batalioni u hodh menjëherë në sulm dhe i zembrapsi gjermanët. Ne u ndodhëm në një situatë të papritur, po partizanët trima nuk e humbën kurajon. Aty u ndodhën rastësisht Jaho Gjoliku dhe Qazim Kondi. Xha Jahua hidhej kundra gjermanëve me një guxim dhe trimëri të pashoqe.

Partizanët nuk u lanë kohë gjermanëve të ndërmerrmin ndonjë sulm, të organizoheshin. Gjatë asaj përpjekje të papritur inisjativa mbeti gjithnjë në duart tonë. Gjermanët ikën të mundur. Ne ka-pëm dy mitrolozë dhe dy kafshë.

Të nesërmen lufta filloi përsëri në Ballaban e Këlcyrë. Këtë herë gjermanët, të tërbuar nga disfatat që kishin pësuar, u kthyen me forca të mëdha. Përpjekja vazhdoi për 10 ditë prej Qafës së Kiçokut në Cukë të Komanit në Rabije e gjer në kufi me Beratin. Gjermanët filluan të sulmojnë në drejtim të Çorovodës për të kaluar në drejtim të Cerovës për të zënë Tendën e Qypit, ndërsa forca të tjera vinin nga Qafa e Shkozës. Bënte të ftohët i madh, kishte rënë dëborë: ndërresat, ushqimet na mungonin. Ishim vendosur në fshatin Bubës. Partizanët qenë strehuar nëpër shtëpi të fshatarëve. Vetëm rojet ndërrroheshin herë pas here. Në fshat për të ngrënë nuk gjetëm.

Kur u ktheva me komandantin e batalionit, shoku Riza Veipi, mora vesh se përgjegjësi i skuadrës që mbante mortajat, topat dhe mitrolozët ishte arrestuar me urdhër të Zv/komisarit të batalionit. Zv/Komisari tha se ai duhej gjykuar nga gjyqi partizan, pasi, në përpjekjen e befasishme me gjermanët në Kuqar, tregoi shenja frike. Kafshët i la vetëm dhe nuk u përdorën mitrolozët e rëndë, me të cilët do tu kishim shkaktuar gjermanëve humbje më të mëdha. Ne na u duk me vend një mendim i tillë dhe u vendos që të mblidhej gjyqi partizan, ky përbëhej nga Zv/komisarët e kompanive, komisari dhe komandanti i batalionit. Gjyqi drejtohej nga Zv/Komisari i batalionit. Ky propozoi që përgjegjësi i skuadrës të pushkatohej. Ne të tjerët mendonim që, duke marrë parasysh se ishin krijuar disa rrëthana të papritura dhe se ai vetëm për një çast nuk u tregua i guximshëm, prandaj t'i jepnim një dënim më të lehtë: t'i hiqnim yllin e kuq për 10 ditë. Debatet vazhduan të ashpra gjer

në orën një pas mes nate. Po më parë është e nevojëshme të hapim një parantezë.

Të gjithë partizanët kanë qënë trima. Në këto fjalë s'ka asgjë të tepëruar. Për partizanët nuk kishte njeri më të urryer se frikacak. Një frikacak të jetonte midis partizanëve ishte e pamundur. Trimëria në radhët e partizanëve ishte diçka e ndërgjegjëshme, një çfaqje e zakonshme, e përherëshme. Asnjeri s'të detyronte të ishe pak trim apo shumë trim, por vetë opinioni partizan, ideali për të cilin luftonim, vendosmëria, besimi në të ardhmen i bënte të gjithë partizanët trima. Dhe ja një partizani, që kish treguar kushedi sa herë guxim dhe trimëri, në një çast të caktuar, në disa rrethana krejt të papritura, i kish munguar ajo kurajë që karakterizonte edhe atë vetë. Dhe për një lëkundje të çastit, për një faj të tillë, ndofta sot dikujt mund t'i duket si diçka shumë e ashpër që të bëhet fjalë për pushkatim. Po në atmosferën e atëherëshme, qoftë dhe një lëkundje e vogël, një shenjë e vogël frike, binte në sy menjëherë, dhe stononte në atë sfond heroizmi masiv. Pas një akti të tillë vetë partizani e ndjente veten të pushkatuar shpirtërisht. Dhe ja, ne ishim para një rasti të tillë. Sigurisht që masa e propozuar nga Zv. Komisari nuk u muar parasysh, megjithë këmbënguljen e tij dhe presionin që ushtroi mbi zv/komisarët e kompanive. Partia na mësonte se njeriu nuk ka lindur trim, por duhej edukuar e brumosur me një ideal të lartë që të bëhej i guximshëm për çdo sakrificë. Ishim pikërisht mësimet, fryma revolucionare, besimi, ideali me të cilat i ushqeu partizanët partia e tyre, që ata shkruan faqe të lavdishme trimëri dhe heroizëm. Dhe kur ndodhë ndonjë rast i tillë i rrallë, ai i mbetej partizanit si një gozhdë në

shpirt për tërë jetën dhe me trimërinë e tij e mbulonte edhe atë ngjarje të rastit. Kështu ndodhi dhe me partizanin tonë.

E përmenda këtë episod për të treguar se sa e neveritëshme, sa përbuzëse ishte frika për partizanin dhe sa rëndë kërkonte ta ndëshkonte atë opinioni i përgjithëshëm.

Pastaj batalioni u hodh në Dangëlli, ku shpartalloi një batalion ballistash dhe, më 25 janar, shkuam në Përmet, ku u bë inaugurimi i Brigadës së 6-të Sulmuese.

### **Luftimi im i fundit në rreshtat e batalionit «Asim Zeneli»**

*Më 25 janar 1943. — Prej Përmetit marshuam në drejtim të Këlcyrës. Sipas informatave që kishim, do të vinin forca gjermane. Batalioni ynë ndaj të ngrysuri zuri pozicione në të dy anët e rrugës pranë fshatit Kosinë.*

Në Përmet ishin tri batalione të Brigadës së 6-të S. dhe tri spitale. Ne duhej ta bënim xhadënë të pakalueshme, mirëpo duhej parashikuar se armiku mund të na sulmonte me tankse.

Për këtë arësyen vumë dy mina në urë dhe dy të tjera pak si kalon urën, në fund të një bregoreje. Gjermanët, sipas të dhënave tona, ndodheshin në lokalitetin e Ballabanit. Afér të gdhirit ata arritën te ura. Tanksi i parë takoi në minë dhe u përmbysh. Katër tankse të tjera kaluan nga një vend që gjermanët e hapën menjëherë, ndërsa me mitroloza filluan të godisnin pozicionet tona. Në atë kohë gjermanët sulmuan dhe ne kundërsulmuam, duke

u përleshur grykë për grykë. Kur katër tankset qëllonin vazhdimisht pozicionet tona, ne kishim vettëm një pushkë antitankse. Luftimet po ashpërsoshezin, forcat këmbësore gjermane po përleshezin me partizanët, që nuk i lejonin të bënin asnje hap përpara. Në atë kohë, kur unë shkoja te përgjegjësi i grupit të armëve të rënda që ta porositja për të qëlluar më me saktësi topi dhe mortaja jone, më goditi një predhë tanki në krahun e djathë. Filloj të më rridhte gjak. Ishim në një pozicion që goditej nga të gjitha anët. Duhej të kalonim një mur 1,5 metër të lartë. Po nga dhëmbja e madhe që kisha në dorë, me gjithëse më ndihmonte dhe komandanti i batalionit, Riza Veipi, nuk mund ta kaloja. Pas shumë përpjekjesh hodhëm murin, po në atë çast unë ndjeva se nuk mund të lëvizja më. Gjaku vazhdonte të më rridhëte. Ne ishim në një vend të rrezikshëm, ku të goditnin predhat. Në atë kohë na vjen në ndihmë Gjysho Aliaj, duke kaluar barkas nëpër predha. Si më larguan ai dhe Rizai afro njëzet metra, Gjyshua nxori shaminë dhe më lidhi krahun. Unë i thashë Rizait dhe zv-komisarit që të më linin mua dhe të shkonin në pozicione. N'atë kohë partizanët kishin dalë duke sulmuar në mes të fushës. Gjermanët po thyheshin. Të katër tankset e tyre u ktheyen prapa. Për tërë natën forcat gjermane u tërroqën.

Ky ka qënë një nga luftimet më të egra që ka zhvilluar batalioni ynë me gjermanët. Për ballë armatimeve të shumta, katër tankseve, numrit të madh të ushtarëve gjermanë, partizanët e batalionit «Asim Zeneli» vinin vendosmërinë, trimërinë e tyre.

Gjendja e krahut po më keqësohej. Infermierët ma mjekuan dhe përpinqeshin për të më nda-

luar gjakun, por ishte e pamundur. Atëherë u nisa për në spitalin partizan që ndodhej në fshatin Kosovë.

Ky ishte luftimi im i fundit që bëra së bashku me partizanët sypatrëmbur të batalionit «Asim Zeneli». Do të ndahesha prej tyre për të mos u kthyer më. Unë e kam kujtuar gjithmonë me dashuri kohën që kalova bashkë me partizanët e atij batalioni.

Sa shkrova për luftimet që ka zhvilluar ky batalion, si edhe për luftimet në malet e Kurveleshit, nuk janë vecse një pjesë e vogël; një kroatikë e thjeshtë e atyre që kanë ngjarë, disa kujtime. Dhe si të tilla duhet të merren prej lexonjësve.

## PJESA E TRETË

### Me plagët në trup

Në çdo pëllëmbë të tokës sonë, partizanët tri-ma u përleshën fyt për fyt me pushtonjësit bar-barë.

Armiqtë lanë në vëndim tonë koskat e tyre, larg vendlindjes, në tokë të huaj. Dhe nuk mund të kishin fat tjetër, gjersa shkelnin këtë tokë me thundrën e çizmeve të pushtonjësve. Dhe sa ndry-shonte vdekja e tyre nga vdekja e heronjve të kësaj toke që binin për vatrën ku kishin lindur, për nderin e atdheut, për lavdinë e tij, që të shkël-qente e pastër si majat e maleve shqiptare të ve-shura me dëborën e përjetëshme: 28 mijë emrat e tyre nuk do të harrohen kurrë. Qindra të tjerë morën mbi trup plagët e predhave dhe plumbave të armikut. Edhe plagët në trupat e partizanëve qenë shenja të një përpjekjeje të ashpër me ar-mikun, dhe ndritën si dekorata trimërie në gjoks të atdheut. Unë isha një nga ata qindra veta që qysh prej datës 26 janar të vitit 1944 e gjer në cilimin e plotë të atdheut, duke mbajtur në nje-rin krah një plagë të armikut, më takonte të shkoja pyll më pyll e mal më mal me partizanët e pla-

gosur dhe të jetojë përsëri thuajse çdo ditë në përpjekje me armikun, të shikoja përsëri me q'vetëmohim partizani mbronte shokun e plagosur, se ç'trimëri e burrëri tregonin të plagosurit në çastet më kritike.

Mund të tregosh për veten dhe është një lloj si kur tregon për shokun tënd, mund të tregosh për shokun tënd dhe është një lloj sikur tregon për veten tënde. Kjo nuk ka asnje rëndësi.

Nga fshati i Kosovës arrita në Frashër. Më shoqëronin dy infermierë. Fshati i Naimit kish fare pak shtëpi, kurse numri i të plagosurve ishte shumë më i madh dhe s'kishin ku të strehoheshin. Vetëm në shtëpinë që shkova unë, kishte 27 të plagosur e infermierë. Ata kishin udhëtar tërë ditën në dëborë, në një të ftohtë të madh. Vendi ishte shumë i zveshur, dhe era të priste si me brisk. Partizanëve u ngrinte pështyma në buzë, aq ftohtë bënte.

Në atë shtëpi partizanët i gjeta pa zjarr dhe pa bukë, por nuk e jepnin veten. Sipas urdhërit, ata duhej të furnizoheshin me bukë nga Teqeja. Po Babai, një njeri i paspirt, u kish thënë intendentëve se do t'ju jepte ushqim vetëm partizanëve që ishin strehuar në Teqe. U takova me shokët e këshillit të fshatit, por fshatarët vuanin vetë nga uria. Ishte e qartë se ata s'kishin fare ç'të na jepnin. Vetëm u ndezën partizanëve zjarr që të ngroheshin. Atëherë unë kërkova të takohesh me Baba Fejzon nga Tepelena, anëtar i Shtabit të Zonës së parë Operative Vlorë-Gjirokastër, që kish ardhur dhe ai në Frashër për t'u kujdesur për të plagosurit. Ai ishte në Teqe, por, siç u muar vesh më vonë, atë e kishin gënjer, duke i thënë se partizanët e plagosur ishin strehuar të

gjithë duke u siguruar me ushqim dhe me fjetje.

Baba Fejzua, i veshur me një xhaketë ushtarrake, me rrÿp të hedhur krahaqafë dhe një revolver në brez, më dolli dhe më priti. Më paraqiti me Babanë e Teqesë e pastaj shkuam në një dhomë, e cila ishte aq e ngrohtë, sa nuk i afroheshe dot zjarrit. Aty shërbenin dy dervishë. Në tryezën e shtruar kishte raki, meze mishi, mollë, bajame, turshi, etj. Baba Fejzua mori gotën e rakisë dhe iu drejtua babait të teqes me fjalët: «ta pimë për shëndetin e Partisë Komuniste».

Unë në atë çast i them Baba Fejzos se të plagosurit ishin pa bukë dhe zjarr, po ai m'u përgjegj të mos bëhesha merak, se ishin siguruar me gjithshka. M'u desh t'i shpjegoja se si ishte gjendja e vërtetë dhe i thashë se unë sapo vija prej tyre. Atëherë Baba Fejzua iu drejtua babait të Teqesë, po ai iu përgjegj se Teqeja nuk kish me se t'i ushqente të gjithë, pasi ishin në mes të malit dhe mund të mbeteshin keq. Baba Fejzua, sa mori vesh një gjë të tillë, e qërttoi ashpër kolegun e tij, duke i thënë:

— C'farë janë këto që thua, jezit i Imam Aliut. Buka dhe Teqeja janë të popullit dhe ata që kanë marrë plagë, janë bijtë e vërtetë të tij.

Babai i Teqesë u ngrit më gjunjë duke thënë gjithnjë:

— Ejvalla! Ejvalla!

— T'u jepet menjëherë ushqim të plagosurve, se të shkula mjekrën, — i bërtiti Baba Fejzua.

Babai i Teqesë ra përsëri tok me dervishët më gjunjë dhe doli menjëherë e u dërgoi ushqime partizanëve të plagosur.

Ora duhet të ishte 8.30 e natës. Me Baba Fejzon kisha mbetur vetëm në dhomë. Unë i thashë:

E tmerove, duke i folur aq ashpër! Por Babai, që vazhdonte të ish i inatosur, m'u përgjegj:

— Do t'i heq menjëherë petkun, po të mos i rregullojë të gjithë partizanët brenda një ore!

Dy partizanë erdhën e na lajmëruan se çdo gjë ishte në rregull dhe Babai me dy dervishët, që posa ishin kthyer, u ulën në tryezë. Baba Fejzua vazhdonte të fliste me nervozitet, tre fetarët aprovonin fjalët e tij me një «ejevalla», duke mbajtur dorën në zemër.

Të nesërmen që në mëngjes spitali u shpër-  
ngul për fshatin Miçan. Disa nga të plagosurit u  
mbartën me kafshë, kurse ata që ishin shumë  
rëndë, me barela, duke i marrë ngadalë ngadalë,  
që të mos u lëndoheshin plagët. Unë me disa sho-  
kë u nisa më përpala për të siguruar strehimin.  
Muarëm me vete edhe disa kafshë për të mbartur  
medikamentet dhe pajimet e tjera, që kishin mbe-  
tur, mbasi kafshët e spitalit nuk mjaftonin as për  
të mbartur të plagosurit. Në atë kohë asgjë nuk  
sigurohej kollaj.

Megjithëqë fshatarët u treguan të gatshëm për  
të na ndihmuar, u ndodh njeri që kërkonte të  
ngjallte pakënaqësi midis fshatarëve, duke i nxiti-  
tur me shëmbëllin e tij të keq që të mos na ndih-  
monin, bile ai foli hapur kundër Luftës Nacional-  
Çlirimtare. Ai ishte një burrë rrëth tridhjetë vjeç-  
ve. U arrestua menjëherë dhe të nesërmen u nxuar  
për ta gjykuar para popullit të fshatit. Unë u cak-  
tova t'i flisja popullit në emër të gjyqit partizan  
për të demaskuar atë njeri që bënte punën e armi-  
kut. Te lëmi i fshatit ishte mbledhur i madh e i  
vogël, kishin ardhur dhe ata partizanë që mund  
të ecënин. Po, pa kaluar as dhjetë minuta, mua më  
filloj një emoragji nga krahu, gjaku më hidhej

lart me forcë. Doktor Ibrahim Dervishi, që kish ardhur për të pritur në Miçan spitalin partizan si dhe doktorët italianë Varano, Karuli dhe Viti, po mundoheshin të më ndalnin gjakun. Mirëpo ishte e pamundur. Emoragjia ishte shumë e madhe, sa që isha në rrezik nga humbja e tepërt e gjakut. Në këto rrethana Ibrahimimi më çau dorën në dy vende me thikë. Gjithë këto veprime bëheshin përjashta, pranë një guri. Gjaku vërvshonte dhe, kur doktorët i vinin dorën, ngriheshin curila si nga një shatryan. Pas dy orësh doktorët mundën të më ndalnin gjakun.

Në Miçan qendruam tri ditë. Që andej spitali u shpërngul në drejtim të Përmetit, pasi nga Skrapari po vinin forca armike. Ish një mëngjes i ftohët. Kafshët u ngarkuan me medikamente dhe pajisjet e spitalit. Të plagosurit, që ishin shumë rëndë, u mbartën në barela, ndërsa të tjerët do të ecën me këmbë. Kur u nisëm, binte një breshër i hollë. Toka ishte e mbuluar me 3-4 cm dëborë. Kolona u nis ngadalë. Doktor Ibrahimimi herë dilte në krye të kolonës, herë në mes e herë në fund. Ai u jepte zemër të sëmurëve. Gati e pyeste secilin si e ndjen te veten, i jepte këshilla. Ai sillej me partizanët e sëmurë, jo vetëm si një doktor, por edhe si një prind i vërtetë.

Por doktor Ibrahimit i pëlqente shumë edhe atmosfera e luftës, përleshja me armikun. Andaj ai shumë herë gjendej edhe në ballë të sulmit, megjithëse për atë ndihej më tepër nevoja për të qënë pranë të sëmurëve. Sa herë qe kritikuar përkëtë. Sa herë e kishim detyruar që të linte luftën dhe të kthehej në spital. Midis partizanëve, Doktor Ibrahim Dervishi bëhej shpesh herë objekt

bisedimesh për trimërinë e tij, për përpjekjet e pakursyera, që bënte për të shëruar partizanët e plagosur, për sjelljen e njerëzishme ndaj tyre. Më kujtohet se një partizan fshatar, dervish Miftari, thoshte:

— More, kjo parti bëri çudira. Kjo bëri që të luftojnë dhe poturepambuktë e jo ne që jemi marrë me pushkë që kur kemi lindur.

Ne qeshnim më fjalët e thjeshta po plot kuptim të partizanit.

Spitali nuk arriti dot atë ditë në Përmet. Natën e kaluam në fshatin Tremisht. Të plagosurve u ishin ftohur plagët. Ato u dhimnin edhe nga rruga. Jo të ishe i sëmurë ose i plagosur, por edhe në një gjendje të mirë shëndetësore, ish tepër e vështirë të bëje një udhëtim në mes një të ftohti të tillë, të veshur keq dhe të pangrënë. Spitali ynë ishte e treta herë që lëvizte brenda më pak se 5-6 ditëve. Por unë nuk dëgjova asnjë partizan që të ankohej.

Të plagosurit dhe të sëmurët u shpërndanë në-për shtëpira. Infermieret na ndërronin plagët, na i pastronin, na i mjekonin dhe kujdesoheshin për ne si për vëllezërit e tyre. Ato merrnin pjesë në dhëmbjet dhe vuajtjet tonë. Ne s'do t'i harrojmë kurrë shoqet, si Nako Muçaja, Arife Baboçi, Resmie Sakua, Hamide Baboçi, nënë Katija, Areko e Hedo Xhangua, e të tjera. Unë do t'u jem përherë mirënjohës Nakos dhe Arifës. Mjeku më kish këshilluar që të rrija shtrirë dhe krahun e plagosur ta mbaja 10 cm. lart nga trupi në një pozicion të palëvizëshëm. Të dy shoqet me qëndruan pranë për tri ditë me radhë natën dhe ditën, duke ma mbajtur dorën sipas porosive të mjekut. Duke më shikuar se kisha dhëmbje të

mëdha, ato qëndronin pa gjumë, bashkë me mua, dhe më lagnin kraharonin me lotë.

### Në zonat e partizanëve grekë

Krahu po më keqësohej gjithnjë e më shumë. Duhej pa tjetër një mjek operator. Më 11 shkurt, me përpjekjet e shokëve të partisë, doktor Ibrahim Dervishi më tha se kishin gjetur një njeri që mund të na tregonte udhën për të shkuar në një spital të partizanëve grekë në Maqedoni. Në orën 9 të mbrëmjes u bëmë gati për nisje. Kishim me vete katër kafshë të ngarkuara me municion dhe ushqime. Bashkë me ne do të vinte edhe Ibrahimini, doktori italian Varano, një infermier. Do të na shoqëronte një kompani me partizanë. Kur u nisëm, binte borë me flokë të mëdha. U nisëm në drejtëm të Tri Urave të Leskovikut. Pas tre ditësh udhëtimi qendruam në shtëpinë e Kiço Kasapit. Aty më nisi përsëri emorragjia. Doktorët ma ndaluan pas shumë përpjekjesh. Doktor Ibrahimini na tha se duhej të niseshim po atë natë. Erseka, ku do të kalonim, ishte mbushur me ballistë dhe gjermanë. Ne duhej të shfrytëzonim kohën e keqe: natën e errët, borën që vazhdonte të binte, erën që fryente pa pushim. Ibrahimini, para se të niseshim, i mblođhi të gjithë partizanët dhe u tha:

— Na duhet të kalojmë përmes gjermanëve dhe ballistëve, rrugë tjetër kalimi nuk ka. Mund të takohemi me rojet apo patrullat armike dhe duhet të luftojmë. Në asnjë mënyrë nuk do të kthehem prapa!

Infermierin dhe tre shokët e tjerë që më mba-

nin mbi kalë Ibrahimi i porositi që sado luftë që të bëhej, ata duhej të ecnin vetëm përpara. Në dorë të armiqve nuk duhej dorëzuar gjallë në çdo lloj rrethane.

Në orën 10 të natës kaluan lumin dhe iu ngjittëm një rrëpire të mbuluar me dëborë, që vënde vënde kish aq trashësi sa pengonte kalimin, sidomos të kafshëve. Në orën 2 pas mesnate kaluan Ersekën pa u diktuar. Vetëm kur ishim larguar në drejtim të kufirit grek gjermanët kishin dalluar gjurmët tonë dhe u vunë në ndjekje. Ata na u afroan duke na qëlluar me pushkë.

Doktor Ibrahimi iu bëri pritë me kompaninë partizane në mënyrë që të na jepte mundësi ne të plagosurve të largohejshim. Pas dy orë luftimi, armiqtë u detyruan të tërhiqeshin.

Po tani na paraqitej një armik jo më pak i egër; të ftohit dhe uria. Bora kish arritur një gjysmë metri trashësi në disa vende kalonte dhe një metër dhe vazhdonte të binte. Ne tani po ecnim në tokën greke. Kafshët nuk mund të iknin më dhe ne u detyruam t'i vrismi, duke lënë pjesën më të madhe të ngarkesës së tyre në dëborë. Një pjesë e partizanëve nuk mund të ecnin. Edhe të shëndetëshmit mezi çanin borën. Në fshatin e parë grek arri-tëm në orën 12 të ditës. Atje kaluan dhe natën. Fshati quhej Pisojan. Rreth orës 3 pasdite mua përsëri më plasi hemoragjia. Më rrodhi aq shumë gjak sa i humba ndjenjat krejt. Për dy orë rrjesht doktorët luftuan me vdekjen, gjersa arriten të më ndalnin gjakun. Duhej që unë pa tjetër të shkoja në spital. Po spitali ish larg. Duhej të shkonim nëpër disa shtigje malore. Veç kësaj, kish rënë borë e madhe. Partizanët ishin të rraskapitur. Mjekët kërkuan ndihmën e fshatarëve grekë. Doktor

Ibrahimi i porositi fshatarët që të më mbanin me kujdes, pasi tronditja më e vogël shkaktonte vdekjen. Si kaluam dy fshatra, mua më plasi përsëri hemoragjia. Kështu që u detyruam të qëndronim në fshatin Eptahor. Të tre doktorët (njeri prej tyre ishte grek) po përpinqeshin të më ndalnin gjakun. Aty ishte i pranishmë edhe komisari i divizionit IX të partizanëve grekë, Karaxhai. Ai ish një burrë rrëth 45 vjeç, me një trup të lidhur dhe të shëndoshë. Doktori grek kur pa që nuk po dilte asgjë, tha i dëshpëruar:

— Mjaft! S'kemi ç'i bëjmë më!

— Duhet luftuar kundër vdekjes! — iu përgjegj doktor Ibrahimi.

Rreth orës 5 doktorët hoqën çdo shpresë shpëtimi. Doktor Ibrahimi iu drejtua Komisarit të divizionit partizan grek:

— Shoku Komisar! Jam i ngarkuar nga Partia Komuniste Shqiptare, nga Shtabi Operativ i zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër që të shpëtohet me çdo kusht jeta e këtij komunisti. Është detyra juaj internacionaliste që të na ndihmoni. Komisari grek u përgjegj se do të bënte ç'ishte e mundur, po atë natë s'kish asnjë mundësi. Spitali iš larg. Doktor Ibrahimi nguli këmbë që kirurgu të thirrej të vinte, të shumtën gjer në orën 2 pas mesnate; ndryshe i sëmuri mbaronte. Doktori nguli këmbë: — Për komunistët s'mund të jetë pengesë asnjë largësi. Jam i urdhëruar që të shpëtohet jeta e këtij komunisti. Dhe partia më ka dërguar që të kërkoj ndihmën tuaj, andaj çdo gjë varet nga ju!

Unë dëgjoja se si Ibrahimi fliste i revoltuar. Më në fund ata të dy shkuat në central dhe komisar Karaxhai urdhëroi që të nisej një kirurg me të gjitha mjetet e operimit, të shoqërohej nga një kom-

pani partizanësh me fenerë, ndërsa një kompani tjetër do të nisej që andej për t'u dalë përpara. Kish rënë mbi një metër borë. Ajo kish ngirë. Ai udhëtim natën do të kryhej në kushte shumë të vështira.

Pas 10 minutash Ibrahimim i erdhi i gjëzuar dhe me lajmëroi se atë natë do të vinte një kirurg. Kisha dhembje të forta, aq sa nuk mund të qëndroja as shtrirë. Krahu m'u ajt shumë. Mishi m'u nxi krejt, vetëm gishti i vogël i krahut të plagosur mori gati trashësinë e qafës së dorës të një fëmije. Më bënin vazhdimisht gjëlpëra, siç duket për forcim zemre. Ibrahimim dërgonte Pertef Kokalarin e Braho Gabën vazhdimisht në çentral për të marrë lajm mbi kirurgun. Mbas orës 3 të mesnatës krahu m'u nxi krejt; të ajturit më erdhi gjer në rrëzë të supit. Unë s'mund të ngrihesha dot më këmbë. Ibrahimim lëviste pa pushim, dilte në drithare, kthehej përsëri pér të shikuar tenxheren që valonte me ujë të nxeh të, pér ta pasur gati kirurgu dhe herë pas here më bënte ndonjë gjilpëre. Porsa dëgjoi një zhurmë, doli përjashta dhe u kthye fluturimthi. Ai më dha lajmin se kirurgu kish ardhur dhe u ul e më puthi nga gjëzimi. Kirurgu zveshi menjëherë një pallto të madhe gjëzofi. U përshëndet me Ibrahimimin dhe hodhën menjëherë në temxhere thika dhe pinca. Filluan të më kontrollojnë krahun. Kirurgu grek thoshte se duhej prerë deri në majën e supit, ndërsa Ibrahimim ngulte këmbë pér më poshtë. Ata flisnin italisht dhe e merrja vesh bisedën e tyre. Më në fund, më pyetën mua. Doktori shqiptar i tha kirurgut se i sëmuri nuk pranon te t'i pritej dora aq lart. Ibrahimim kishte qëllim që të më pritej me një vend të tillë që të kishe mundësi të vendosej protezë.

Të gjitha këto biseda nuk zgjatën më shumë se tri minuta. Menjëherë më vendosën në një dyshek të shtruar për tokë. Ibrahimim më ngushullonte duke më thënë se me narkozë nuk do ta ndjeja dhëmbjen fare.

Operacioni u krye dhe nga ora 9 e ditës mundoheshin që të më nisnin për në spital, po, si duket, gjendja ime nuk ish e mirë dhe u la për ditën tjetër. Po edhe në spital, pas operacionit, nuk kisha përmirësimë. Doktor Ibrahimim qëndroi aty edhe 5-6 ditë të tjera. Ai, para se të largohej, bisedoi me të gjithë personelin e spitalit për të më kryer të gjitha shërbimet e duhura.

Vendi ku ish ngritur spitali quhej Pendallofo. Lokali ish një shkollë e madhe me disa anekse, ku ishin shtruar rrëth 200 të sëmurë. Veç meje aty kish dhe shqiptarë të tjerë si shoku Enver Liço me dy partizanë të tjerë të sëmurë. Enverit i kishin ngrirë gishtërinjtë e këmbëve nga bora. Atij i hiqnin një nga një kockat e gishtërinjve, gjersa këmbla i mbeti krejt pa gishtërinj. Gjithashtu bashkë me mua kishin ardhur dhe shokët Sabri Pilkati dhe Astrit Kallapodhi që edhe ata u bënë operacion, Sabriu në kokë dhe Astriti në sy.

Unë që nga dita që u shtrova dhe gjer më 20 prill 1944, d.m.th. gati katër muaj, nuk munda të lëvizja nga vendi. Më 20 të prillit më thanë se me kërkonte vëllai Selmani në telefon. U përpoqa për herë të parë të ngrihesha në këmbë, por nuk munda, u desh të më ndihmonin dhe shokët dhe fillova të eci nga pak. Megjithë që centrali ish shumë afër, unë atje arrita pas tre çerek orësh, aq ngadal ecja. Vëllai kish ardhur bashkë me Memo Pleshtin nga Lekdushi. Ata qëndruan aty deri me 10 maj për të pritur sa të përmirësohe-

sha. Unë po shkoja gjithnjë duke u përmirësuar. Fillova të ngrihesha të ecij më lirisht, të merria pjesë në biseda dhe në konferenca politike. Nëpër konferencat politike kishte raste që vinin në kundërshtim me partizanët grekë. Kështu, p.sh., ne u hëngrem me drejtorin e spitalit se ai thosh që pas luftës Greqia do të zgjeronte kufitë e saja në kurriz të Shteteve fqinje. Unë një gjë të tillë e kundërshtoja si të palogjikëshme, bashkë me shokët e mi, dhe krejt të padrejtë, vec asaj ai nuk ishte i qartë politikisht si komunist grek. Puna arriti gjer sa kërkua më të ndërhyjë komisari i divisionit, Karaxhai. Ai më dha të drejtë mua. Sigurisht kjo qartësi jona ish si përfundim i politikës së drejtë, i svarimit të plotë që na kish bërë neve partija jonë e për këtë e ndjenim veten krenarë, se kur ngrihen probleme të ndryshme ne dinim si të orientoheshim dhe të jepnim gjykime të drejta mbi këtë ose atë problem.

Më 10 maj 1944 u nisëm nga spitali për në atdhe. Shokët grekë na shoqëruan deri në kufi. — Ata e njihnin vendin mirë dhe mundën të na kallionin nën hundën e gjermanëve dhe ballistëve pa u diktuar. Edhe në këtë rast ashtu si dhe në spital, shokët grekë treguan për ne kujdesin më të madh. Kjo ishte e dyta herë që më takonte të shikoja solidaritetin e komunistëve grekë, ndihmën e tyre internacionaliste: një herë, më 1941, kur na ndihmuam për t'u kthyer nga Selaniku për në atdhe dhe tanj kur ata bënë për ne të plagosurit shqiptarë gjithshka të mundur që të shëroheshim sa më shpejt. Kjo ndihmë, ky solidaritet e kish bazën te ideali ynë i përbashkët, te lufta kundërtë njejtë armik. Ajo ish miqësi dhe ndihmë midis shokëve të armëve. Ne derdhëm gjak kundër

të njëjtët armik dhe kjo miqësi gjaku nuk do të shuhet kurrë midis dy popujve tanë.

### Çaste hidhërimi dhe mallëngjimi

Më 16 maj u kthyem në Përmet. Ishim përsëri në gjirin e atdheut tonë të dashur. Na kish marrë malli edhe për gurët e drurët.

Në spital takova edhe shokun tim të vjetër të grupeve komuniste Jani Zaharinë. Ai u interesua për shëndetin tim. Biseda midis nesh u bë për luftërat, për shokët, për të afërmit, për fitoret, për humbjet e shokëve. Ndër të tjera ai më njoftoi vdekjen e Mustafa Matohitit, Meleq Gossnishtit, Memo Metos, Sadik Buzos, Halil Ymerit, Sejdin Xhafos, dhe të shokëve të tjera.

Nuk mund ta përshkruaj emocionin dhe hidhërimin që kalova në ato çaste. Që të dy qamë. Po Jani e mblodhi veten i pari dhe më tha:

— Ne nuk duhet të qajmë, Ago! Shokët që ranë në fushën e nderit na lanë si amanet që të vazhdojmë çështjen e tyre. Kjo duhet të na bëjë më të fortë dhe më të egër me armikun.

Kujt i ka ndodhur që, papritur të marrë vesh se shokët e tij të armëve nuk janë më, mund të ketë provuar atë që provova unë në ato çaste. Shokët nuk mund t'i përfytyroja veçse të gjallë, ashtu siç kishin mbetur të gjallë në mendjen time edhe hidhërimet, gjëzimet, plagët e luftës, ngazellimi i fitores, kur ishim ndarë herën e fundit. Kujtoja ato çaste të vështira kur isha ndarë prej tyre, kur çdo gur e çdo breg i asaj ane të kujtonte një përpjekje, një episod, një bashkëfjalim me shokun e vrarë. M'u kujtua bilbili i Labërisë, Mustafa Matohiti, lufta në Ballaban të Këlcyrës, ku Halili,

Sadiku dhe Sejdini suleshin si luanë mbi gjermanët; trimi Murat Bardhi që u hodh në fyt fashistave, Memua, militant i shquar i çeshtjes së partisë dhe i revolucionit, veprimitaria e tij revolucionare, këngët e tija që të jepnin forcë në çastet më të vështira, satira e tij aq therëse për armiqëtë dhe tradhëtarët.

Në operacionin e dimrit, më 1942, në Kurvelesh populli dhe partizanët kishin zënë grykat dhe shtigjet nga mund të vinte armiku. Gratë dhe fëmijët, në shpella dhe pyje, prisin me padurim fatin e burrave të tyre. Aeroplani mitrolonin dhe bombardonin për disa ditë pyje, gërxhe, fshatrat, duke mos pasur mëshirë as për gratë dhe fëmijët.

Në ato çaste të vështira, kur me Memon shkoja nga një pozicion në tjetrin për t'i dhënë zemër popullit dhe luftëtarëve, në afërsi të Qafës Dërrasës, ai, me gjithëse i rraskapitur, ngriti një këngë shumë shprehëse për çastin që po kalonim:

Kurvelesh zemëra imc, Kurvelesh  
Dita ditës kërcënime, Kurvelesh,  
Të dërgon Duçja lövdime, Kurvelesh,  
Se do behen bombardime, Kurvelesh,  
Në Kurvelesh s'ndihet frika, Kurvelesh,  
Nga Kolgjini dhe Merlika, Kurvelesh...

Kjo këngë ishte kushtrim për partizanët, që kishin disa ditë në pozicione. Ajo u përhap menjëherë dhe këndohej nga pozicioni në pozicion, duke u dhënë zemër burrave dhe grave, që hidhen edhe më me forcë kundër armikut.

Një herë tjetër me Memon po kthehesha nga Picari, duke kaluar natën në Grykën e Lepushës (Shuri i Kucit). Vëndi ishte shumë i rrezikshëm,



Dëshmori Memo Meto

po duhej kaluar pa tjetër. Rreziku shtohej edhe sepse në atë vend bënин roje disa patrulla të xhanda-mërisë. Vëndosëm t'i kalonim dy nga dy. Kaluam unë dhe Memua të parët dhe u futëm në vijën e Mullirit të Halos, që të prisnim shokët. Memua më propozoi të dëgjoja një këngë të re. Sapo filluam t'ja merrnim këngës, arriti Alem Kondi me Karadakun dhe ja nisëm këngës me zë të ulët:

Grykës Shurit tatëpjetë.  
Dëgjohet një çap i lehtë,  
Shkon partizani në çetë...

Memua me këtë këngë përfytyronte, se si, në gjithë rrugët, gërxhet, natë e ditë, në çdo fshat dhe krahanë, partizanët kalonin në njësite dhe çeta; përfytyronte gjithë krahanën, gjithë Shqipërinë që ish ngritur nën kushtimin e lirisë dhe kish marrë malet atje, ku shqiponjat kishin ndërtuar foletë.

Më del përpara syve Memua në ceremoninë e varrimit të déshmorit të parë të Kurveleshit, Dalip Tares. Për nder të tij në Nivicë kishte ardhur populli i gjithë fshatrave për rrëth: burra të moshuar, nëna labe që aq bukur u thurnin ligje djemve të tyre, të rinj e të reja. Për të berë nderimet e fundit, çeta ishte rrjeshtuar përpara varrit të shokut të vrarë. Kur e nxorëm nga varri, ku e kishin hedhur tradhëtarët, për çudi të të gjithëve, ai ishte i paprishur, i patretur; i dukej bile edhe plaga, që kish marrë dhe vendi ku kish kaluar plumbi.

Nga mesi i turmës një grua e qante me një

zë të qartë dhe kumbonjës. Me ligjet që ajo thuri, beri që të qanin të gjithë të pranishmit.

Dalip leshëragabuli,  
U derëzeza, o djale,  
Pse s'zure një rrëzë guri,  
U derëzeza, o djale,..  
Të vrisje sa të ziq plumbi,  
U derëzeza, o djale,..

Po kështu vajtoi pak më vonë edhe motra e dëshmorit Sadik Buzo, që kish një djale të vetëm; të cilin, për ca kohë, e kish pasur partizan dhe më vonë i qe hedhur në radhët e Ballit kombëtar, i gënjer nga puna armiqësore e Bilal Nivicës. Ajo as të birit, të vdekur, nuk ja falte tradhëtinë. Lötët i derdhite për të vëllanë dëshmor, trimin Sadik Buzo dhe për të birin, po këtë e qortonte ashpër. Ajo do të kish pasur dëshirë që edhe i biri të vritet si i vëllai që të kish përsë të qante: Ajo duke e vajtuar i thoshte edhe këto fjalë:

S'm'u vrave me dajo trimnë,  
U derëzeza, o djale,  
Po u vrave me Seitnë!  
Sos m'u vrave për liri,  
Por për turp e tradhëti!

Memua atëhere, kur të gjithë kishin shpërthyer në ngashërim, u ngrit e foli në emër të Frontit Nacional-Çlirimtar:

— Nëna dhe motra! Prindër dhe shokë!  
Mos derdhni lot mbi varrin e Dalipit, shokut tonë të dashur. Ai qendroi si trim me armë në dorë. Luftoi edhe me baltën e zezë e të ftohtë duke mos

u tretur, për t'u takuar me shokët e tij të Partisë, me ju, bashkëfshatarët e tij, me të gjithë, o vëllezër kurveleshas, për të na kujtuar edhe një herë atë betim që kishte bërë në zemrën e tij, se jetën ja kishte kushtuar atdheut dhe se do të luftonte gjer në fund për çlirimin e Shqipërisë. Ai nuk arriti ta vazhdonte luftën gjer në fund, se plumbi tradhëtar e shtriu përdhe. Po përpara trupit të tij nuk duhet të qajmë, por të betohemi se do të bashkohemi të gjithë nën udhëheqjen e Partisë, të zhdukim sa më shpejt pushtonjësit fashistë dhe, së bashku me ta, edhe bashkëpunëtorët e tyre. Të ngremë lart mbi malet tona dhe brigjet legjendare të Kurveleshit flamurin e lirisë, flamurin që na lenë në duar amanet shokët tanë Qemal Stafa, Perlat Rexhepi, Myzafer Askeriu dhe të tjerë shokë e shoqe, që janë vrarë e po vriten në luftë dhe përleshje të përditëshme me armikun. Fitorja është jona. Gjaku i tyre është nderi dhe krenaria e popullit tonë.

Fjala e tij la përshtypje të thellë në të pranishmit. Ata u betuan se do të luftonin ashtu siç i mësonte Partia për çlirimin e atdheut.

Këto episode m'u kujtuan kur mora vesh lajmin e vrasjes së Memos, e këtij militanti të vijës së Partisë, birit besnik të Labërisë trime.

### Të plagosurit në tërheqje

Si qëndrova ca ditë në spitalin e Përmetit, shkova në fshatin Lëshicë, ku ishin shokët e mi Musa Daci, Saliko Sulo, Josif Pogaçe dhe të plagosur të tjerë rëndë që nuk mund të lëviznin nga vendi.

Më 24 maj 1944 u ndodha në Kongresin e Përmetit. Delegatët vinin nga të gjitha anët. Nuk mund të përshkruhej dot entuziazmi dhe hareja e atyre ditëve. Si mbaroi kongresi, që do të kish atë rëndësi historike që e dimë të gjithë, shoku Enver Hoxha takohet me komandantët e njësive partizane, u jep këshilla, udhëzime, u njofton se së shpejti nazistët gjermanë do të përgatisnin një operacion, të madh. Ai pothuaj u përqafua me të gjithë. Kur po largohej dhe përhëndeste me dorë, disa shokë, në shenjë hareje, po shtinin me pushkë dhe revolverë. Shoku Enver i porositi që t'i ruajnë fishekët për ar-mikun.

Dhe nga Përmeti, komisarë dhe komandantë të njësive partizane, aktivistë, patriotë, burra dhe gra, po shpërndaheshin për në të gjitha anët e atdheut, si dejat e gjakut në trupin e njeriut, përtë shkuar përsëri në krye të detyrës, përtë zgjerruar luftën në front dhe punën në zonat e çliruara, me forca dhe energji të reja, me besim të shumë-fishuar.

Dhe vërtet, pas pak ditëve, filloi operacioni i njohur i qershorit. Në atë kohë unë isha në spitalin partizan të Leshicës, i cili u shpërngul në drejtim të pyjeve të Lupckës. Komisari i spitalit, shoku Mufit Dudushi, kish grumbulluar kafshët përmbartjen e të plagosurve, ndërsa të plagosurve rëndë u ishin përgatitur barela. Po ato nuk mjaf-tonin, pasi gjatë ditëve të fundit kishin ardhur të plagosur të tjerë. Emil Qirkua me disa shokë të tjerë, me shkathësinë që i karakterizonte, thurën shpejt e shpejt disa barela me shufra lofate. Filloi mbartja e të plagosurve grupe grupe. Arritëm në një lugine me pyje të dendur. Ishim rrëth 200 veta. Po atë mbremje arritën aty edhe spitalet e Korçës

dhe të Skraparit. Merret me mend se me sa vësh-tirësi mund të manovroje me kafshë që mbartnin të plagosurit ose me barela. Lugina ishte e mbushur plot. Mirë por nuk lejohej që të grumbulloheshin të gjitha spitalet në një vend. Duhej shpërndarë në pika të ndryshme. Dhe kështu u bë. Filluam të ndahemi nëpër grupe. Çdo grupi iu caktuan inten-dentët dhe infermierët përkatës. Filloi shpërndarja e të sëmurëve, ndërsa ata që nuk lëviznin dot, mba-reshin nga shokët në krahë.

Shtabi i spitalit krijoj lidhje me të gjithë këto grupe, sidomos me ata që ishin plagosur rëndë. Gji-thashtu ishim në lidhje me Shtabin e përgjithshëm. Shoku Spiro Moisiu na urdhëronte që të manovronim me të gjitha mënyrat, që armiku të mos kapte asnjë të sëmurë. Një batalion partizan me koman-dant e komisar Xhorxhi Zeren e Birçe Sinematin, luftonte me trimëri, që armiku të mos depërtonte në pyll. Duhej mbrojtur jeta e 300 të plagosurve. Për këtë batalioni kundërsulmoi disa herë; por for-cat fashiste ishin aq të shumta, sa që qe e pamun-dur të ndaloheshin. Veç kësaj, ata sulmuani në drej-time të ndryshme, na dolën prapa krahëve dhe fi-luan të qëllonin nëpër pyll. Në këtë mënyrë spi-tali mbetet i rrëthuar. Gjermanët filluan të kërko-nin me qen policë grupet e të plagosurve. Atëhere kompanitë e batalionit u shpérndanë në drejtime të ndryshme andej nga msynin gjermanët dhe ranë në përpjekje me ta në disa vende. Vetëm si përfundim i këtij manovrimi, nazistët hasën qëndresë në pika të ndryshme dhe nuk mundën të kapnin asnjë të plagosur.

Afër mbrëmjes një skuadër partizanësh u rrë-thua nga gjermanët befasisht dhe u kap rob, po në çastin kur do t'i pushkatonin, ata u hodhën kun-

dër gjermanëve dhe disa tentuan të iknin. Të ne-sërmen në mëngjez unë, Xhorxhi dhe Birçja shkuam në vendin ku gjermanët kishin pushkatuar shokët tanë. Gjetëm 8 veta të vrarë. Kufoma e parë që dalluam, ish ajo e një partizaneje të veshur me një fustan të zi. E gjetëm të rënë përmbyss. Zakonisht kjo nuk ish veshje e partizaneve. Mua s'di pse më bëri përshtypje fustani i saj i zi. Ndofta asaj mund t'i ishin vrarë vëllai, i fejuari ose prindërit. Ishim që të tre shumë të dëshpëruar, megjithëse forcat partizane kishin manovruar mjaft mirë, duke mos u dhënë mundësi gjermanëve që të kapnin asnë të plagosur. Ne na duhej që të përgatisnim varrimin e të vrarëve sa më shpejt, pasi gjermanët ende vazhdonin të na mbanin të rrëthuar. Tek po kthe-heshim, qëndruam sérish pranë partizanes me fustan të zi për të shikuar plagët që kish marrë. Po papritur, ajo filloj të lëvizte.

— Mos do të jetë akoma e gjallë! Po lëviz!  
— tha Birçja.

Partizana e njoihu zërin e komisarit të saj dhe foli menjëherë. Ajo kish mbetur e plagosur, po herën e parë nuk dha shënë se dyshoi se mos ishim gjermanë, apo baillistë. Ajo na tregoi se si i kishin kapur shokët gjermanët dhe si i kishin vrarë. Edhe n'ato çaste, nuk e di pse u gëzova aq te-për kur u ndodhëm përpara asaj së papriture.

Ndërkohë gjermanët ishin larguar. Spitali i Korçës dhe i Skraparit ishin nisur në drejtim të Këlcyrés për të arritur në Kurvelesh, kurse ne u mblozhëm, se ishim të ndarë në grupe, për në fshatin Lupckë. Sipas lajmeve që kishim, forcat gjermane ishin kthyer në drejtim të Dangëllisë për t'u ardhur në ndihmë forcave të tyre që luftomin kundër Divizonit të parë, prandaj

urdhëri ish që të kthehet e përsëri në Leshicë të Përmetit. Të plagosurit nisën udhën ashtu siç ishin, të lodhur e të rraskapitur.

Personelin që i shoqéronte, e karakterizonte një qëndresë e papërshkrueshme. Përpara të sëmurëve dhe të plagosurve nuk jepej asnje shënjë lodhjeje, rreziku, dëshpërimi. Nuk kish gjë më të shenjtë se sa të bëje çdo sakrificë për të shpëtuar jetën e atyre që kishin provuar në mishin e vet plagët e armikut.

Pasi qëndruam tri ditë në Leshicë, u muar vesh se gjermanët dolën në Këlcyrë, kapën urën e Përmetit, andaj aty s'mund të qëndronim më. Këtë lajm na e pruri korieri. Ishte një djali i gjallë, sypatrembur. Më kujtohet vetëm emri i tij, quhej Zeqo. Ky deshi të nisej përsëri. Rrua ish prerë. Po Zequa ish i vendosur ta hidhët lumin e Vjosës, edhe pse s'dinte fare not. Sigurisht që të hidhje Vjosën që kish ujë të shumtë, pa ditur as not, d.m.th. të gjeje vdekjen e sigurt. **Unë nuk e lejova që të nisej.**

Spitalit s'i mbetej gjë veçse të shpërngulej përsëri. Duhej t'i ngjitej malit të Badilonjës, të dilte më mal të Policanit dhe nga Policanit të shkoni më drejtim të Kurveleshit. Menjëherë grumbulluan disa kafshë të fshatrave për rrith, dhe u nisëm. Mbrëmanet ishim larguar mjaft nga Leshica. Të nesërmen filluan t'i ngjitemi të përpjetaye të malit, që ishin rrëpira të vërteta. Gjermanët qëllonin me artilleri të plagosurit gjatë tërheqjes. Na u rrëzuan disa mushka me gjithë të plagosurit, me ushqimet dhe medikamentet që kishim. Prandaj pjesën më të madhe të të plagosurve e mbartëm me barela. Rrith orës 1 të ditës arritëm më majë të

malit të Policanit, ku qëndruam për të pushuar në disa gropa.

Aty kishin stanet disa vlehe. Këtyre u kërkuam të na jepnin qumësht për të sëmurët e të plagosurit. Po ata nuk pranuan dhe na thanë të largohe-shim që andej, pasi do të na diktonin gjermanët dhe do t'i merrnim në qafë dhe ata. Vllehtë ishin të tmerruar nga frika.

Në atë kohë arrin një grup partizanësh të Brigadës së tetë. Ata na thanë se gjermanët, të ardhur që nga malet e Greqisë, kishin arritur në Sheper, Polican dhe Fllomo. Në në fillim nuk i besuam dhe i morëm për dezertorë. Po pak më vonë erdhi Mehmet Ali Shehu me disa partizanë dhe na tha se këto lajme ishin të vërteta e pritej që gjermanët të dilnin nga çasti në çast në majë të malit, ku ishim edhe ne. Pra, ishim të rrethuar nga të dy anët. Ahere u vendos që spitali të fshihej në pyllin e Badillonjës. U ndamë në grupe, duke pasur çdo grup 5 veta të armatosur.

Gjermanët dolën në majë të malit dhe filluan të na qëllonin që andej. Një pjesë e partizanëve, bashkë me korier Zeqon nga Tërbaçi, qëndruan për të pritur gjermanët, gjersa të fshihej mirë spitali. Po ata nuk u varën poshtë, qëndruan në majë të malit, gjersa u larguan fare.

Pylli i Badillonjës ish mbushur plot. Poshtë nesh ishin strehuar banorët e fshatrave për rreth me fëmijë, me bagëti. Ne qëndruam në pyll për tri ditë pa pasur asnjë ushqim. Po më tepër se sa uria për bukë, nuk durohej dot etja, sidomos në atë vapë dhe zagushi të madhe që kish në pyll. Ne shikonim poshtë me një etje të djegur Vjosën që gjarpëronte. Po ditën e tretë, 30 gjerma-

në që vinin nga Përmeti u kthyen në pyll dhe filluan të qëllonin me automatikë e mitrolozë.

Ishim në rrezik. Të sëmurët e plagosur as që ishin në gjendje të luftonin. Pas gjithë atij marshimi të gjatë, ata mezi mbanin frymën. Shkova grup më grup. Të gjithë kishin nxjerrë ato bomba që u ndodheshin; revolverët i mbanin në duar, sidomos ata që s'lëviznin dot. Ishin të vendosur që të mos dorëzoheshin të gjallë.

Gjermanët më poshtë nesh takuan disa familje. Ne e morëm vesh këtë nga të shtenat dhe ulërimat e grave dhe fëmijëve. Ato po vinin në drejtimin tonë. Unë, korier Zequa dhe Faiku, që kishim mundësi të luftonim, po i prisnim gjermanët gati për luftë. Zequa kish një automatik. Unë mbaja bomba, pasi krahu i prerë më pengonte të qëlloja më këmbë me pushkë. Me të na u afruar, ne i goditëm gjermanët që të tre me bomba. Kjo ish për ta e papritur dhe i çorientoi. Zequa filloi t'i ndjekë me automatik.

Sic duket, gjermanët menduan se në pyll kish forca të shumta partizane dhe u larguan në panik. U hap vendi për ujë. Partizanët e plagosur filluan të shtinin nga gjëzimi, dhe të shtenat i tmeruan gjermanët. Spitali i kish shpëtuar çdo rreziku. Në ato ditë marshimi të pandërprerë e përpjekjesh me armiqtë, qëndresa dhe heroizmi partizan ishin të patregueshëm. Vetëm një gjë mund të thuhet: për partizanët nuk kish asgjë të pamundur.

Spitali, sipas urdhërit të Shtabit të Zonës së Parë Operative, u vendos në fshatin Kosovë. Komisari i shtabit të zonës, shoku Abdyl Këllezi, falenderoi personelin e spitalit dhe të sëmurët e të plagosurit, që, duke qendruar me burräri.

duke përballuar vështirësi të pamundura, të parashikuara, i shpëtuan darës së armikut.

## Përmes Adriatikut

Në krah më kishte dalë jashtë mishit një kockë 10 cm. e gjatë. Sipas doktorit italian, Varano, ajo duhej bërë përsëri operacion. Kështu mua më takoi të shkoja me të plagosur të tjerë në Itali, sipas një marrëveshjeje që kishim me aleatët. Më 20 gusht të vitit 1944 arritëm në Pilur të Himarës. Pas katër ditësh erdhi dhe na mori një motobarkë. Shtabi i përgjithshëm kishte urdhëruar që, bashkë me ne, të vinin dhe disa italiane të plagosur.

Motobarka ishte ngarkuar plot. Italianët këndonin nga gëzimi që po kthehen në atdhe. Ata qendronin sipër mbi kuvertë. Vetëm disa italiane që kishin qenë partizanë vinin tek ne dhe flisnin plot admirim për popullin dhe luftën tonë. Disa nga ata italianët që qëndronin sipër dhe që i kishim strehuar në prapavijat tona për t'u shpëtuar kokën, filluan të na shanin ne shqiptarët. Filluan të grindeshim me ta. Kur, papritur, pranë motobarkës ranë predha artillerie. Ata, të frikësuar, zbritën poshtë me vrap. Gjermanët, që kishin diktyuar motobarkën tonë, na qëllonin me artileri që nga Llogaraja. Predhat binin shumë afër, aq sa uji që ngrihej nga predhat, mbulonte anjen tonë. Ne i thamë kapitenit ta kthente barkën nga jugëperëndimi për të zvogëluar figurën. Ishte me të vërtetë një gjendje e tmershme, kur ashtu, në mes të detit, pa qenë i aftë për asnjë veprim, të prisje fatalisht se ku do të binte predha.

Po pas dhjetë minutash ne u larguam shumë dhe artilleria pushoi së qëlluari.

Ata italianët që gjer n'atë kohë, të trëmbur si minjtë, ishin futur në hambar, dolën përsëri dhe filluan të na fyenin. Përgjithësisht qenë nga ata që i kishim pasur kuzinierë nëpër spitale, ose ishin marrë me punë të tjera në prapavija. Ishin nja pesëdhjetë veta. Dhe ja tashti kundrejt popullit tonë trim, që u kish shpëtuar kokën, që i kish prurë gjer në atë ditë sa të ktheheshin shëndoshë e mirë pranë familjeve të tyre, silleshin me aqë mosmirënjojje. Atyre, siç duket, nuk u ish shkullur ende nga mushkëritë era e qelbur e fashizmit të Duçes. Po ata ishin vetëm një pjesë. Më kujtohet mirë se një italian që quhej Luigji, që kish luftuar me trimëri krah për krah me partizanët e Brigadës së Parë, fliste me simpati të madhe për heroizmin partizan, për shpirtin liridashës e fisionik të popullit tonë. Ai, në një rast, i inatosur, i qëlloi me patericat e veta disa italianë që po na fyenin. Luigji ish i plagosur në këmbë. Ai, i nevrikosur, iu drejtua bashkatdhetarëve të vet:

— Italia pati njerëz të poshtër si ju, që i vannë pas Musolini dhe e çuan Italinë gjer në një ditë të tillë. Ne erdhëm në Shqipëri si pushtonjës, si vrasës. Shqiptarët, jo vetëm që nuk na vranë, megjithëse kishin plot të drejtë ta bënин një gjë të tillë, po u sollën me ne si njerëz, sepse ata nuk e ngatërruan kurrë popullin italian me Duçen, me fashizmin.

«Ne e kemi për detyrë që në Itali të luftojmë që të mos kthehet fashizmi kurrë më. Po ja që paska disa nga ju, që edhe pse i provuan mbi supet e tyre pasojat e politikës imperialiste, prapë akoma nuk kanë vënë mënd».

Fjalët e Luigjit nuk mund të thuash se e bindën, po të paktën e bënë që të heshte atë grup gan-

gsterësh, që kishin paturpësinë të shanin popullin tonë, pa ndihmën e të cilit do të kishin gjetur vdekjën e sigurt nga thikat dhe plumbat e gjermanëve të pamëshirshëm, ashtu siç e gjetën shumë ushtarë të tjerë që u kishin rënë në duar.

Ky episod i vogël kish një kuptim të thellë simbolik: një pjesë akoma nuk kishin marrë mësimme nga historia. Ai grup vagabondësh simbolizonte ato forca reaksionare që edhe sot e kësaj dite në Itali ndjekin politikën imperialiste.

Në Brindis arritëm shpejt. Kishin dalë për të na pritur shumë oficerë anglezë, një gjeneral, si dhe delegacioni ynë i komandës së përgjithëshme në Shtabin e Mesdheut. Ishim shtatëdhjetë veta. Në fillim në spitale na shërbyen mirë. Doktorët dhe infermierët ishin anglezë. Po kjo zgjati pak kohë. Filluan të na lagonin grupe-grupe nga spitali dhe të na shpërndanin në drejtime të paditura. Shumë shokë i çuan nëpër fshatra, duke i lënë pa mjekuar, ata vuajtën për ushqime dhe strehë. Po ne, që në Shqipëri kishim zgjedhur një komitet, i cili u interesua për t'u grumbulluar gjithë shokët, që ishin lënë nën mëshirën e fatit.

Më 3 dhjetor u kthyem në atdheun e dashur, që tani ish qiruar plotësisht.

Në Tiranë qendruam një javë. Gjithë vendi ish i djegur dhe i shkretuar. Komunikacioni, linjat telefonike nuk punonin. Po entusiazmi në popull që i papërshkrueshëm.

### Dyshimi që më bëri të mendohesha

Në mes të entusiazmit të përgjithshëm, diçka më bëri të mendohesha. Një shok që vinte nga Kosova më tha se jugosllavët po masakronin shqip-

tarët. Po të mos e njihja mirë, sigurisht që do ta cilësoja si provokator. Megjithatë nuk desha t'i besoja fjalët e tija, andaj i thashë: «Duhet të të kenë gënjer». Ai nguli këmbë në të tijën. Unë as që mund të dyshoja se në një vend ku janë në fuqi komunistët, të ngjisnin krimë të tillë.

Mirëpo, pas disa muajsh, kur u mbajt në gushtshtator të vitit 1945 kongresi i parë i invalidëve jugosllavë, në delegacionin që përfaqësonëtë atë kongres invalidët e Luftës sonë nacional-çlirimtare bëja pjesë edhe unë.

Kur mora lajmin, natyrisht u gjëzova shumë. Në delegacion bënин pjesë edhe Zylyftar Veleshnja e Pandi Kocaqi.

Si arritëm në Manastir, që herët në mëngjes u nisëm me tren për në Beograd. Nga dritaret e vagonit, pas disa orësh udhëtimi, po sodisnim fushën e bukur të Kosovës, malet që shtriheshin gjer në kufirin tonë, malet e Tropojës, e të Krumës. Ne bisedonim me njëri-tjetrin se tani Kosova kishte shpëtuar nga skllavëria e drazhamihailovicëve, nga shovenistët sérbonëdhënë, pasi në Jugosllavi ishte vendosur pushteti popullor. Zylyftari, që kish qënë i arratisur politik në Jugosllavi për shumë vjet me radhë, na tregonte mbi regjimin shtypës të krajëve.

Udhëtarët, kur morën vesh se ne ishim shqiptarë, filluan të na mblidhen rreth, të na flasin plot respekt e dashuri për Shqipërinë, për luftën e saj heroike, për ndihmën që u kishim dhënë në luftën kundër pushtonjësve gjermanë. Disa prej atyre njerëzve ishin oficerë. Ata na folën për trimëritë e partizanëve të brigadave tona në tokat e Jugosllavisë.

Po ndërkohë ne na u afrua një burrë i veshur fshatar dhe na pyeti:

— Shqiptarë jini ju? Prej Shqipnisë së madhe vini?

Dhe pas kësaj u hodh e më përqafoi.

— Ne jemi vllazën, — tha ai, i mallëngjyer, — unë jam kosovar. Po në jini vllaznit tonë të vërtetë, pashi zotin, na shpëtoni. I thoni Enver Hoxhës, mos me na lanë të na çfarosin serbët!

Ne të tre shikuam njëri-tjetrin në sy dhe s'flisnim. Pastaj Zilyftari i tha:

— Në të kaluarën, por jo tani, që Jugosllavia është pushtet popullor me Titon në krye.

— Unë nuk flas për të kaluemen, — tha përsëri kosovari, — por për të tashmen. Shikojeni atë kodrën, e kuqe në rranxë të malit — dhe ai na tregoi me gishtin tregues. — S'ka gjashtë ditë që pushkatuen dyzet e dy veta dhe i hodhën që të gjithë në një gropë.

— Ata janë vrarë se kanë bashkëpunuar me armiqtë. Edhe ne në Shqipëri tradhëtarët i gjykojmë dhe, pas krimeve që kanë bërë, u japim dënimin që u takon.

— Jo, bre burra, ata s'kanë konë t'atillë (ai ishte nga Gjakova dhe fliste në dialektin e vet). Serbët rrethuen Gjakovën, dhe i arrestuen burrat nëpër shtëpi. Njizet e shtatë veta që s'pranuen të dorëzoheshin i vranë në rrugë. Po me nandë fëmij trembëdhjetëvjeçarë c'patën? Ata ishin fëmij! Në Pejë pushkatuen shtatëmbëdhjetë burra të tjerë. Po kjo punë ka ndodhun edhe në shumë katunde të tjera shqiptare.

Gjakovasi filloi të numëronte emrat e fshatrave. Ai na tha se atij i kishin therur dy niprit, njëri trembëdhjetë dhe tjetri pesëmbëdhjetë vjeç. Kish

shkuar dhe i kish nxjerrë nga gropo, ku i kishin hedhur me shumë tē tjerë. I kish varrosur përsëri, që tē mos u humbiste vorri, siç u shpreh ai.

Burrit filluan t'i binin lot.

— Ti nuk je në rregull! — i tha Zylyftari.

Po ne që tē tre ishim tē mallëngjyer. U larguam menjëherë. Shkuam në kabinën tonë. Mbyllëm derën dhe filluam tē bisedonim me njëri-tjetrin pér njeriun nga i cili sapo ishim ndarë. Na shkoi mendja se ai mund tē ish ndonjë provokator, ose ndonjë çetnik. Ndofta ishin vrarë dhjetë spiunë dhe ai e stërmadhonte atë numër. Po kish diçka që ne na la një përshtypje tē pashlyer — gjakovasi ish një fshatar i thjeshtë që merrej me bujqësi. Ish pak e pabesuar që ai tē trillonte me aqë imtësi. Ajo që na bënte tē mendonim më shumë, ishte sinqueriteti me tē cilin tregonë, lotët që i binin, që dëshmonin një shpirt tē plagosur e tē mbushur plot revoltë kundër gjithë atyre krimeve. Ai na foli se ishin pushkatuar fëmijë, duke na përmëndur edhe emrat e të dy nipërve tē tij. Nuk mund tē ish ai një njeri i parapërgatitur. As që mund tē mendohej se ai e dinte, bie fjala, që më përrpara, se ne, tre shqiptarë, do tē udhëtonim me atë tren, dhe pra, do tē kishtë pasë mundësi pér tē grumbulluar gjithë ato fakte, që na parashtroi, kush e di me çfarë qëllimi.

Po vetëkuptohet se ne, komunistët shqiptarë, atëhere nuk mund tē dyshonim tek ata që e quanin veten komunistë. Duhej tē kalonin shumë kohë që ujérat e turbulluara tē kulloheshin.

Mbrëmanet arritëm në Beograd. Ne na priten një nënkolonel dhe një major. Ata na shoqëruan në zyrat e Shoqatës së Invalidëve Jugosllavë. Aty

na pritën një gjeneral dhe një kolonel, që njërën këmbë e kish të prerë.

Ata na folën plot simpati për luftën e partizanëve tanë. Gjenerali i kish parë me sytë e tij trimëritë e partizanëve shqiptarë në tokën e Jugosllavisë. Si përkthenjës kishim një toger kosovar. Po gjuhën e tyre e dinte edhe Zylyftari.

Përpara se të shkonim për të ngrënë darkë, në një tryezë në sallon na prunë disa gota birrë. Gjenerali, duke m'u drejtuar mua, e ngriti gotën për popullin shqiptar, por edhe për «republikën e shtatë», me Titon në krye. Kur togeri e përktheu, unë propozova ta pinim për Shqipërinë demokratike me komandantin e përgjithëshëm, shokun Enver Hoxha në krye dhe për Jugosllavinë e re me shokun Tito në krye.

Po gjenerali e uli gotën. Ai më pyeti përsë mua s'më pëlqente ta pi ja atë dolli për Shqipërinë si «republikë të shtatë» të Jugosllavisë me Titon në krye?

I ulëm gotat të dy palët. Unë u përgjegja se edhe Titon e doja si udhëheqës të një vendi mik e vëlla; po si udhëheqës të popullit shqiptar unë njihja vetëm Enver Hoxhën.

Ndërhyri Zylyftari dhe muhabeti u zbut.

Në kongres pritej që të vinte Titua; por na lajmëruan se ai nuk do të vinte, pasi duhej të prisë ministrin anglez, për të biseduar me të për disa çështje të rëndësishme. Megjithatë na ngushëlluan duke na njoftuar se Titua do të organizonte një pritje, ku do të merrnin pjesë dy veta nga çdo republikë e Jugosllavisë dhe nga një përfaqësonjës i delegacioneve të ftuara.

Në atë pritje më takoi të shkoja edhe unë.

Në orën 1 të ditës shkuam në pallatin e Titos.

Ai ngrihej në një vend krejt të veçuar, në mes të një pylli. Na priti një grup prej 20 oficerësh. Na çuan në një sallë të bukur. Secili ishte ulur në një tryezë të veçantë të vogël. Na kishin vënë nga një gotë, një shishe me një lloj liqeri dhe një paqetë me cigare.

Prisnim nga çasti në çast që të hynte Titua. Në fillim te dera hyri një qen i zi, i cili u vërsul mbi ata që ishin te dera. Disa prej tyre ishin pa këmbë dhe s'lëviznin dot. Ata mbroheshin nga qeni vetëm me duar. Po dikush i foli dhe qeni qëndroi. Pas pak hyri Titua. Ai tundi kamzhikun që mbante në duar. Ndofta kjo ish shenjë që të heshte qeni.

Titua zuri vend mbi një qilim të bukur. Ai i pyeti ata të tre që rrinin te dera në i kish ngrënë qeni. Pastaj filloi të na tregojë historinë e kafshës së tij që i kish shpëtuar jetën. Ky tregim vazhdoi më tepër se 1 orë. Titua kish veshur uniformën e marshallit. Gjoksin e kishte të mbushur me dekorata. Kamzhikun e kish vendosur mbi tryezë. Nxori një pipë lluksoze me disa të dredhura dhe ndezi një cigare.

Të them të drejtën, mua më bëri përshtypje gjithë ai saltanet. Titon e mendoja më të thjeshtë, ashtu siç ishim të gjithë ne, komunistët. Pa dashur, bëja një krahasim me udhëheqësit tanë. Me disa prej tyre më kish takuar të kisha qenë afër gjatë luftës dhe pas. Po këta ishin shumë të thjeshtë, pa gjithë ato lulka, pa gjithë atë suitë. Nuk ish puna se atëhere mund të dyshoja. Përkundrazi. Po mua, që te personi i Titos, shikoja udhëheqësin e komunistëve jugosllavë, më dukej sikur gjithë ajo krekosje, gjithë ai saltanet nuk pajtohej me

një udhëheqës komunist. Ndryshe qëndronte e skalitur në përfytyrimin tim, figura e një udhëheqësi të tillë.

Por tani, pas njëzet e ca vjetësh, çdo gjë paraqitet e qartë: ai nuk kishte, ashtu siç nuk ka, asgjë të përbashkët me figurën e një udhëheqësi të vërtetë komunist.

## PÉRMBAJTJA

Faqe

Dy fjalë për lexonjësin .....	3-
-------------------------------	----

## PJESA E PARË

Në repartet «kufitare» njihem me shokë .....	7
Komunisti italian .....	10
Tentativë revolte e armatosur .....	15
Në vend të huaj .....	19
Largimi nga kampi .....	22
E papritura .....	24
Barba Simoni .....	27
Në gjirin e tokës mëmë .....	32

## PJESA E DYTË

Në malet kryengritës të Kurveleshit .....	36
Si u ngritën Këshillat e para të Kuqe .....	39
Një gasti politike .....	41
Autoritetet fashiste hidhen në kundërveprim .....	47
Nënprefekti vritet si tradhëtar .....	49
Autoritetet në panik .....	54
Armikut i digjen planet në duar .....	56
Në Kurvelesh të poshtëm merr fund pushteti fashist ..	60
Venua dhe xha Magripi: figura tipike labe .....	63
Inisiativa kalon përfundimisht në duart toma .....	73
Çeshtja e lirisë bën për vete zemrat .....	75
28 Nëndori i 1942-së festohet në liri .....	81
Bilbili i maleve .....	85
Jo vetëm propagandist, po edhe trim i rrallë .....	87

	Faqe
«Prishësi» i gostisë .....	88
Përgjigja e popullit .....	92
Ballë për ballë me Ali bej Këlcyrën .....	99
Operacioni i dhjetorit 1942 .....	104
Populli kërkon luftë frontale .....	108
Operacioni i prillit 1943 .....	112
Përgarja: arma e fundit e armikut .....	117
Batalioni pagëzohet me zjarr .....	122
Përpjekja e parë me gjermanët .....	125
Ballistët për plaçkë lënë koskat e tyre .....	134
Balli dhe porta e Kalasë .....	139
Shpresa e Ballit: oratoria e Ali beut .....	142
Fundi i një Divizioni .....	146
Në një përpjekje me xhepistët .....	148
Ish Dervishi partizan .....	152
Kur populli të ka në zemër .....	155
Një letër nga Qarkori i Gjirokastrës .....	157
Me batalionin «Asim Zeneli» .....	159
Në Rrëzoma të Delvinës .....	161
Asnjë minutë qetësi për armikun .....	163
Luftë e papritur në pyll .....	167
Luftimi im i fundit në rreshtat e batalionit «Asim Zeneli» .....	170

### PJESA E TRETË

Me plagët në trup .....	173
Në zonat e partizanëve grekë .....	179
Çaste hidhërimi dhe mallëngjimi .....	185
Të plagosurit në tërheqje .....	190
Përmes Adriatikut .....	197
Dyshimi që më bëri të mendoheshha .....	199